



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2018 – Numri: 116

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E hënë, 6 gusht 2018

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 49/2018 datë 23.7.2018	Për denoncimin e marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar 2010, për projektin “Rifinancimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në zonat urbane dhe rurale, faza e dytë”, ratifikuar me ligjin nr. 86/2015.....
	7117
Ligj nr. 50/2018 datë 23.7.2018	Për denoncimin e marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2010, për projektin “Eficienca energjetike përmes sektorit bankar”, ratifikuar me ligjin nr. 89/2015.....
	7118
Ligj nr. 51/2018 datë 23.7.2018	Për ratifikimin e marrëveshjes financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe <i>Cassa Depositi e Prestiti s.p.a.</i> për programin e arsimit dhe formimit profesional nëpërmjet inovacionit.....
	7120
Ligj nr. 52/2018 datë 23.7.2018	Për ratifikimin e marrëveshjes së grantit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit “Hekurudhat shqiptare - rehabilitimi i linjës hekurudhore Tiranë–Durrës dhe ndërtimi i linjës hekurudhore për në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës”, në kuadër të grantit të investimit nga Fondi i Përbashkët Evropian i Ballkanit Perëndimor.....
	7131
Ligj nr. 53/2018 datë 23.7.2018	Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për shtesën e financimit për projektin e modernizimit të asistencës sociale.....
	7151
Ligj nr. 54/2018 datë 23.7.2018	Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për projektin e konektivitetit të rrugëve rajonale dhe lokale.....
	7159

Vendim i Komisionit
të Ndhmës Shtetërore
nr. 86, datë 16.7.2018

Për një ndryshim në vendimin nr. 49, datë 29.9.2014 “Autorizim i ndihmës shtetërore për zbatimin e projektit të Gazsjellësit Trans Adriatik, bazuar në ligjin nr. 116, datë 15.4.2013, “Për ratifikimin e marrëveshjes me qeverinë e vendit pritës ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave, dhe Trans Adriatik Pipeline AG, lidhur me projektin e gazsjellësit Trans Adriatik (Projekti TAP), si dhe të marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, dhe Trans Adriatik Pipeline AG, në lidhje me projektin e gazsjellësit Trans Adriatik (Projekti TAP)””

7166



LIGJ
Nr. 49/2018

PËR DENONCIMIN E MARRËVESHJES
NDËRKOMBËTARE NDËRMJET
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE
TË GJERMANISË PËR
BASHKËPUNIMIN FINANCIAR 2010,
PËR PROJEKTIN “RIFINANCIMI I
NDËRMARRJEVE TË VOGLA DHE TË
MESME NË ZONAT URBANE DHE
RURALE, FAZA E DYTË”, RATIFIKUAR
ME LIGJIN NR. 86/2015

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1
Denoncimi

Denoncohet marrëveshja ndërkombëtare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar 2010, për projektin “Rifinancimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në zonat urbane dhe rurale, faza e dytë”, ratifikuar me ligjin nr. 86/2015.

Neni 2
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 23.7.2018

Shpallur me dekretin nr.10852, datë 31.7.2018
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Ilir Meta

MARRËVESHJE

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË
GJERMANISË PËR BASHKËPUNIM
FINANCIAR 2010 PËR PROJEKTIN
“RIFINANCIMI I NDËRMARRJEVE TË
VOGLA DHE TË MESME NË ZONAT
URBANE DHE RURALE, FAZA E DYTË”

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë, *në frymën e* marrëdhënieve ekzistuese miqësore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë;

duke u nisur nga dëshira për t'i forcuar dhe thelluar këto marrëdhënie miqësore nëpërmjet Bashkëpunimit Financiar si partnerë;

të ndërgjegjshme se ruajtja e këtyre marrëdhënieve përbën bazën e kësaj marrëveshjeje,

me qëllim për të kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë;

duke iu referuar bisedimeve ndërqeveritare të datës 18 maj 2010,

u morën vesh si vijon:

Neni 1

1. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë u jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë ose huamarrësve të tjerë që do të zgjidhen bashkërisht nga të dyja qeveritë, të marrin:

për projektin “Rifinancimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në zonat urbane dhe rurale, faza e dytë”, një hua me kushte të favorshme nga *Kreditanstalt für Wiederaufbau (KfW)*, e cila akordohet në kuadër të bashkëpunimit publik zhvillimor, me vlefte prej deri në 10.000.000 EUR (me dhjetë milionë euro),

kur nga shqyrtimi përkatës ka rezultuar se projekti vlen për t'u mbështetur në kuadër të politikës zhvillimore dhe, kur Shqipëria vazhdon të jetë e besueshme lidhur me kreditë. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë zotohet të mos e pengojë projektin dhe të përkrahë qeverinë e Republikës Federale të Gjermanisë kundrejt marrësit, lidhur me pretendimet eventuale për kthimin e huas, për shkak të përdorimit të saj të padrejtë. Projekti në fjalë nuk mund të zëvendësohet me projekte të tjera.



2. Në rast se qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë në një kohë të mëvonshme i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të marrë nga *Kreditanstalt für Wiederaufbau* hua ose shuma të tjera financimi për përgatitjen e projektit të përmendur në paragrafin 1 ose shuma të tjera financimi për masa të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit të përmendur në paragrafin 1, atëherë gjen zbatim kjo marrëveshje.

3. Shumat e financimit për masa përgatitore dhe shoqëruese sipas nenit 1 paragraf 2 do të kthehen në hua, në rast se ato nuk përdoren për masa të tilla.

Neni 2

1. Përdorimi i shumës së përmendur në nenin 1, kushtet me të cilat vihet në dispozicion ajo, si dhe procedura e dhënies së porosisë përcaktohen në kontratat që do të përfundohen midis *Kreditanstalt für Wiederaufbau* dhe marrësve të huas dhe të shumave të financimit, të cilat u nënshtrohen dispozitave ligjore që janë në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë.

2. Premtimi i shumës së përmendur në nenin 1 do të zhvlefësohet, në rast se kontratat përkatëse të huadhënies dhe të financimit nuk përfundohen brenda një afati prej tetë vitesh pas vitit të premtimit. Për shumën e përmendur në nenin 1, ky afat mbaron në datën 31 dhjetor 2018.

Neni 3

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e liron *Kreditanstalt für Wiederaufbau* nga të gjitha taksat dhe tatimet e tjera publike, të cilat merren në Republikën e Shqipërisë, lidhur me përfundimin dhe zbatimin e kontratave të përmendura në nenin 2, paragraf 1.

Neni 4

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i lejon pasagjerët dhe furnizuesit të zgjedhin lirisht ndërmarrjet transportuese për transportimin e personave dhe të mallrave në rrugë detare, tokësore dhe ajrore që rezultojnë nga dhënia e huas dhe e shumave të financimit, nuk merr asnjë masë e cila përjashton ose vështirëson pjesëmarrjen me të drejta të barabarta të ndërmarrjeve transportuese me qendër në Republikën Federale të Gjermanisë, dhe nxjerr në rastet e duhura lejet e nevojshme për

pjesëmarrjen e këtyre ndërmarrjeve trans-portuese.
Neni 5

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën, kur Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i njofton qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, se janë përmbushur kushtet brendashtetërore për hyrjen në fuqi. Përcaktuese është dita e marrjes së njoftimit.

Bërë në Tiranë, më _____, në dy origjinale, secili në gjuhën shqipe dhe gjermane, duke pasur të dyja tekstet fuqi të barabartë.

Për Këshillin e Ministrave të Republikës
së Shqipërisë

Për Qeverinë e Republikës Federale të Gjermanisë

LIGJ
Nr. 50/2018

**PËR DENONCIMIN E MARRËVESHJES
NDËRKOMBËTARE NDËRMJET
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE
TË GJERMANISË, PËR
BASHKËPUNIMIN FINANCIAR 2010, PËR
PROJEKTIN “EFICIENCA
ENERGJETIKE PËRMES SEKTORIT
BANKAR”, RATIFIKUAR ME LIGJIN
NR. 89/2015**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1
Denoncimi

Denoncohet marrëveshja ndërkombëtare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2010, për projektin “Eficienca energjetike përmes sektorit bankar”, ratifikuar me ligjin nr. 89/2015.



Neni 2

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 23.7.2018

Shpallur me dekretin nr.10853, datë 31.7.2018 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

MARRËVESHJE

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË, PËR BASHKËPUNIM FINANCIAR 2010, PËR PROJEKTIN “EFICIENCA ENERGJETIKE PËRMES SEKTORIT BANKAR”

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë,

në frymën e marrëdhënieve ekzistuese miqësore ndërmjet Republikës së Shqipërisë Republikës dhe Federale të Gjermanisë;

duke u nisur nga dëshira për t'i forcuar dhe thelluar këto marrëdhënie miqësore nëpërmjet bashkëpunimit financiar, si partnerë;

të ndërgjegjshme se ruajtja e këtyre marrëdhënieve përbën bazën e kësaj marrëveshjeje;

me qëllim për të kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë;

duke iu referuar bisedimeve ndërqeveritare të datës 18 maj 2010,

u morën vesh si vijon:

Neni 1

1. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë u jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë ose huamarrësve të tjerë që do të zgjidhen bashkërisht nga të dyja qeveritë, të marrin:

për projektin “Eficiencia energjetike përmes sektorit bankar”, një hua me kushte të favorshme nga *Kreditanstalt für Wiederaufbau (KfW)*, e cila akordohet në kuadër të bashkëpunimit publik zhvillimor, me vlefë prej deri në 12.000.000 EUR (me fjalë: dymbëdhjetë milionë euro),

kur nga shqyrtimi përkatës ka rezultuar se projekti vlen për t'u mbështetur në kuadër të politikës zhvillimore dhe, kur Shqipëria vazhdon të jetë e besueshme lidhur me kreditë. Këshilli i

Ministrave i Republikës së Shqipërisë zotohet të mos e pengojë projektin dhe të përkrahë qeverinë e Republikës Federale të Gjermanisë kundrejt marrësit, lidhur me pretendimet eventuale për kthimin e huas, për shkak të përdorimit të saj të padrejtë. Projekti në fjalë nuk mund të zëvendësohet me projekte të tjera.

2. Në rast se qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë, në një kohë të mëvonshme i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të marrë nga *Kreditanstalt für Wiederaufbau* hua ose shuma të tjera financimi për përgatitjen e projektit të përmendur në paragrafin 1 ose shuma të tjera financimi për masa të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit të përmendur në paragrafin 1, atëherë gjen zbatim kjo marrëveshje.

3. Shumat e financimit për masa përgatitore dhe shoqëruese sipas nenit 1, paragrafi 2, do të kthehen në hua, në rast se ato nuk përdoren për masa të tilla.

Neni 2

1. Përdorimi i shumës së përmendur në nenin 1, kushtet me të cilat vihet në dispozicion ajo, si dhe procedura e dhënies së porosisë përcaktohen në kontratat që do të përfundohen midis *Kreditanstalt für Wiederaufbau* dhe marrësve të huas dhe të shumave të financimit, të cilat u nënshtrohen dispozitave ligjore që janë në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë.

2. Premtimi i shumës së përmendur në nenin 1 do të zhvleftehet, në rast se kontratat përkatëse të huadhënies dhe të financimit nuk përfundohen brenda një afati prej tetë vjetësh pas vitit të premimit. Për shumën e përmendur në nenin 1, ky afat mbaron në datën 31 dhjetor 2018.

Neni 3

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e liron *Kreditanstalt für Wiederaufbau* nga të gjitha taksat dhe tatimet e tjera publike, të cilat merren në Republikën e Shqipërisë lidhur me përfundimin dhe zbatimin e kontratave të përmendura në nenin 2, paragraf 1.

Neni 4

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i lejon pasagjerët dhe furnizuesit të zgjedhin lirisht ndërmarrjet transportuese për transportimin e personave dhe të mallrave në rrugë detare, tokësore



dhe ajrore që rezultojn nga dhënia e huas dhe e shumave të financimit, nuk merr asnjë masë e cila përjashton ose vështirëson pjesëmarrjen me të drejta të barabarta të ndërmarrjeve transportuese me qendër në Republikën Federale të Gjermanisë dhe nxjerr, në rastet e duhura, lejet e nevojshme për pjesëmarrjen e këtyre ndërmarrjeve transportuese.

Neni 5

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën kur Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i njofton qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, se janë përmbushur kushtet brendashtetërore për hyrjen në fuqi. Përcaktuese është dita e marrjes së njoftimit.

Bërë në Tiranë, më _____, në dy origjinale, secili në gjuhën shqipe dhe gjermane, duke pasur të dyja tekstet fuqi të barabartë.

Për Këshillin e Ministrave të Republikës
së Shqipërisë
Për Qeverinë e Republikës Federale të Gjermanisë

LIGJ
Nr. 51/2018

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
FINANCIARE NDËRMJET KËSHILLIT
TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA
MINISTRIA E FINANCAVE DHE
EKONOMISË, DHE *CASSA DEPOSITI E
PRESTITI S.p.A.* PËR PROGRAMIN E
ARSIMIT DHE FORMIMIT
PROFESIONAL NËPËRMJET
INOVACIONIT**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:
Neni 1

Ratifikohet marrëveshja financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe *Cassa Depositi e Prestiti S.p.A.* për programin e arsimit dhe

formimit profesional nëpërmjet inovacionit, me një hua të butë, në shumën 5 000 000 (pesë milionë) euro, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 23.7.2018

**Shpallur me dekretin nr.10854, datë 31.7.2018
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Ilir Meta**

F.ROT./AID 16/005/00

**MARRËVESHJE FINANCIARE
NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA
MINISTRIA E FINANCAVE DHE
EKONOMISË DHE *CASSA DEPOSITI E
PRESTITI S.p.A.* 5,000,000.00 EURO,
“PROGRAMI I ARSIMIT DHE I
FORMIMIT PROFESIONAL NËPËRMJET
INOVACIONIT”**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, i përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (në vijim i referuar si “Huamarrësi”), nga njëra anë dhe

Cassa Depositi e Prestiti S.p.A., kapitali aksionar 4,051,143.264.00 euro, me seli në adresën: Rome, Via Goito 4, e regjistruar në Regjistrin e Shoqërive me kod fiskal nr. 80199230584, TVSH nr. 07756511007 (në vijim i referuar si “CDP”), si administratori i Fondit Qarkullues të Bashkëpunimit për Zhvillim, i krijuar nga qeveria e Italisë, sipas nenit 26, të ligjit italian nr. 227, të datës 24 maj 1977, në emër të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave të Republikës së Italisë dhe, në vijim të referuara në nenin 8, të ligjit italian 125/2014, me ndryshimet e herëpashershme, i përfaqësuar nga z. Stefano Gatti, Departamenti i Bashkëpunimit për Zhvillim Ndërkombëtar, përgjegjës i Njesisë së Menaxhimit të Fondit Qarkullues, nga ana tjetër.

(CDP dhe Huamarrësi, së bashku, të referuar në vijim si “Palët”).

Duke pasur parasysh:



A. Në vijim të “Marrëveshjes” (në vijim e referuar si “Marrëveshja”) të nënshkruar më 24 shkurt 2017, në Lushnjë, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe qeveria e Republikës së Italisë, kjo e fundit ka marrë përsipër të financojë Programin (siç përcaktohet këtu më poshtë), nëpërmjet një kredie të butë deri në një shumë maksimale prej 5,000,000.00 eurosh (pesë milionë euro/00);

B. Ministria e Ekonomisë dhe Financave e qeverisë së Republikës së Italisë, me dekreten nr. 91689, të datës 2 nëntor 2016 (në vijim i referuar si “Dekreti”) autorizoi CDP-në për t’i dhënë Huamarrësit një kredi të butë, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në nenin 2 të kësaj Marrëveshjeje Financiare (në vijim e referuar si “Marrëveshja Financiare”), për qëllimin e financimit të Programit;

C. Sipas kësaj Marrëveshjeje Financiare, Palët synojnë të parashtrijnë procedurën e disbursimit dhe kushtet financiare që lidhen me kredinë e butë, siç parashikohet në nenin 8 të Marrëveshjes dhe në Dekret.

Si rrjedhojë, aktualisht kanë vendosur të lidhin këtë Marrëveshje Financiare.

Neni 1

Përkufizimet dhe interpretimi

1.1 Pjesa hyrëse dhe shtojcat e kësaj Marrëveshjeje Financiare janë pjesë përbërëse dhe thelbësore e saj.

1.2 Në këtë Marrëveshje Financiare dhe në shtojcat e saj, termat në vazhdim kanë kuptimet si më poshtë:

- “Njohje e borxhit” do të thotë deklarimi i referuar në nenin 10, me anë të të cilit Huamarrësi pranon të jetë debitor i CDP-së dhe merr përsipër, në favor të CDP-së, të rimbursojë principalin dhe çdo shumë tjetër që duhet të paguhet në lidhje me kredinë e butë që do të përgatitet në përputhje me shtojcën F (Formulari i Njohjes së Borxhit) të kësaj Marrëveshjeje Financiare.

- “AICS” do të thotë Agjencia Italiane e Bashkëpunimit për Zhvillim.

- “Llogaria e CDP-së” do të thotë llogaria e mbajtur nga CDP-ja që ka të dhënat e mëposhtme IBAN IT06Z076020320000000000122-Bic /Swift CADPITRRXXX, e çelur nën emrin e *Cassa depositi*

e prestiti Società per azioni.

- “Marrëveshje Financiare” do të thotë kjo Marrëveshje Financiare, pjesa hyrëse dhe shtojcat, të cilat janë pjesë përbërëse e saj.

- “Raport financiar” do të thotë raporti financiar që lidhet me komponentin D të kredisë së butë;

- “Periudhë e faljes” do të thotë periudha që fillon në datën e disbursimit të parë të kredisë së butë dhe mbaron 120 (njëqind e njëzet) muaj pas saj.

- “Autoritete kompetente italiane” do të thotë Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe/ose Ministria e Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar të Republikës së Italisë dhe/ose AICS, dhe/ose çdo autoritet tjetër kompetent i qeverisë së Republikës së Italisë, i caktuar për qëllime të kësaj Marrëveshjeje Financiare.

- “MAECI-DGCS” do të thotë Ministria e Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar të Republikës së Italisë - Drejtoria e Përgjithshme e Bashkëpunimit për Zhvillim.

- “MEF” do të thotë Ministria e Ekonomisë dhe Financave të Republikës së Italisë.

- “MMSR” do të thotë Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë e Republikës së Shqipërisë ose çdo pasues i saj që është Agjencia Ekzekutive e Programit dhe do të përfaqësojë Huamarrësin në procedurat e disbursimit të përcaktuara në këtë Marrëveshje Financiare.

- “OECD” do të thotë Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik.

- “Kredi e butë” do të thotë huaja lehtësuese që CDP-ja, në bazë të autorizimit të parashikuar në dekret dhe në bazë të kushteve dhe afateve të përcaktuara në këtë Marrëveshje Financiare, është angazhuar t’i japë Huamarrësit.

- “Llogari e posaçme” do të thotë llogaria e çelur në emër të Huamarrësit në Bankën e Shqipërisë, ku kësti i vetëm i komponentit D) të Programit do të disbursohet në përputhje me procedurën e përmendur në nenin 8.

- “Kontratë/a furnizimi” do të thotë kontrata/t tregtare në lidhje me furnizimin e mallrave dhe/ose shërbimeve ndërmjet MMSR-së dhe furnizuesve në lidhje me realizimin e Programit.

Neni 2

Kredia e butë

2.1 Në bazë të kushteve dhe afateve të përcaktuara në këtë Marrëveshje Financiare, CDP-



ja i jep Huamarrësit dhe Huamarrësi pranon kredinë e butë, që vijon:

- shuma: 5,000,000.00 euro (pesë milionë euro/00);
- kohëzgjatja: 22 (njëzet e dy) vjet;
- periudha e faljes: 120 (njëqind e njëzet) muaj, duke filluar nga data e disbursimit të parë në llogarinë e posaçme;
- shlyerja: 24 (njëzet e katër) këste principali të njëpasnjëshme, të barabarta, çdo gjashtëmuaj, i pari nga të cilët bëhet detyrim për t'u paguar 120 (njëqind e njëzet) muaj pas disbursimit të parë;
- norma e interesit: 0.00% (zero pikë zero për qind);
- qëllimi i kreditimit: “Programi i arsimit dhe aftësimit profesional nëpërmjet inovacionit”.

2.2 Kredia e butë do të ndahet në katër komponentë:

A. 1,263,000.00 euro (një milion e dyqind e gjashtëdhjetë e tre mijë/00) që synon financimin e rehabilitimit dhe ndërtimit të infrastrukturës;

B. 2,240,000.00 euro (dy milionë e dyqind e dyzet mijë/00) që synon financimin e laboratorëve dhe pajisjeve;

C. 1,335,000.00 euro (një milion e treqind e tridhjetë e pesë mijë/00) që synon financimin e asistencës teknike institucionale;

D. 162,000.00 euro (njëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë/00) që synon financimin e asistencës për MMSR-në.

Komponentët sipas pikave të mësipërme: A, B dhe C, për një shumë të përgjithshme prej 4.838.000,00 eurosh (katër milionë e tetëqind e tridhjetë e tetë mijë/00) do të disbursohen në përputhje me procedurën e përmendur në nenet 5, 6 dhe 7 të kësaj Marrëveshjeje Financiare.

Komponenti në pikën e mësipërme D, deri në shumën maksimale prej 162,000.00 (njëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë/00), do të disbursohet në përputhje me procedurën e përmendur në nenin 8 të kësaj Marrëveshjeje Financiare.

2.3 Disbursimi i parë që lidhet me komponentët sipas pikave të mësipërme: A, B dhe C dhe disbursimi i vetëm i komponentit në pikën e mësipërme D, do të kryhet me plotësimin e kushteve të nenit 3 të kësaj Marrëveshjeje Financiare dhe kushtet e përmendura në shtojcën 2 të Marrëveshjes, që duhet plotësuar dhe i komunikohet CDP-së nga MMSR-ja.

2.4 Kredia e butë do të përdoret për Programin. Kredia e butë do të përdoret për financimin e blerjes së mallrave dhe shërbimeve që kanë origjinën në vend dhe/ose nga vende të tjera fqinje në zhvillim dhe/ose nga vendet e OECD-së deri në shumën totale të kredisë së butë.

Kontratat e furnizimit do të jenë të përcaktuara në euro.

2.5 Kredia e butë nuk mund të përdoret për të financuar:

- taksat vendore, detyrimet doganore, TVSH-në.

2.6 Kredia e butë do të jetë e disponueshme në përputhje me procedurat e përcaktuara në këtë Marrëveshje Financiare.

Neni 3

Hyrja në fuqi e Marrëveshjes Financiare

3.1 Kjo Marrëveshje Financiare do të hyjë në fuqi sapo CDP-ja të ketë marrë dokumentet e mëposhtme nga Huamarrësi:

i. një deklaratë nga autoriteti kompetent i qeverisë së Republikës së Shqipërisë, i cili provon autoritetin e Huamarrësit për ta nënshkruar, në emër dhe për llogari të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, këtë Marrëveshje Financiare nga një person plotësisht i autorizuar, në përputhje me ligjet dhe rregullat në fuqi dhe me efekt të plotë në Republikën e Shqipërisë dhe të marrë përsipër detyrimet që rrjedhin nga kjo Marrëveshje Financiare;

ii. një njoftim me shkrim nga Huamarrësi për përfundimin e procedurave të tij të brendshme;

iii. caktimin me shkrim nga autoriteti kompetent i Huamarrësit (nëpërmjet Ambasadës Italiane në Republikën e Shqipërisë) të personit ose personave plotësisht të autorizuar për të nënshkruar këtë Marrëveshje Financiare, Kërkesën për financimin e kontratës së furnizimit, sipas formularit në shtojcën A; autorizimin për disbursim sipas formularit në shtojcën C, kërkesën për disbursim sipas formularit në shtojcën D dhe “Njohjen e borxhit” sipas formularit në shtojcën F, të referuar në nenin 10 më poshtë. Ky caktim duhet të specifikojë emrin dhe pozicionin e këtij/këtyre personi/personave dhe do të përmbajë të përditësuar depozitimin e nënshkrimeve të tyre. Çdo modifikim në të (nëse ka) do të



transmetohet në kohën e duhur nga Huamarrësi tek CDP-ja.

3.2 CDP-ja, pas pranimi dhe plotësimit tërësor të dokumenteve të lartpërmendura, do të njoftojë Huamarrësin dhe AICS-në, me letër ose me faks që do të konfirmohet më pas me shkresë, për datën në të cilën do të hyjë në fuqi kjo Marrëveshje Financiare.

Neni 4

Afati për disbursimin e kredisë së butë

4.1 Kredia e butë do të jetë e disponueshme për disbursim nga data në të cilën të gjitha kushtet e përcaktuara në nenin 7 dhe 8 do të jenë përmbushur ose hequr nga CDP-ja, deri në (dhe duke përfshirë) datën që korrespondon 36 (tridhjetë e gjashtë) muaj pas datës së hyrjes në fuqi të Marrëveshjes Financiare. Kjo periudhë mund të zgjatet nga CDP-ja, me kërkesën me shkrim të Huamarrësit, në bazë të miratimit paraprak të autoriteteve kompetente italiane, të njoftuar me shkrim të CDP-ja para datës së skadimit të periudhës së disbursimit.

4.2 Në rastin kur periudha e disbursimit ka skaduar dhe nuk mund të zgjatet, në zbatim të nenit 4.1 më sipër, CDP-ja, pas konsultimit me autoritetet kompetente italiane, do të informojë Huamarrësin për anulimin e angazhimit të CDP-së në lidhje me fondet e papërdorura.

Neni 5

Kushtet dhe mënyrat për disbursimin e komponentëve A, B dhe C të kredisë së butë, për shumën maksimale prej 4,838,000.00 eurosh

5.1 Kredia e butë mund të përdoret nga MMSR-ja, në përputhje me kushtet që vijnë:

i. autorizimi i dhënë nga autoritetet kompetente italiane për shpërndarjen e kontratës/ave të furnizimit në kredinë e butë;

ii. rezultati pozitiv nga verifikimi i kryer nga CDP-ja sipas nenit 5.2(i) më poshtë;

iii. marrja e kërkesës nga ana e CDP-së për financimin e kontratës së furnizimit të parashikuar sipas nenit 6.1 më poshtë.

5.2 Me marrjen e autorizimit të përmendur në nenin 5.1(i) më lart, CDP-ja do të veprojë menjëherë si më poshtë:

i. të kryejë kontroll, në bazë të kërkesave të parashikuara nga Autoritetet Kompetente

Italiane, për furnizuesin dhe për kontratën/at e furnizimit. Në lidhje me kontratën/at e furnizimit, CDP-ja do të verifikojë nëse janë në përputhje me afatet dhe kushtet e kredisë së butë dhe nëse janë të detajuara në mënyrë të mjaftueshme në lidhje me kostot/analizën e çmimeve, me qëllim që të lejojnë verifikimet e parashikuara në nenin 7.2;

ii. të njoftojë MMSR-në dhe Huamarrësin për marrjen e autorizimit sipas nenit 5.1(i) më sipër dhe t'i kërkojë MMSR-së, të paraqesë kërkesën e parashikuar në nenin 6.1.

5.3 Rezultati pozitiv nga verifikimi i kryer nga CDP-ja, sipas nenit 5.2(i) më lart, do të çojë në akordimin e kontratës/ave të furnizimit në kredinë e butë. Financimi i kontratës/ave të furnizimit do të kryhet vetëm pas plotësimit të kushtit të përcaktuar në nenin 5.1(iii).

5.4 CDP-ja do të njoftojë me letër ose faks MMSR-në, Huamarrësin, AICS-në dhe furnizuesin për akordimin e kontratës/atave të furnizimit.

Neni 6

Kërkesa për financimin e kontratës së furnizimit do të disbursohet nga komponentët A, B dhe C të kredisë së butë, për shumën maksimale prej 4,838,000.00 eurosh

6.1 Pas njoftimit të rezultateve pozitive të dala nga verifikimi, sipas nenit 5.2(i), MMSR-ja do t'i dërgojë CDP-së një letër kërkesë për financimin e Kontratës së Furnizimit, e nevojshme për pagesat e parashikuara në çdo kontratë furnizimi. Me anë të një kërkesë të tillë, e cila do të jetë sipas formularit në shtojcën A, Huamarrësi do të pranojë që kontrata e furnizimit është e kualifikuar për t'u financuar dhe do të marrë përsipër t'i rimbursojë CDP-së shumën e disbursuar. CDP-ja duhet të njoftojë me letër ose faks MMSR-në, Huamarrësin, AICS-në dhe furnizuesin për financimin e kontratës/ave të furnizimit.

6.2 Letra e kërkesës për financimin e kontratës së furnizimit, e parashikuar në nenin 6.1, do të merret në kohën e duhur dhe në asnjë rast më vonë se gjashtë muaj nga data e njoftimit nga CDP-ja e parashikuar në nenin 5.4 më lart ose afati (nëse ka) i parashikuar në kontratën e furnizimit. Pas skadimit të periudhës së



lartpërmendur, CDP-ja, pas konsultimit me autoritetet kompetente italiane, do të marrë në konsideratë anulimin e mundshëm të kontratës/ave të furnizimit të akorduara për kredinë e butë.

Neni 7

Procedura e disbursimit të komponentëve A, B dhe C të kredisë së butë, për shumën maksimale prej 4,838,000.00 eurosh

7.1 Furnizuesi duhet të dorëzojë dokumentacionin kontraktues origjinal në CDP dhe do të kërkojë disbursimin e shumës përkatëse në CDP, në përputhje me kontratën e furnizimit, sipas formularit në shtojcën B që do t'i dërgohet Huamarrësit dhe MMSR-së. Kopja origjinale e lartpërmendur e dokumentacionit kontraktual do të dërgohet nga CDP-ja te Huamarrësi dhe MMSR-ja.

7.2 Pas marrjes së çdo kërkesë për disbursim, CDP-ja do të shqyrtojë dokumentacionin kontraktual. Një shqyrtim i tillë do të përfshijë pajtueshmërinë e dokumentacionit kontraktual me kontratën përkatëse të furnizimit.

7.3 CDP-ja do të kryejë disbursimin vetëm pas autorizimit të pagesës së MMSR-së, sipas formularit në shtojcën C, duke përjashtuar parapagimet dhe me përmbushjen e kushteve, sipas nenit 2.3 të kësaj Marrëveshjeje Financiare.

7.4 Në bazë të kontrollit pozitiv të parashikuar në nenin 7.2 dhe plotësimit të kushteve sipas nenit 7.3, CDP-ja duhet të konfirmojë me shkrim ose faks për MMSR-në dhe Huamarrësin shumën e përgjithshme të disbursimit dhe datën në të cilën janë kredituar fondet.

7.5 CDP-ja do të kryejë pagesat në favor të furnizuesit/esve dhe duhet të marrë nga ai/ata furnizues, faturën e përmbushjes së detyrimit të parashikuar në shtojcën E në dy origjinale, njëra prej të cilave do t'i kthehet MMSR-së dhe Huamarrësit.

7.6 Pas çdo pagese në interes të furnizuesit/esve, CDP-ja duhet t'i dërgojë me shkrim Huamarrësit dhe MMSR-së, një plan shlyerjeje, i cili paraqet shumat e disbursuara, duke specifikuar datat e kërkueshme për pagesë që lidhen me to në përputhje me nenin 9 më poshtë. Huamarrësi do të konfirmojë me shkrim pranimin e tij për grafikun e lartpërmendur të shlyerjes.

Neni 8

Procedura e disbursimit për komponentin D të kredisë së butë, për shumën maksimale prej 162,000.00 eurosh

8.1 Shuma prej 162,000.00 euro (njëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë/00) që synon financimin e asistencës për MMSR-në, do të disbursohet nga CDP-ja pas plotësimit të kushteve, sipas nenit 2.3 të kësaj Marrëveshjeje Financiare.

8.2 Kërkesa për disbursim e transmetuar nga MMSR-ja, në përputhje me shtojcën D, në shumën prej 162,000.00 (njëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë/00), do të ekzekutohet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së kërkesës nga CDP-ja.

8.3 Brenda 24 (njëzet e katër) muajve nga data e disbursimit, MMSR-ja do të dërgojë tek AICS, CDP dhe Huamarrësi një raport financiar në lidhje me rregullsinë dhe pajtueshmërinë me kushtet e vendosura në Marrëveshje dhe në këtë Marrëveshje Financiare për çdo transaksion financiar që lidhet me shumën e disbursuar. AICS-ja dhe CDP-ja duhet të informojnë MMSR-në dhe Huamarrësin për rezultatet e verifikimit brenda 20 (njëzet) ditëve kalendarike nga data e marrjes së raportit financiar.

8.4 Huamarrësi merr përsipër në mënyrë të parevokueshme që të kthejë te CDP-ja shumat e barabarta me shpenzimet e pamiratuara nga AICS-ja dhe CDP-ja.

8.5 Nëse ndonjë shumë e kredituar në MMSR nga CDP-ja nuk do të përdoret brenda 24 (njëzet e katër) muajve nga data e disbursimit, kjo shumë do të kthehet menjëherë te CDP nga MMSR-ja. Ky transferim do të bëhet pa vonesë pas komunikimit, të rënë dakord me AICS-në, nga CDP-ja te Huamarrësi dhe MMSR-ja, dhe me çdo mjet, brenda një muaji nga komunikimi i CDP-së.

8.6 Pas disbursimit të fondeve në llogarinë e posaçme, CDP-ja do të përcjellë me shkresë te Huamarrësi dhe MMSR-ja, grafikun përkatës të shlyerjes, duke treguar datat përkatëse të pagesës. Një skemë e tillë shlyerjeje, e plotësuar në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 9 më poshtë, do të pranohet me shkrim nga Huamarrësi.

Neni 9

Shlyerja e kredisë së butë

9.1 Çdo shumë e disbursuar do të shlyhet sipas grafikut të shlyerjes në 20 (njëzet) këste të njëpasnjëshme, të barabarta, çdo gjashtëmujor (në



vijim të referuara si “Këste të Principalit”), i pari nga të cilët bëhet detyrim për t’u paguar 120 (njëqind e njëzet) muaj nga data e disbursimit të parë. CDP-ja duhet t’i dërgojë Huamarrësit grafikun e shlyerjes në përputhje me nenet 7.6 dhe 8.6.

9.2 Për Këstet e Principalit të mbetura pa shlyer dhe efektivisht të kredituara, interesi i mbetur do të llogaritet me një normë nominale vjetore prej 0.00% (zero pikë zero për qind).

9.3 Huamarrësi merr përsipër të kryejë të gjitha shlyerjet e marra sipas kësaj Marrëveshjeje Financiare, si dhe në bazë të njohjes së borxhit pa vonesë: në datën aktuale të pagesës, për shumën korresponduese në euro, në favor të CDP-së ose personit që ka të drejtë. Këto shuma do të kreditohen pa asnjë zbritje të ndonjë komisioni bankar dhe/ose tarife shkëmbimi valutor dhe/ose tatimor dhe pa qenë e nevojshme njoftimi për këtë nga CDP-ja ose personat e caktuar të cilëve iu është kërkuar. Huamarrësi do të marrë njoftim përpara datës së shlyerjes të duhur. Nëse Huamarrësi, për çfarëdo arsye, nuk merr njoftimin e lartpërmendur, ai do të ndërmarrë, gjithsesi, të kryejë të gjitha pagesat sipas grafikut të shlyerjes pa vonesë. Për çdo shlyerje, Huamarrësi do të përcaktojë në CDP numrin e Marrëveshjes Financiare dhe shumën totale të kredisë së butë dhe do të detajojë për secilën datë të duhur shumat e paguara.

Neni 10

Dorëzimi i njohjes së borxhit

10.1 Brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve kalendarike nga data e fundit e skadimit të disbursimit të kredisë së butë të përcaktuar në nenin 4.1, Huamarrësi do të dorëzojë te CDP-ja “Njohjen e borxhit”, të nënshkruar dhe të sigluar në mënyrë të duhur nga Huamarrësi në çdo faqe, sipas formularit në shtojcën F).

10.2 Grafiku i shlyerjes i parashtruar në “Njohjen e borxhit” do të plotësohet duke mbledhur të gjitha këstet e principalit që nuk janë maturuar ende të parashikuara në grafikun përkatës të shlyerjes për çdo disbursim, në përputhje me dispozitat e neneve 7.6 dhe 8.6.

10.3 CDP-ja duhet të depozitojë “Njohjen e borxhit” për regjistrimin dhe administrimin e tij dhe, herë pas here, do të regjistrojë në “Njohjen e borxhit” çdo pagesë të shumës së principalit dhe sa

më shpejt të jenë kryer të gjitha pagesat e parashikuara në “Njohjen e borxhit”, CDP-ja do t’i kthejë Huamarrësit “Njohjen e borxhit”, të nënshkruar siç duhet për pranim.

Neni 11

Angazhimi i Huamarrësit

Angazhimi i Huamarrësit për të paguar shumat e kërkueshme sipas kësaj Marrëveshjeje Financiare dhe “Njohjes së borxhit” që lidhet me të, është i pavarur, absolut, i pakushtëzuar dhe i parevokueshëm.

Neni 12

Pengesat dhe forca madhore

Në rast të pengesave për zbatimin e Programit për arsye të forcës madhore (të tilla si: lufta, përmytja, zjarri, tajfuni, tërmeti, konfliktet e punës dhe grevat, vështirësitë e papritura të transportit dhe arsye të tjera) do të zbatohen dispozitat e përcaktuara në nenin 12 të Marrëveshjes. CDP-ja duhet të ndjekë udhëzimet nga autoritetet kompetente italiane në lidhje me veprimtaritë e Programit.

Neni 13

Pezullimi i disbursimit

13.1 Gjatë periudhës së disbursimit të kredisë të butë, CDP-ja ruan të drejtën të pezullojë çdo kërkesë për disbursim sipas neneve 7 dhe 8, në rast të ndonjë mosrealizimi kundrejt CDP-së, sipas kësaj Marrëveshjeje Financiare ose çfarëdo kredie tjetër të butë të dhënë nga qeveria e Republikës Italiane për qeverinë e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 8, të ligjit nr. 125/2014, të Republikës Italiane, të ndryshuar herë pas here. CDP-ja do të informojë në kohë Huamarrësin për një pezullim të tillë.

13.2 CDP-ja do të ekzekutojë çdo kërkesë për disbursim të parashikuar në nenet 7 dhe 8, në rast se shumat përkatëse vihen në dispozicion nga autoritetet kompetente italiane. CDP-ja nuk do të konsiderohet përgjegjëse kundrejt Huamarrësit, në rast se shumat për t’u disbursuar në bazë të kredisë së butë nuk do të bëhen të disponueshme nga autoritetet kompetente italiane.



Neni 14

Interesi në rast vonese/kamatëvonesa

14.1 Nëse për çfarëdolloj arsyeje, CDP-ja nuk merr shumat e kërkueshme për principalin brenda datës së caktuar, Huamarrësi do të jetë i detyruar t'i paguajë CDP-së, për shumat e lartpërmendura, kamatëvonesa që nga data e detyrimit deri në datën e kreditimit efektiv në favor të CDP-së ose të personit/ave të caktuar për këtë qëllim.

14.2 Ky interes do të llogaritet duke zbatuar formulën e interesit të thjeshtë.

Kamatëvonesa nuk do të llogaritet për periudhën 35 (tridhjetë e pesë) ditë, menjëherë pas datës fillestare të detyrimit për pagesë dhe më pas do të llogaritet me një normë 0.10% (zero pikë dhjetë për qind) deri në datën e kreditimit efektiv në favor të CDP-së. Kamatëvonesa e kësaj të fundit do të përditësohet periodikisht nga autoritetet kompetente italiane.

Neni 15

Taksat

15.1 Çdo taksë në fuqi në të tashmen apo në të ardhmen, e cila mund të jetë e detyrueshme për pagesë në Shqipëri, për çfarëdolloj arsyeje në lidhje me këtë Marrëveshje Financiare dhe me "Njohjen e borxhit", do të mbulohet ekskluzivisht nga Huamarrësi.

15.2 Çdo taksë e kërkueshme për t'u paguar në Itali në lidhje me këtë Marrëveshje Financiare, nuk do të mbulohet nga Huamarrësi.

Neni 16

Ligji i zbatueshëm

Kjo Marrëveshje Financiare do të zbatohet dhe interpretohet në përputhje me ligjin italian.

Neni 17

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

17.1 Palët e kësaj Marrëveshjeje do të bëjnë përpjekje për të zgjidhur në mirëkuptim çdo mosmarrëveshje që lind prej ose nga interpretimi dhe/ose zbatimi i kësaj Marrëveshjeje Financiare.

17.2 Nëse këto përpjekje nuk çojnë në një zgjidhje të mosmarrëveshjes brenda një afati të arsyeshëm, atëherë mosmarrëveshja do të zgjidhet në nivel qeveritar.

17.3 Nëse edhe kjo përpjekje do të dështojë (nëse është bërë përpjekje) ose nuk sjell një rezultat

të kënaqshëm, të gjitha mosmarrëveshjet që lindin prej ose që lidhen me këtë Marrëveshje Financiare, do të zgjidhen, përfundimisht sipas Rregullores së Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Paris, Francë, nga një gjykatë arbitrazhi me tre arbitra:

- një arbitër i caktuar nga Huamarrësi;

- një arbitër i caktuar nga CDP-ja;

- arbitri i tretë caktohet nga arbitrat e lartpërmendur ose në rast të mosrënies dakord të tyre, prej kryetarit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Paris.

17.4 Nëse Huamarrësi ose CDP-ja nuk caktojnë arbitrin brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga kërkesa e palës tjetër, ky arbitër do të caktohet nga kryetari i Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Paris.

17.5 Vendimi i Gjykatës së Arbitrazhit, i cili do të vendosë sipas Ligjit të Republikës së Italisë, do të jetë përfundimtar dhe pa kushte, i detyrueshëm për zbatim nga të dyja palët pa asnjë mundësi për ta apeluar.

17.6 Asnjë mosrënie dakord dhe asnjë mosmarrëveshje që mund të lindë midis palëve të këtushme, nuk do të pezullojë detyrimin e Huamarrësit për të paguar, në datat e detyrim, të rëna dakord, për të gjitha shumat detyrim sipas kësaj Marrëveshjeje Financiare dhe, veçanërisht, të gjitha shumat që rezultojnë nga grafikët e shlyerjes të përcaktuara në nenet 7.6 dhe 8.6 më lart dhe nga "Njohja e borxhit" e lidhur me të.

Neni 18

Njoftimet

Njoftimet që do të kryhen në përputhje me këtë Marrëveshje Financiare, do të dërgohen në adresat e mëposhtme:

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë e Republikës së Shqipërisë, bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 3, Tiranë, Shqipëri;

Tel.: +355 -4- 228405- Faks: +355 -4- 2228494;

Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë e Republikës së Shqipërisë, Rruga e Kavajës, Tiranë Shqipëri...;

- Cassa depositi e prestiti S.p.A. - International Development Cooperation Department Via Goito 4 – 00185 Rome Italy e-mail: fondorotativocs@cdp.it.



Neni 19

Çdo amendament i kësaj Marrëveshjeje Financiare duhet të bëhet me shkrim ndërmjet CDP-së dhe Huamarrësit. Ministri i Financave dhe Ekonomisë i Republikës së Shqipërisë është i autorizuar të nënshkruajë çdo amendament, i cili duhet të miratohet nga Këshilli i Ministrave të Shqipërisë. Për amendamentet në këtë Marrëveshje Financiare që prekin vetëm afatin e disbursimit nuk do të jetë i nevojshëm miratimin paraprak i Këshillit të Ministrave të Shqipërisë.

Neni 20

Tekstet origjinale të Marrëveshjes Financiare

Kjo Marrëveshje Financiare nënshkruhet në tri origjinale në gjuhën angleze, CDP-ja mban dy origjinale dhe Huamarrësi një origjinal.

Cassa depositi e prestiti S.p.A.	Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, i përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë
----------------------------------	---

Nënshkruar në... më...	Nënshkruar në... më...
------------------------	------------------------

(Formulari i kërkesës për financimin e kontratës së furnizimit)**Shtojca A**

Nga:..... (MMSR)

Për: Cassa depositi e prestiti S.p.A.

Marrëveshja Financiare për (.....) euro, e nënshkruar nga, në, më, dhe nga Cassa depositi e prestiti S.p.A. në, më

Në zbatim të nenit 6 të Marrëveshjes Financiare të lartpërmendur, ne dëshirojmë t'ju informojmë se kontrata e furnizimit, këtu bashkëlidhur, nr., datë, midis dhe, lidhur me (Projektin), është e kualifikuar për financim.

Si rrjedhojë, ne ju kërkojmë që të financoni shumën përkatëse prej eurosh (.....), e cila u korrespondon pagesave, detyrim nga ana jonë, për (furnizuesi), që ju do të kryeni në përputhje me kushtet e Kontratës së Furnizimit.

Për këtë qëllim, ne pranojmë se pagesat që ju do të kryeni në favor të furnizuesit, të treguara nga vetë ne, do të varen nga procedura e përmendur në nenin 7 të Marrëveshjes Financiare.

Në këtë kuptim, ju do të na dërgoni origjinalin e dokumentacionit kontraktual, si dhe një nga dy origjinalet e faturës së paguar.

Me anë të kësaj, ne ju konfirmojmë se Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë merr përsipër, pa kushte dhe, në mënyrë të pakthyeshme, të shlyejë çdo shumë të kredituar nga ju në llogarinë e furnizuesit, sipas kushteve dhe afateve të parashikuara në Marrëveshjen Financiare.

Brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditësh nga data e skadimit të afatit të fundit të disbursimit të kredisë së butë, të përcaktuar në nenin 4 të Marrëveshjes Financiare, ne marrim përsipër të lëshojmë një “Njohje të borxhit” për shumën e principalit që korrespondon me shumën totale të të gjitha disbursimeve të kryera sipas Marrëveshjes Financiare.

Kjo “Njohje e borxhit” do të jetë sipas formularit në shtojcën F të Marrëveshjes Financiare.

Me respekt,

Datë ...

(.....)
Nënshkrimi i MMSR-së

**(Formulari i kërkesës për disbursim)****Shtojca B**

Nga:(furnizuesi)

Për: Cassa depositi e prestiti S.p.A.

Në vëmendje të: (Huamarrësi)

... (MMSR)

Marrëveshja Financiare për (.....) euro, nënshkruar nga, në, më dhe nga Cassa depositi e prestiti S.p.A., në, më

Të nderuar zotërinj,

Duke iu referuar kontratës së furnizimit, nr. datë, midis nesh dhe (blerës) për shumën prej (....) eurosh, lidhur me (projektin), ne ju dërgojmë dokumentacionin kontraktual që vijon për shumën (....) euro:

.....

.....

.....

Ne ju kërkojmë të disbursoni shumën e lartpërmendur, me konfirmimin e MMSR-së, në llogarinë bankare që vijon:

IBAN: Çelur në emër të: Banka:, nr. telefoni i zyrës së degës: nr. faksi i zyrës së degës:

Me respekt,

Datë ...

Nënshkrimi**(Formulari i autorizimit për disbursim)****Shtojca C**

Nga: (MMSR)

Për: Cassa depositi e prestiti S.p.A.

Në vëmendje të: (Huamarrësi)

Marrëveshja Financiare për (.....) euro, e nënshkruar nga, në, më dhe nga Cassa depositi e prestiti S.p.A., në, më

Të nderuar zotërinj,

Në zbatim të nenit 7 të Marrëveshjes Financiare të lartpërmendur, ne dëshirojmë t'ju informojmë se kemi marrë origjinalin e dokumentacionit kontraktual në lidhje me kontratën e furnizimit nr., datë, midis dhe, në lidhje me (projekti), për shumën që duhet paguar prej (....) eurosh.

Ne vërtetojmë që dokumentet kontraktuale të cituara më lart janë të rregullta sipas kontratës së cilës i referohen.

Ne ju autorizojmë që të paguani kundërvlerën e dokumenteve përkatëse në favor të (furnizuesi).

Me respekt,

Data ...

(.....)
Nënshkrimi i MMSR-së

**(Formulari i kërkesës për disbursim)****Shtojca D**

Nga: (MMSR)

Për: Cassa depositi e prestiti S.p.A.

Në vëmendje të: (Huamarrësi)

Marrëveshja Financiare prej eurosh, e nënshkruar nga ne në, më dhe nga Cassa depositi e prestiti S.p.A., në, më

Në zbatim të nenit 8 të Marrëveshjes Financiare të lartpërmendur, ne ju kërkojmë që të kreditoni brenda 30 (tridhjetë) ditësh, në llogarinë e posaçme (siç është përcaktuar në të) me nr. IBAN dhe çelur në Bankën, shumën prej..... (.....) euro, me kusht që fondet përkatëse të jenë vënë në dispozicion nga autoritetet kompetente italiane (siç përcaktohet në të).

Fondet e kredituara nga ju në llogarinë e posaçme do të shfrytëzohen për zbatimin e Programit "...".

Huamarrësi me këtë rast merr përsipër, në mënyrë të pakushtëzuar dhe të pakthyeshme, të shlyejë shumën e përmendur prej eurosh, të kredituar nga ju në llogarinë e posaçme, sipas afateve dhe kushteve të përcaktuara në Marrëveshjen Financiare të lartpërmendur.

Brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga data e skadimit të afatit të fundit të disbursimit të kredisë së butë, të përcaktuar në nenin 4 të Marrëveshjes Financiare, Huamarrësi merr përsipër t'i lëshojë CDP-së një "Njohje të borxhit" për të gjitha shumat e disbursuara sipas Marrëveshjes Financiare të lartpërmendur.

"Njohja e borxhit" do të jetë sipas formularit në shtojcën F të Marrëveshjes Financiare të lartpërmendur.

Me respekt,

Datë ...

Nënshkrimi i MMSR-së**(Formulari i vërtetimit për faturë të paguar)****Shtojca E**

Nga: Furnizuesi

Për: (MMSR)

Për: Cassa depositi e prestiti S.p.A.

Në vëmendje të: (Huamarrësi)

Vërtetimi për faturë të paguar

Duke iu referuar kontratës së furnizimit nr. nënshkruar më, ndërmjet shoqërisë sonë dhe, për furnizimin e, ne, me anë të kësaj, konfirmojmë se kemi marrë shumën prej..... (.....) eurosh, si pagesë të pjesshme/totale të kësaj kontrate furnizimi.

Kjo shumë lidhet me kredinë e butë prej (.....) eurosh, të dhënë nga CDP-ja për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë, në zbatim të nenit 8, të ligjit nr. 125, të datës 11 gusht 2014, me ndryshimet e pësuar herë pas here, me anë të Marrëveshjes Financiare të nënshkruar në, më dhe në ..., më

Prandaj, ne, me anë të kësaj, konfirmojmë se jemi paguar tërësisht për shumën e pjesshme/totale detyrim sipas kredisë së butë, si pagesë për shumën prej (.....) eurosh dhe se Huamarrësi dhe CDP-ja nuk janë përgjegjës për ndonjë apo për të gjitha komisionet dhe përgjegjësitë që lidhen me shumën e marrë.

Datë ...

Nënshkrimi



(Formulari i njohjes së borxhit)

Shtojca F

(Huamarrësi)

Nr.

Vendi dhe data e lëshimit:

Në lidhje me Marrëveshjen Financiare ndërmjet (Huamarrësi), i cili vepron në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë ... dhe CDP-së, të nënshkruar në, më, dhe në, më, (Huamarrësi) pranon marrjen e shumave që vijnë nga CDP-ja:

..... on

Prandaj, (Huamarrësi), me anë të kësaj, deklaron pa kushte dhe në mënyrë të pakthyeshme, të jetë debitor ndaj CDP-së, si administrator i Fondit Qarkullues për Bashkëpunim e Zhvillim, në emër të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave të Italisë, me zyrë të regjistruar në Romë (Itali), Via Goito 4, për shumën e principalit prej (....) eurosh, të cilën ai merr përsipër ta shlyejë në ... (.....) këste të barabarta, të njëpasnjëshme, i pari i të cilëve do të bëhet detyrim për t'u paguar, më ... dhe i fundit, më, sipas grafikut të shlyerjes të përcaktuar këtu më poshtë.

..... (Huamarrësi) do të shlyejë këstet e principalit të parashikuara në këtë “Njohje borxhi”, duke kredituar shumat përkatëse në euro, në datat e detyrimit, të rëna dakord, në favor të CDP-së, në llogarinë e CDP-së, pa ndonjë tarifë shërbimi bankar dhe/ose këmbimi valutor.

Nëse CDP-ja, për çfarëdolloj arsyeje, duke përfshirë edhe arsyet jashtë kontrollit të Huamarrësit, nuk merr në datën e detyrimit, shumat detyrim për principalin e parashikuar në këtë “Njohje borxhi”, Huamarrësi do të jetë i detyruar të paguajë në llogarinë e CDP-së, kamatëvonesa për këto shuma që nga data e detyrimit deri në datën e kreditimit efektiv në favor të CDP-së.

Kjo kamatëvonesë do të llogaritet duke zbatuar formulën e interesit të thjeshtë. Kamatëvonesa nuk do të llogaritet për periudhën prej 35 (tridhjetë e pesë) ditësh menjëherë pas datës fillestare të detyrimit për pagesë dhe më pas do të llogaritet në masën ...% (... për qind) deri në datën e kreditimit efektiv në favor të CDP-së.

.....

(inicialet/sigla e Huamarrësit)

vazhdon

Shtojca F vijon

Ky interes i fundit do të përditësohet periodikisht nga autoritetet kompetente italiane.

CDP-ja do të shënojë, herë pas here, në këtë “Njohje borxhi” çdo pagesë të principalit.

Menjëherë sapo të jenë kryer të gjitha pagesat e renditura në grafikun e shlyerjes të përcaktuar më poshtë, kjo “Njohje borxhi” do t'i kthehet (Huamarrësi).

Kjo “Njohje borxhi” lëshohet në zbatim të kredisë së butë prej (... ..) eurosh.

GRAFIKU I SHLYERJES

	Data e maturimit	Këstet e principalit	TOTALI
a)			
b)			
c)			
d)			
.....			
.....			
1)			
2)			

(.....)

(Nënshkrimi i Huamarrësit)



LIGJ
Nr. 52/2018

VERSION NËNSHKRIMI
(Numri i operimit: 48466)

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
SË GRANTIT NDËRMJET REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË DHE BANKËS
EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE
ZHVILLIM, PËR FINANCIMIN E
PROJEKTIT “HEKURUDHAT
SHQIPTARE - REHABILITIMI I LINJËS
HEKURUDHORE TIRANË–DURRËS
DHE NDËRTIMI I LINJËS
HEKURUDHORE PËR NË
AEROPORTIN NDËRKOMBËTAR TË
TIRANËS”, NË KUADËR TË GRANTIT
TË INVESTIMIT NGA FONDI I
PËRBASHKËT EVROPIAN I
BALLKANIT PERËNDIMOR**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e grantit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit “Hekurudhat shqiptare - rehabilitimi i linjës hekurudhore Tiranë–Durrës dhe ndërtimi i linjës hekurudhore për në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës”, me një grant investimi nga Fondi i Përbashkët Evropian i Ballkanit Perëndimor në shumën 35 435 000 (tridhjetë e pesë milionë e katërqind e tridhjetë e pesë mijë) euro, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 23.7.2018

**Shpallur me dekretin nr. 10855, datë 31.7.2018
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Ilir Meta**

MARRËVESHJE GRANTI

(HEKURUDHAT SHQIPTARE-
REHABILITIMI I LINJËS HEKURUDHORE
TIRANË–DURRËS DHE NDËRTIMI I
LINJËS HEKURUDHORE PËR NË
AEROPORTIN NDËRKOMBËTAR TË
TIRANËS) NDËRMJET REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE BANKËS EVROPIANE
PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM, NË
LIDHJE ME NJË GRANT INVESTIMI NGA
FONDI I PËRBASHKËT EVROPIAN I
BALLKANIT PERËNDIMOR
DATË 9.5.2018

Marrëveshja e datës _____, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Përfituesi) dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (“Banka” ose “BERZH”).

PREAMBULA

Duke pasur parasysh se:

A. BERZH-i është një institucion financiar ndërkombëtar i krijuar sipas së drejtës ndërkombëtare, bazuar në Marrëveshjen që krijon Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (Marrëveshja që krijon Bankën), të datës 29 maj 1990.

B. Përfituesi ka kërkuar asistencë për financimin e një pjese të Projektit (të përkufizuar këtu e më poshtë), i cili është hartuar për të ndihmuar Përfituesin, për rehabilitimin e linjës ekzistuese hekurudhore ndërmjet qyteteve të Tiranës dhe të Durrësit, me gjatësi prej 34.17 km përafërsisht dhe ndërtimin e një linje të re hekurudhore me gjatësi 5 km përafërsisht, për të lidhur Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës dhe vendtakimin e tij me linjën ekzistuese.

C. Më 29 dhjetor 2016, Banka ka nënshkruar Marrëveshje Huaje me Përfituesin në cilësinë e Huamarrësit, sipas së cilës Banka si huadhënëse do të japë hua shumën prej 36 870 000 eurosh (tridhjetë e gjashtë milionë, tetëqind e shtatëdhjetë mijë euro) për financimin e pjesës së Projektit, të përshkruar në grafikun 1 të saj dhe në grafikun 1 të kësaj Marrëveshjeje (Projekti), sipas afateve dhe kushteve të përcaktuara në



Marrëveshjen e Huas që mund të ndryshohet herë pas herë (Marrëveshja e Huas).

D. Të ardhurat nga Marrëveshja e Huas do të nënkuazohen nga Përfituesi për Hekurudhën Shqiptare sh.a. (Njësia Projektit) për zbatimin e Projektit, në përputhje me afatet dhe kushtet e marrëveshjes për nënkuadhinien, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Financave të Përfituesit dhe Subjektit të Projektit, të datës 22 maj 2017, që mund të ndryshohet herë pas here (Marrëveshje Nënkuaje).

E. Më 17 maj 2017, Banka nënshkroi një marrëveshje projekti me Subjektin e Projektit, që mund të ndryshohet herë pas here (Marrëveshje Projekti), sipas së cilës, duke marrë parasysh nënshkrimin e Marrëveshjes së Huas dhe të kësaj Marrëveshjeje nga Banka, Njësia e Projektit pranon që të realizojë Projektin, në përputhje me afatet dhe kushtet e Marrëveshjes së Projekt.

F. Sipas nenit 20.1(viii) të Marrëveshjes që krijon Bankën, Banka, Komisioni Evropian, Banka e Zhvillimit të Këshillit të Evropës dhe Banka Evropiane e Investimeve kanë krijuar Fondin e Përbashkët Evropian të Ballkanit Perëndimor (Fondit), i cila menaxhohet dhe administrohet në përputhje me kushtet e përgjithshme, të datës 7 nëntor 2006, ndryshuar më 2 tetor 2009 dhe më 16 qershor 2016 dhe që mund të ndryshohet herë pas here (Rregullat e Fondit).

G. Më 16 dhjetor 2016, Komiteti Drejtues i Kuadrit të Investimit të Ballkanit Perëndimor (WBIF) ka rënë dakord, sipas afateve dhe kushteve të Rregullave të Fondit, të japë një grant në shumën jo më shumë se 35 435 000 euro (tridhjetë e pesë milionë e katërqind e tridhjetë e pesë mijë euro) nga burimet e Fondit, sipas dhe me afatet dhe kushtet e përcaktuara në këtë Marrëveshje për të bashkëfinancuar deri në 50 për qind të kostove kapitale të Projektit dhe mbikëqyrjen e punimeve dhe mbështetjen për zbatimin e projektit, në përputhje me metodologjinë e tyre të re për mbështetjen e investimeve në infrastrukturë në Ballkanin Perëndimor. Të ardhurat nga ky grant vihen në dispozicion të Subjektit të Projektit me anë të një marrëveshjeje transferimi ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë së Përfituesit dhe Subjektit të Projektit (Marrëveshje Transferimi).

Si rrjedhojë, aktualisht palët bien dakord si më poshtë:

Neni I

Përkufizime dhe interpretim

Seksioni 1.01 Përkufizime

Fjalët dhe shprehjet me shkronja të mëdha në këtë Marrëveshje (përfshirë preambulën, pasqyrat dhe grafikët), por që nuk janë përkufizuar këtu, kur përdoren në këtë Marrëveshje kanë kuptimin që i jepet në Marrëveshjen e Huas, Marrëveshje Projekti dhe/ose Afate dhe Kushte Standarde (si edhe afatet e përcaktuara na Afatet dhe Kushtet Standarde kur janë ndryshuar në Marrëveshjen e Huas).

Sa herë që përdoren në këtë Marrëveshje (përfshirë preambula, pasqyrat dhe grafikët), përveçse nëse konteksti përcakton ndryshe, termat e mëposhtëm do të kenë kuptimet e mëposhtme:

“Marrëveshje për krijimin e Bankës” ka kuptimin që i jepet në recitalin A.

“Kontrata” janë kontratat në fuqi ose që do të nënshkruhen ndërmjet Subjektit të Projektit dhe çdo Kontraktuesi, në formë dhe përmbajtje të kënaqshme për Bankën, në lidhje me prokurimin e të mirave, punimeve dhe shërbimeve përkatëse për Projektin, përfshirë Zëra të Financuar nga Granti dhe që do të financohen tërësisht ose pjesërisht nga Financimi i Grantit.

“Kontraktues” janë kontraktuesit me imazh dhe reputacion të mirë për t’u përfshirë nga Subjekti i Projektit në lidhje me prokurimin e mallrave, punimeve dhe shërbimeve përkatëse për Projektin, përfshirë Zëra të Financuar nga Granti, ku çdo kontraktues i tillë zgjidhet në përputhje me seksionin 4.06 (Prokurimi).

“Shteti i Operimit” është anëtar i BERZH-it i përmendur në rezolutën nr. 35 të Bordit të Guvernatorëve të BERZH-it.

“Disbursim” është disbursimi i çdo pjese të Grantit herë pas here sipas seksionit 2.02 (*Disbursimet*) të kësaj Marrëveshjeje.

“Data e hyrjes në fuqi” është data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje në përputhje me seksionin 8.01 (Data e Hyrjes në Fuqi) e kësaj Marrëveshjeje.

“Subjekti i përjashtuar” është personi:

i) që ka falimentuar ose është në likuidim, marrëdhëniet e të cilit administrohen nga



gjykatat, ka nënshkruar marrëveshje me kreditorët, ka pezulluar veprimtaritë e biznesit ose është në situatë të ngjashme që lind nga një procedurë e ngjashme e parashikuar në ligjin e Vendit të Operimit;

ii) duke pasur prokurë përfaqësimi, kompetenca vendimmarrëse ose kontrolli, është dënuar për shkelje profesionale me vendim të një autoriteti kompetent që ka fuqinë *res judicata* ose ka qenë objekt i një vendimi i cili ka të njëjtën fuqi për mashtrim, korrupsion, përfshirje në një organizatë kriminale, pastrim parash ose veprimtari tjetër të paligjshme në dëm të interesave financiare të Bashkimit Evropian;

iii) që është fajtor për keqpërfaqësim në ofrimin e informacionit të kërkuar, si kusht për pjesëmarrje në një prokurim ose procedurë tjetër të rëndësishme ose nëse nuk e jep këtë informacion; ose

iv) që është objekti i një konflikti interesi.

“Fond” ka kuptimin që i jepet në Recitalin F.

“Zëra të Financuar nga Granti” janë mallra, punime dhe shërbime të lidhura me to të nevojshme për Projektin dhe që duhet të financohen nga Granti të përshkruara më tej në grafikun 2 (Zëra të financuar nga Granti) të kësaj Marrëveshjeje.

“Financimi me Grant” ka kuptimin që i jepet sipas seksionit 2.01(a) (Shuma, Monedha dhe Qëllimi) të kësaj Marrëveshjeje.

“Data e fundit e disponueshmërisë për Financimin me Grant” është data e specifikuar në seksionin 2.02(a) (Data e fundit e disponueshmërisë së Financimit të Grantit) të kësaj Marrëveshjeje.

“Marrëveshje huaje” ka kuptimin që i jepet në recitalin C.

“Financimi me Hua” është financimi i dhënë ose që do të vihet në dispozicion nga Banka për Përfituesin, në cilësinë e tij si Huamarrës, sipas Marrëveshjes së Huas dhe që do t’i nënshkruhet Subjektit të Projektit sipas kushteve të Marrëveshjes së Nënshkruarimit.

“Plan Prokurimi” është plani i prokurimit për Projektin, përfshirë Zërat e Financuar nga Granti, në formë dhe përmbajtje të kënaqshme për Bankën, prandaj si i tillë plani i prokurimit mund të ndryshohet herë pas here nga Përfituesi, përmes Njësise Projektit, me pëlqimin paraprak me shkrim të Bankës.

“Praktikë e ndaluar” ka kuptimin që i jepet në Marrëveshjen e Huas, me kusht që, për qëllime të kësaj Marrëveshjeje, ajo të përfshijë edhe vjedhjen, si një përvetësim i pronës që i përket palës tjetër.

“Projekt” ka kuptimin që i jepet në recitalin C.

“Marrëveshje Projektit” ka kuptimin që i jepet në recitalin E.

“Data e Realizimit të Projektit” është data, kur:

a) Përfituesi, përmes Subjektit të Projektit, i dorëzon Bankës një njoftim, në formë dhe përmbajtje të kënaqshme për Bankën, që vërteton realizimin e Projektit; dhe

b) Banka i ka dorëzuar Subjektit të Projektit një njoftim që konfirmon se Banka është e bindur se Projekti është realizuar.

“Njësia e Projektit” ka kuptimin që i jepet në recitalin D.

“Angazhim Rimbursimi” është angazhimi i referuar në seksionin 2.03 (Angazhime rimbursimi me Kusht dhe pa Kusht) të kësaj Marrëveshjeje dhe mund të jetë një “angazhim rimbursimi me kusht” ose një “angazhim rimbursimi pa kusht”, siç përdoren këto terma në atë seksion.

“Rregullat e Fondit” ka kuptimin që i jepet në recitalin F.

“Përfaqësuesi i Autorizuar i Përfituesit” është ministri i Financave dhe Ekonomisë i Republikës së Shqipërisë.

“Terma dhe Kushte Standarde” janë Termat dhe Kushtet Standarde të BERZH-it të datës 1 dhjetor 2012.

“Marrëveshje Nënshkruar” ka kuptimin që i jepet në recitalin D.

“Marrëveshje Transferimi” ka kuptimin që i jepet në recitalin G.

Seksioni 1.02 Interpretimi

Në këtë Marrëveshje:

a) Fjalët në njëjës përfshijnë shumësin dhe anasjelltas, përveçse kur konteksti përcakton ndryshe;

b) Titujt dhe tabela e përmbajtjes përfshihen vetëm për lehtësi reference dhe nuk ndikon në interpretimin e kësaj Marrëveshjeje;

c) Fjalët që tregojnë persona përfshijnë korporatat, partneritetet dhe persona të tjerë juridikë dhe referencat për një person përfshijnë pasuesin e tij dhe të caktuarit e lejuar; dhe



d) Referenca për një nen, seksion, grafik ose pasqyrë specifike, përveçse kur përcaktohet ndryshe në këtë Marrëveshje, interpretohet si referencë për atë nen ose seksion specifik, ose shtojcë apo pasqyrë të kësaj Marrëveshjeje.

Neni II Financimi me Grant

Seksioni 2.01 Shuma, Monedha dhe Qëllimi

a) Sipas dhe në përputhje me këtë Marrëveshje, Banka bie dakord që t'i japë Përfituesit, nga Fondi, një grant në shumën jo më shumë se 35 435 000 euro (tridhjetë e pesë milionë, katërqind e tridhjetë e pesë mijë euro) (Financimi me Grant).

b) Financimi me Grant do të përdoret vetëm për qëllimet e financimit të Zërave të Financueshëm nga Granti, që duhet të prokurohen sipas seksionit 4.06 (Prokurimi) të kësaj Marrëveshjeje.

c) Përveç sa parashikohet ndryshe sipas seksionit 6.05 (Ngjarjet e Rimbursimit) të kësaj Marrëveshjeje, Financimi me Grant nuk është i rimbursueshëm.

d) Shprehimisht pranohet dhe bihet dakord që Banka nuk do të jetë e detyruar që të bëjë një Disbursim ose pagesë tjetër sipas kësaj Marrëveshjeje, përveçse në masën që një shumë, në lidhje me dhe në vlerë të barabartë me këtë Disbursim ose pagesë është e disponueshme në Fond për këtë qëllim.

e) Përveçse kur Banka bie dakord ndryshe:

1. Zëra të Financuar nga Granti bashkëfinancohen nga Financimi me Grant dhe Financimi me Hua në raporte dhe shuma që duhet të përcaktohen në Planin e Prokurimit;

2. Shuma e Financimit të Grantit alokuar për çdo Zë të Financuar nga Granti sipas Planit të Prokurimit:

a) Në asnjë moment nuk kalon 50 për qind të vlerës së Kontratës në lidhje me Zërin e Financuar nga Granti, lidhur me kontratën e punimeve sipas numrit 1 të grafikut 2;

b) Mbulon plotësisht vlerën e Kontratës për Zërat të Financuar nga Granti, sipas numrit 2 (shërbime të mbikëqyrjes së punimeve) dhe numrit 3 (mbështetje zbatimi) të grafikut 1 dhe asnjë pjesë e të ardhurave të Financimit me Grante nuk përdoret, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, për të paguar blerjen e tokës ose

ndërtesave, në territorin e Përfituesit ose diku tjetër.

Seksioni 2.02 Disbursime

Sipas seksionit 6.01 (Pezullimi), seksionit 6.02 (Anulimi nga Banka) dhe seksionit 8.02 (Kushtet paraprake për Hyrjen në Fuqi) të kësaj Marrëveshjeje, Financimi i Grantit disbursohet nga Banka herë pas here, në një ose më shumë Disbursime, sipas dispozitave të mëposhtme:

a) Data e Fundit e Disponueshmërisë së Financimit të Grantit

E drejta e Përfituesit për të kërkuar një Disbursim në përputhje me këtë Marrëveshje bëhet efektive në Datën e Hyrjes në Fuqi dhe përfundon në momentin më të parë, të: i. të Datës së Fundit të Disponueshmërisë të Huas së Bankës për Projektin (të përshkruar në Marrëveshjen e Huas), të specifikuar në seksionin 2.02(f) (Terma të tjera Financiare të Huas) të Marrëveshjes së Huas; ose ii. 31 dhjetor 2025 ose në një datë të mëvonshme që Banka në diskrecionin e saj dhe në marrëveshje me Përfituesin, përcakton dhe i njofton Përfituesit.

b) Shpenzime të pranueshme

Disbursimet, përveçse kur Banka vendos ndryshe, bëhen për të financuar:

1. Shpenzimet e bëra (ose nëse Banka bie dakord që të bëhen) në lidhje me kostot e arsyeshme të Zërave të Financuar nga Granti; dhe

2. Shpenzimet e bëra pas datës së kësaj Marrëveshjeje.

c) Kushtet për Disbursim

Pa kufizuar përgjithësimin e këtij seksioni 2.02, çdo Disbursim sipas kësaj Marrëveshjeje, në lidhje me një ose më shumë Zëra të Financuar nga Granti, i nënshtrohet përmbushjes ose heqjes dorë në diskrecion të vetëm të Bankës, tërësisht ose pjesërisht dhe sipas kushteve ose moskushtëzimit të kushtit që në datën e kërkesës së Përfituesit për këtë Disbursim, e gjithë shuma e Financimit të Huas alokuar për të njëjtin Zë të Financuar nga Granti, sipas Planit të Prokurimit të jetë tërhequr ose kërkuar sipas kërkesës bindëse për Tërheqje, në përputhje me Marrëveshjen e Huas.

d) Kërkesë Disbursimi

1. Përfituesi mund të kërkojë një Disbursim, duke i paraqitur Bankës një kërkesë origjinale për këtë Disbursim, të nënshkruar nga Përfaqësuesi i



Autorizuar i Përfituesit ose një person i caktuar nga Përfaqësuesi i Autorizuar i Përfituesit. Çdo kërkesë Disbursimi bëhet në formën e pasqyrës 1 (Formulari i Kërkesës për Disbursim) dhe i dorëzohet Bankës të paktën pesëmbëdhjetë (15) ditë pune përpara datës së propozuar të vlerës së këtij Disbursimi. Kjo kërkesë, përveçse kur Banka vendos ndryshe, është e parevokueshme dhe e detyrueshme për Përfituesin.

2. Çdo kërkesë Disbursimi shoqërohet me dokumente dhe vërtetime të tjera të mjaftueshme në formë dhe përmbajtje bindëse për Bankën që Përfituesi ka të drejtë për shumën e Disbursimit dhe që shuma e Disbursimit do të përdoret vetëm për Zërat e Financuar nga Granti. Këto dokumente përfshijnë, por jo vetëm, faturën/faturat e Kontraktuesit, të certifikuara (nëse kërkohet nga Kontrata përkatëse) nga ose në emër të Subjektit të Projektit ose faturën aktuale, ose në formën e një vërtetimi të veçantë, që tregon konfirmimin e Subjektit të Projektit se mallrat, punimet janë ofruar në mënyrë të kënaqshme ose shërbimet janë kryer në përputhje me kërkesat e kësaj Marrëveshjeje dhe Kontratës përkatëse.

e) Monedha e Disbursimit

Disbursimi bëhet në EUR, në shumë të barabartë ose ekuivalente me shpenzimet që do të financohen nga të ardhurat e Financimit me Grant.

f) Shuma Minimale e Disbursimit

Përveç Disbursimit të fundit ose përveçse kur Banka bie dakord ndryshe, Disbursimet bëhen në shuma jo më pak se 250 000 euro (dyqind e pesëdhjetë mijë).

Seksioni 2.03 Angazhime Rimbursimi me Kusht dhe pa Kusht

a) Me kërkesë të Përfituesit, në formën dhe përmbajtjen e kënaqshme për Bankën, Banka, në përputhje me dispozitat e zbatueshme të manualit të BERZH-it për Disbursim *mutatis mutandis* mund të nxjerrë Angazhime Rimbursimi, me Kusht ose pa Kusht, për të rimbursuar pagesat e bëra nga bankat sipas letërkredive në lidhje me shpenzimet që do të financohen nga Financimi me Grante. Çdo rimbursim i tillë përbën një Disbursim.

b) Në rast të një Angazhimi Rimbursimi me Kusht, detyrimi i Bankës për të paguar pezullohet ose ndërpritet menjëherë me

pezullimin ose anulimin e financimit me Grant nga Banka, sipas seksionit 6.01 (Pezullimi) ose seksionit 6.02 (Anulimi nga Banka) të kësaj Marrëveshjeje.

c) Në rast të një angazhimi rimbursimi pa kusht, detyrimi i Bankës për të paguar nuk ndikohet nga ndonjë pezullim ose anulim pasues i Financimit me Grant.

Seksioni 2.04 Rialokimi

Përfituesi mund t'i kërkojë Bankës që të rialokojë shumat e alokuara për çdo zë të Zërave të Financuar nga Granti të renditura në grafikun 2 të kësaj Marrëveshjeje me kusht që ky rialokim të jetë në përputhje me Rregullat e Fondit. Banka mund të miratojë kërkesën e rialokimit, duke njoftuar Përfituesin. Ky rialokim bëhet efektiv pasi Banka dhe Përfituesi lidhin marrëveshje ndryshimi që dokumenton këtë rialokim dhe pas realizimit të procedurave të brendshme sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Seksion 2.05 Anulimi nga Përfituesi

Përfituesi mund të anulojë në çdo kohë, jo më pak se tridhjetë (30) ditë pune para njoftimit me shkrim të Bankës, pjesërisht ose plotësisht, çdo pjesë të Financimit të Grantit të padisbursuar. Çdo njoftim i tillë anulimi nga Përfituesi është i parevokueshëm dhe i detyrueshëm për Përfituesin.

Seksioni 2.06 Pagesat

a) Përveçse kur Banka bie dakord ndryshe, shumat që duhet të disbursohen nga Banka, sipas kësaj Marrëveshjeje paguhen direkt në llogarinë e Kontraktuesit përkatës të përcaktuar nga Përfituesi në kërkesën e tij për Disbursim.

b) Nëse afati për një pagesë sipas kësaj Marrëveshjeje bie në një ditë që nuk është Ditë Pune, atëherë kjo pagesë bëhet e pagueshme ditën pasuese të punës.

c) Çdo shumë që mund të bëhet e detyrueshme për t'u derdhur në Bankë sipas kësaj Marrëveshjeje paguhet, pa kompensim ose kundërpretendim në euro, për vlerën në datën e pagesës, në llogarinë në Londër, Angli ose vend tjetër që Banka, herë pas herë, mund të përcaktojë duke njoftuar Përfituesin.

Neni III

Deklarata dhe garanci

Seksioni 3.01 Deklarata

Përfituesi garanton dhe deklaron sa më poshtë:



1. As Përfituesi, as ndonjë nëpunës, drejtor, punonjës i autorizuar, filial, agjent ose përfaqësues i Subjektit të Projektit, nuk konsiderohet të jetë ose se është një Subjekt i Përgjithshëm ose është angazhuar apo përfshirë në ndonjë Praktikë të Ndaluar në lidhje me Projektin ose ndonjë transaksion të përcaktuar nga kjo Marrëveshje; dhe

2. Kjo Marrëveshje përbën detyrime të vlefshme dhe të detyrueshme me ligj të Përfituesit, të zbatueshme në përputhje me termat përkatës të saj.

Seksioni 3.02 Pranimit dhe përsëritja

a) Përfituesi pranon që ka bërë deklaratat dhe garancitë në seksionin 3.01 (Deklarata) të kësaj Marrëveshjeje, me synim që të nxisë Bankën të lidhë këtë Marrëveshje dhe të japë Financimin e Grantit dhe që Banka ka lidhur këtë Marrëveshje, në bazë dhe në mbështetje të plotë të çdo deklarate dhe garancie të tillë. Përfituesi garanton që nuk ka dijeni për ndonjë fakt shtesë ose çështje, fshehja e të cilave bën çorientues ndonjë nga këto deklarata dhe garanci.

b) Deklaratat dhe garancitë e parashikuara në këtë nen III (Deklarata dhe Garanci) konsiderohen të përsëritura me paraqitjen e çdo kërkesë Disbursimi dhe në çdo datë Disbursimi.

Neni IV

Zbatimi i projektit

Seksioni 4.01 Bashkëpunimi dhe informacioni

a) Dispozitat e seksionit 4.01 (Bashkëpunimi dhe Informacioni) të Afateve dhe Kushteve Standarde zbatohen si të paraqitura plotësisht këtu *mutatis mutandis*, pa cenuar përgjithësimin e tyre, sikur:

i. referencat për “Huamarrësin” dhe “Garantuesin” lexohen si të ishin referenca për “Përfituesin”;

ii. referenca për “Huan” lexohet si të ishte referencë për “Financimi i Grantit”; dhe

iii. referencat për “Marrëveshje Huaje” dhe “Marrëveshje Projekt” lexohen si të ishin referenca për “këtë Marrëveshje”.

b) Banka, kur merr informacion sipas Marrëveshjes së Huas dhe Marrëveshjes së Projektit, mund ta përdorë dhe të mbështetet në këtë informacion në cilësinë e saj si ofruese e Financimit të Grantit, sipas kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 4.02 Përgjegjësitë në lidhje me Zbatimin e Projektit

a) Përfituesi, përveçse kur Banka bie dakord ndryshe, merr të gjitha masat e nevojshme që të sigurohet se Njësia e Projektit:

1. Realizon projektin me kujdesin e duhur dhe efikasitet dhe në përputhje me Marrëveshjen e Projektit dhe këtë Marrëveshje;

2. Realizon Projektin në përputhje me Planin e Prokurimit, sipas çdo ndryshimi për të cilin Banka bie dakord me shkrim;

3. Realizon Projektin në përputhje me Planin e Veprimit Mjedisor dhe Social dhe Kërkesat e Përcaktuara të Performancës;

4. Mundëson që Data e Realizimit të Projektit të jetë jo më vonë se 31 dhjetori 2020; dhe

5. Merr të gjitha masat e nevojshme që të mundësojë realizimin e suksesshëm të Projektit.

b) Dispozitat e seksionit 4.02 (Përgjegjësitë në Lidhje me zbatimin e Projektit) të Afateve dhe Kushteve Standarde zbatohen si të ishin përcaktuar këtu plotësisht *mutatis mutandis*, pa cenuar përgjithësimin e tyre, sikur:

i. referenca për “Huamarrësin” lexohet si të ishte referencë për “Përfituesin”; dhe

ii. referenca për “të ardhurat e Huas” lexohet si të ishte referencë për “të ardhurat e Financimit të Grantit”.

Seksioni 4.03 Përputhshmëria Mjedisore dhe Sociale

Përfituesi, përveçse kur Banka bie dakord ndryshe sigurohet që Subjekti i Projektit të kryejë pjesën e Projektit të financuar nga Financimi i Grantit në përputhje me seksionin 2.05 (Marrëveshje të Përputhshmërisë Mjedisore dhe Sociale) të Marrëveshjes së Projektit.

Seksioni 4.04 Detyrimet Mbështetëse të Përfituesit

a) Përfituesi nuk ndërmerr asnjë veprim, as nuk lejon ndonjë nga agjentët ose filialet e tij që të marrin ndonjë veprim, që do të parandalonte ose ndërhynte në zbatimin e Projektit ose në funksionimin efikas të pajisjeve të Projektit ose në përmbushjen e detyrimeve të Përfituesit, sipas kësaj Marrëveshjeje. Përfituesi, gjithashtu, sigurohet që asnjë veprim të mos merret ose të mos lejohet që të merret nga ndonjë prej nënndarjeve administrative apo politike ose ndonjë subjekti në pronësi dhe të kontrolluar prej tij, ose që vepron për llogari ose përfitim të Përfituesit ose këtyre nënndarjeve.



b) Përfituesi, përveçse kur Banka bie dakord ndryshe:

1. Përmbush rregullisht të gjitha detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje dhe sipas Marrëveshjes së Huas;

2. Mbështet, nëpërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Subjektin e Projektit për përmbushjen e detyrimeve të tij në lidhje me Projektin, duke marrë të gjitha masat ligjore, rregullatore ose masa të tjera të nevojshme ose të dëshirueshme dhe, duke alokuar dhe dhënë, ose ndikuar në dhënien e fondeve dhe mbështetjes për Subjektin e Projektit, ashtu siç dhe kur nevojitet nga Subjekti i Projektit për të realizuar Projektin; dhe

3. Ekzekuton çdo dokument tjetër dhe të marrë çdo masë tjetër që Banka përcakton se është e nevojshme ose e dëshirueshme për të zbatuar këtë Marrëveshje.

Seksioni 4.05. Njësia e Zbatimit të Projektit

Përfituesi siguron që Subjekti i Projektit të garantojë që veprimtaritë dhe përgjegjësitë e NJZP-së, të përmendur në seksionin 2.03 (Njësia e Zbatimit të Projektit) të Marrëveshjes së Projektit, të përfshijnë prokurimin e Zërave të Financuar nga Granti dhe realizimin e Financimit të Grantit.

Seksioni 4.06 Prokurimi

a) Prokurimi i të gjithë Zërave të Financuar nga Granti, përveçse kur Banka bie dakord ndryshe, rregullohet nga Rregullorja e BERZH-it për Prokurimet. Zërat e Financuar nga Granti prokurohen me tender të hapur, siç përcaktohet në kapitullin 3 të Rregullores së BERZH-it për Prokurimin.

b) Të gjitha Kontratat u nënshtrohen procedurave paraprahe të rishikimit të përcaktuara në Rregulloren e BERZH-it për Prokurimin.

Seksioni 4.07. Kualifikimi i Kontraktuesit

Përfituesi nuk aplikon për një Disbursim nëse Përfituesi, përmes Subjektit të Projektit, ka vendosur kufizime kualifikimi ose origjine për shpalljen fituese të Kontratës specifike që do të financohet nga ky Disbursim ose kjo Kontratë i është dhënë ofruesit, kontraktuesit ose konsulentit ose një nënofruesi, nënkontraktuesi ose nënkonsulenti që konsiderohet të jetë ose është një Subjekt i Përfshirë, ose është përfshirë në listën e personave ose subjekteve të

BERZH-it që nuk kualifikohen për të fituar një kontratë të financuar nga BERZH-i ,ose për financim nga BERZH, listë kjo që mund të merret nga faqja e internetit të BERZH-it.

Seksioni 4.08 Kontratat

a) Subjekti i Projektit i jep Bankës kopje të noterizuara të të gjitha kopjeve origjinale të Kontratave jo më vonë se dhjetë (10) ditë nga data e tyre.

b) Subjekti i Projektit sigurohet që të gjitha Kontratat të përfshijnë dispozita bindëse për Bankën të cilat kërkojnë që një Kontraktues dhe nënkontraktuesit e tyre: i. të mos përfshihen në ndonjë Praktikë të Ndaluar; dhe ii. të njoftojnë menjëherë Subjektin e Projektit nëse konsiderohet se janë ose janë bërë një Subjekt i Përfshirë.

c) Banka, me të shpallur Kontratën fituese, mund të publikojë një përshtypim të saj, emrin dhe shtetësinë e Kontraktuesit dhe çmimin e kontratës.

Seksioni 4.09 Evidenca dhe Raporte të Projektit; Ekzaminime

a) Përfituesi garanton që Subjekti i Projektit të sigurohet që informacioni që Subjekti i Projektit i jep Bankës dhe evidencat e mbajtura nga Subjekti i Projektit, në përputhje me detyrimet e Subjektit të Projektit sipas seksionit 2.07 (Shpeshësia e Raportimit dhe Kërkesat e Paraqitjes) të Marrëveshjes së Projektit, si edhe seksionit 4.04 (Evidencat dhe Raportet e Projektit) dhe seksionit 5.02 (Raportimi) të Kushteve dhe Afateve Standarde:

1. Të përfshijnë informacion të hollësishëm në lidhje me Kontratën, Kontraktuesit, Disbursimet, Financimin e Grantit dhe përdorimin e tij, Zërat e Financuar nga Granti, si edhe statusin e përputhshmërisë me secilën marrëveshje që përfshihet në këtë Marrëveshje, në formë dhe përmbajtje të kënaqshme për Bankën;

2. Të përmbajnë informacion të mjaftueshëm për të mundësuar gjurmimin e Financimit të Grantit të dallueshëm nga Financimi i Huas; dhe

3. Të përfshijnë informacion tjetër në lidhje me *inter alia* Subjektin e Projektit, Projektin dhe transaksione të përcaktuara në këtë Marrëveshje, siç mund të kërkohej në mënyrë të arsyeshme nga Banka, herë pas here.

b) Përfituesi, sapo të jetë e mundur, por në çdo rast, brenda tridhjetë (30) ditëve pas realizimit të Kontratës së fundit, i kërkon



Subjektit të Projektit që të paraqesë në Bankë (nëse kërkohet nga Banka, certifikuar nga Përfaqësuesi i Autorizuar i Përfituesit) një raport përfundimtar në lidhje me përdorimin e Financimit të Grantit, i cili specifikon me detaje të gjitha Kontratat, Kontraktuesit, Zërat e Financuar nga Granti dhe grafikun e livrimit dhe ndërtimit dhe krahasimin kundrejt parashikimit origjinal.

c) Përfituesi, sapo të jetë e mundur, por në çdo rast, brenda tridhjetë (30) ditëve pas realizimit të Kontratës së fundit, i kërkon Subjektit të Projektit që të paraqesë në Bankë (nëse kërkohet nga Banka, certifikuar nga Përfaqësuesi i Autorizuar i Përfituesit) një raport përfundimtar në lidhje me Projektin, ku identifikon përdorimin e Financimit të Grantit.

d) Përfituesi i kërkon Subjektit të Projektit që të bëjë të mundur që Banka dhe përfaqësuesit e saj, me kërkesë të Bankës:

1. Të vizitojnë çdo ambient dhe vend punimi të ndërtimit në lidhje me Projektin;

2. Të ekzaminojë çdo dhe të gjitha mallrat, punimet dhe shërbimet e financuara me të ardhurat e Financimit të Grantit dhe çdo kantier, instalim, vend punimi, punime, ndërtesa, prona, pajisje, evidenca dhe dokumente të rëndësishme për përmbushjen e detyrimeve të Përfituesit sipas kësaj Marrëveshjeje; dhe

3. Për këto qëllime, të takojnë dhe të zhvillojnë diskutime me përfaqësues dhe punonjës të Subjektit të Projektit që Banka mund të konsiderojë të nevojshëm dhe të duhur.

e) Përfituesi ka akses dhe i kërkon Subjektit të Projektit që të sigurojë aksesin e Bankës dhe përfaqësuesve të saj në librat e llogarive dhe evidencat e Subjektit të Projektit në lidhje me Projektin dhe Financimin me Grante.

Seksioni 4.10 Sigurimi

Përfituesi, përmes Subjektit të Projektit, sigurohet që Zërat e Financuar nga Granti, të sigurohen si duhet në çdo kohë kundër të gjitha rreziqeve për humbje ose dëm (përfshirë, por jo vetëm rrezikun apo dëmin nga një tërmet), të mundshëm për blerjen, transportin dhe livrimin e tyre në vendin e përdorimit ose të instalimit, dhe sipas rastit kundër rreziqeve gjatë periudhës së ndërtimit, të gjitha në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare për sigurimin e ndërtimit.

Neni V

Marrëveshje financiare dhe operacionale

Seksioni 5.01 Evidenca dhe Raporte Financiare

a) Përfituesi mban dhe i kërkon Subjektit të Projektit që të mbajë evidenca dhe llogari të veçanta në lidhje me Financimin e Grantit, në përputhje me standardet e llogarive të pranueshme për Bankën dhe të zbatueshme në vazhdimësi.

b) Përfituesi garanton dhe i kërkon Subjektit të Projektit të sigurohet, që informacioni që Subjekti i Projektit i jep Bankës dhe evidencat e mbajtura nga Subjekti i Projektit, në përputhje me detyrimet e Subjektit të Projektit sipas seksionit 3.01 (Evidenca dhe Raporte Financiare) të Marrëveshjes së Projektit si edhe sipas seksionit 5.02(c)(i) (Raportimi) të Kushteve dhe Afateve Standarde:

1. Të përfshijnë informacion të detajuar në lidhje me Financimin e Grantit dhe përdorimin e tij, në formë dhe përmbajtje të kënaqshme për Bankën;

2. Të përmbajnë informacion të mjaftueshëm për të mundësuar gjurmimin e Financimit të Grantit të dallueshëm nga Financimi i Huas; dhe

3. Të përfshijnë informacion tjetër në lidhje me evidencat, llogaritë dhe pasqyrat financiare siç mund të kërkohet në mënyrë të arsyeshme nga Banka, herë pas here.

c) Përfituesi i kërkon Subjektit të Projektit që, të paktën pesë (5) vjet pas Datës së Realizimit të Projektit:

1. Të mbajë dokumente dhe regjistra të llogarive financiare në lidhje me veprimtaritë e financuara nga Financimi i Grantit; dhe

2. Të vendosë në dispozicion të Bankës, me kërkesë, të gjithë informacionin financiar të rëndësishëm, përfshirë pasqyra të llogarive, në lidhje me Projektin.

Seksioni 5.02 Kryerja e punës dhe veprimtarisë

Përfituesi, përveçse kur Banka bie dakord ndryshe, merr të gjitha masat e nevojshme që të sigurohet se Subjekti i Projektit:

a) Përmbush rregullisht të gjitha detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje dhe Marrëveshjes së Projektit;

b) Nuk shet, jep me qira apo shkatërron ndonjë nga asetet e tij thelbësore që janë të nevojshme për të kryer me efikasitet veprimtarinë e tij ose shkatërrimi i të cilave mund të cenojë aftësinë për të përmbushur në mënyrë



të kënaqshme detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje;

c) Nuk bën ndryshime ose lejon bërjen e ndryshimeve në Statutet e tij nëse këto ndryshime nuk janë në përputhje me ndonjë dispozitë të kësaj Marrëveshjeje ose mund të pengojnë aftësinë e Subjektit të Projektit për të respektuar afatet e kësaj Marrëveshjeje; dhe

d) Ekzekuton çdo dokument tjetër dhe të marrë çdo masë tjetër që Banka përcakton se është e nevojshme ose e dëshirueshme për të zbatuar këtë Marrëveshje.

Seksioni 5.03 Dhënia e informacionit

a) Përfituesi njofton menjëherë Bankën nëse Përfituesi ka marrë informacion në lidhje me një shkelje të seksionit 3.01(a) (Deklarata dhe Garanci) ose seksionit 5.06 (Mashtrimi dhe Korrupsioni) të kësaj Marrëveshjeje. Nëse Banka njofton Përfituesi për shqetësimin e saj se ka pasur shkelje të seksionit 3.01(a) (Deklarata) ose seksionit 5.06 (Mashtrimi dhe Korrupsioni) të kësaj Marrëveshjeje, Përfituesi bashkëpunon në mirëbesim me Bankën dhe përfaqësuesin e saj për të përcaktuar nëse kjo shkelje ka ndodhur dhe reagon menjëherë dhe me hollësi të arsyeshme ndaj këtij njoftimi nga Banka dhe jep mbështetjen dokumentuese për këtë reagim me kërkesë të Bankës.

b) Përfituesi, përmes Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe/ose Subjektit të Projektit, njofton menjëherë Bankën nëse Përfituesi konsideron ose vihet në dijeni që një Kontraktues mendohet të jetë ose është bërë një Subjekt i Përrjashtuar. Përfituesi sigurohet që detyrimi i parashtruar në seksionin 5.03(b) t'u transferohet të gjithë Kontraktuesve dhe nënkontraktuesve të caktuar nga Subjekti i Projektit për realizimin e Projektit.

c) Përfituesi njofton menjëherë Bankën nëse Përfituesi konsideron ose vihet në dijeni që një ngjarje ka ndodhur ose mund të ndodhë dhe që do të ndikojë ose do të vonojë zbatimin e pjesës së Projektit të financuar nga Financimi i Grantit në çdo drejtim të rëndësishëm.

d) Përfituesi, përmes Subjektit të Projektit, i jep menjëherë Bankës informacion tjetër që Banka mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme herë pas here dhe lehtëson çdo verifikim, mision vlerësimi dhe hetim (përfshirë kontrolle në terren) në lidhje me zbatimin e Projektit.

Seksioni 5.04 Taksat

a) Përfituesi i kërkon Subjektit të Projektit që të paguajë, kur është afati, të gjitha taksat që vendosen ndaj tij dhe të pagueshme për, ose në lidhje me, ekzekutimin, lëshimin, dorëzimin, regjistrimin ose noterizimin e kësaj Marrëveshjeje (përfshirë dhënien e Financimit të Grantit) ose çdo dokument tjetër në lidhje me këtë Marrëveshje.

b) Asnjë pjesë e të ardhurave të Financimit të Grantit nuk përdoret, direkt apo jo, për të paguar ndonjë taksë, të drejtpërdrejtë apo jo, në territorin e Përfituesit apo tjetërkund.

Seksioni 5.05. Vizibiliteti

a) Përfituesi, vetë dhe sipas rastit, merr të gjitha masat e nevojshme që të sigurohet se Subjekti i Projektit do të marrë të gjitha masat e duhura për të publikuar në publikime përkatëse, komunikime, materiale promocionale, si edhe media, faktin që Projekti është financiar, *inter alia*, nga Fondi.

b) Përfituesi, përmes Subjektit të Projektit, sigurohet që çdo raport specifik ose dokument tjetër, i përgatitur në lidhje me Projektin, të ketë formulimin e mëposhtëm: “Ky dokument është prodhuar me asistencën financiare të Fondit të Përbashkët Evropian të Ballkanit Perëndimor në Kuadrin e Investimeve të Ballkanit Perëndimor. Pikëpamjet e shprehura në të janë vetëm të autorit (emri i autorit) dhe prandaj në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se ato përcjellin mendimin zyrtar të Kontribuesve në Fondin e Përbashkët Evropian të Ballkanit Perëndimor ose të BERZH-it apo të BEI-t, si bashkëdrejtues të Fondit të Përbashkët Evropian të Ballkanit Evropian.”.

c) Përfituesi sigurohet që Subjekti i Projektit të bashkëpunojë plotësisht në mirëbesim me Bankën dhe të marrë të gjitha masat e duhura për të rëna dakord për të plan komunikimi në formë dhe përmbajtje të kënaqshme për Bankën.

Seksioni 5.06. Mashtrimi dhe korrupsioni

Përfituesi vetë nuk përfshihet në ndonjë Praktikë të Ndalar në lidhje me Projektin, Financimin e Grantit apo ndonjë transaksion të përcaktuar nga kjo Marrëveshje dhe nuk autorizon apo lejon ndonjë nga nëpunësit, drejtorët, punonjësit e autorizuar, agjentët ose përfaqësuesit e tij që të përfshihen në ndonjë Praktikë të Ndalar në lidhje me Projektin,



Financimin e Grantit apo ndonjë transaksion të përcaktuar nga kjo Marrëveshje dhe sigurohet që Subjekti i Projektit të mos përfshihet në ndonjë Praktikë të Ndalar në lidhje me Projektin, Financimin e Grantit apo ndonjë transaksion të përcaktuar nga kjo Marrëveshje.

Neni VI

Pezullimi dhe anulimi; rimbursimi

Seksioni 6.01 Pezullimi

a) Banka, nëse ka ndodhur dhe vazhdon të ndodhë ndonjë nga ngjarjet e mëposhtme, duke njoftuar Përfituesin, pezullon plotësisht ose pjesërisht, të drejtën e Përfituesit për çdo Disbursim tjetër, sipas kësaj Marrëveshjeje:

1. Ndonjëra prej: Marrëveshje Huaje, Marrëveshje Projekti, Marrëveshje Nënhuaje apo Marrëveshje Transferimi, pushon së qeni në fuqi ose zgjidhet;

2. Përfituesi ose Subjekti i Projektit nuk ka përmbushur ose nuk përmbush detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje, Marrëveshjes së Nënhuas, Marrëveshjes së Transferimit, Marrëveshjes së Huas ose Marrëveshjes së Projektit.

3. Financimi alternativ provohet se është siguruar për financimin e Projektit, duke çuar kështu në financimin e dyfishtë (tërësisht ose pjesërisht);

4. Banka ka pezulluar ose ka ndodhur një ngjarje që i jep Bankës të drejtën që të pezullojë, plotësisht ose pjesërisht, të drejtën e Përfituesit në cilësinë e tij si Huamarrës sipas Marrëveshjes së Huas që të bëjë kërkesa për Tërheqje, sipas seksionit 7.01 (Pezullimi) të Afateve dhe Kushteve Standarde ose seksionit 4.01 (Pezullimi) të Marrëveshjes së Huas;

5. Banka ka anuluar ose ka ndodhur një ngjarje që i jep Bankës të drejtën të anulojë, tërësisht ose pjesërisht, Financimin e Huas, sipas seksionit 7.02 (Anulimi nga Banka) të Afateve dhe Kushteve Standarde;

6. Ka ndodhur ose vazhdon të ndodhë një ngjarje e specifikuar në seksionin 7.06 (Ngjarjet e Përshpejtimit) të Afateve dhe Kushteve Standarde ose në seksionin 4.02 (Përshpejtimi i Maturimit) të Marrëveshjes së Huas dhe Banka ka deklaruar që i gjithë ose një pjesë e Financimit të Huas detyrohet dhe është i pagueshëm sipas seksionit 7.06 (Ngjarjet e Përshpejtimit) të Afateve dhe Kushteve Standarde;

7. Një situatë e jashtëzakonshme ka lindur si pasojë e ngjarjeve që kanë ndodhur, e cila bën të pamundur realizimin e Projektit ose Përfituesi apo Subjekti i Projektit nuk janë në gjendje të përmbushin detyrimet e tyre sipas kësaj Marrëveshjeje;

8. Një deklaratë e bërë nga Subjekti i Projektit ose Përfituesi në lidhje me këtë Marrëveshje ka qenë e pasaktë ose çorientuese në çdo drejtim të rëndësishëm;

9. Statutet e Subjektit të Projektit janë ndryshuar, pezulluar, shfuqizuar, revokuar ose anuluar në mënyrë të tillë që ndikon në masë të konsiderueshme dhe negative në veprimtaritë ose gjendjen financiare të Subjektit të Projektit ose aftësinë e tij për të kryer Projektin ose për të përmbushur detyrimet e tij sipas Marrëveshjes së Projektit;

10. Përfituesi, në cilësinë e tij si Huamarrës sipas Kontratës së Huas, ka anuluar tërësisht ose pjesërisht çdo pjesë të padisbursuar të Financimit të Huas sipas seksionit 3.08 (Anulimi) të Afateve dhe Kushteve Standarde;

11. Fondi ka përfunduar sipas Rregullave të Fondit;

12. Përfituesi, Subjekti i Projektit, një Kontraktues ose ndonjë nga nëpunësit, punonjësit, agentët apo përfaqësuesit e tyre janë gjetur të përfshirë në ndonjë Praktikë të Ndalar përmes një procesi gjyqësor ose hetimi tjetër zyrtar;

13. Kuadri ligjor dhe rregullator i zbatueshëm për sektorin e transportit në territorin e Përfituesit ka ndryshuar, është pezulluar, shfuqizuar, anuluar në mënyrë të tillë që ndikon në masë të konsiderueshme dhe negative në veprimtaritë ose gjendjen financiare të Subjektit të Projektit, për të përmbushur detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje;

14. Ka ndodhur një ngjarje ose ka mundësi të ndodhë një ngjarje, që në opinionin e arsyeshëm të Bankës, ka mundësi të ndikojë ose të vonojë zbatimin e pjesës së Projektit të financuar nga Financimi me Grante në drejtim të konsiderueshëm;

15. Nëse është bërë e paligjshme në çdo juridiksion që Banka të bëjë, mbajë ose financojë Grantin ose të përmbushë ndonjë nga detyrimet e saj sipas kësaj Marrëveshjeje; ose



16. Banka ka përcaktuar që Përfituesi, Subjekti i Projektit ose një Kontraktues është ose është bërë një Subjekt i Përfshirë.

b) E drejta e Përfituesit për çdo Disbursim të mëtejshëm vazhdon të pezullohet plotësisht ose pjesërisht, sipas rastit, deri kur ngjarja apo ngjarjet që kanë çuar në pezullim të pushojnë së ekzistuari, përveçse kur Banka njofton Përfituesin që është rivendosur e drejta për Disbursime të mëtejshme; megjithatë, me kusht që e drejta për Disbursime të mëtejshme të rivendoset vetëm në masën që dhe sipas kushteve të specifikuara në këtë njoftim dhe asnjë njoftim i tillë të mos ndikojë ose cenojë ndonjë të drejtë, kompetencë apo mjet juridik të Bankës, në lidhje me ndonjë ngjarje tjetër pasuese të përshkruar në këtë seksion.

c) Për qëllim të pikës 4 në paragrafin “a” më sipër, seksioni 7.01(a)(xv) i Afateve dhe Kushteve Standarde ndryshon si më poshtë: “Banka ka pezulluar ose përndryshe ka modifikuar aksesin në burimet e Bankës nga Anëtari sipas një vendimi të Bordit të Guvernatorëve të Bankës”.

Seksion 6.02 Anulimi nga Banka

a) Nëse në çdo kohë Banka vendos që, pas konsultimit me Përfituesin, një shumë e Financimit të Grantit nuk do të kërkohej për të financuar kostot e Projektit që do të financohet nga Granti, Banka, pasi njofton Përfituesin, e anulon këtë shumë të Grantit. Në Datën e Fundit të Disponueshmërisë së Financimit të Grantit, çdo pjesë e pa disbursuar e Financimit të Grantit anulohet automatikisht, përveçse kur Banka bie dakord ndryshe.

b) Nëse e drejta e Përfituesit për Disbursimin e një pjese të Financimit të Grantit sipas kësaj Marrëveshjeje pezullohet sipas Seksionit 6.01 (Pezullimi) të kësaj Marrëveshjeje për një periudhë të vazhdueshme prej tridhjetë (30) ditësh, Banka, pas njoftimit të Përfituesit, mund të anulojë Financimin e Grantit, plotësisht ose pjesërisht.

c) Nëse Banka ka anuluar ose ka ndodhur një ngjarje që i jep Bankës të drejtën të anulojë, plotësisht ose pjesërisht Financimin e Huas, sipas seksionit 7.02 (Anulimi nga Banka) të Afateve dhe Kushteve Standarde, Banka, pas njoftimit të Përfituesit, mund të anulojë Financimin e Grantit, plotësisht ose pjesërisht.

d) Nëse Banka, në çdo moment, konstaton që:

1. Prokurimi i një Zëri të Financuar nga Granti nuk është në përputhje me këtë Marrëveshje;

2. Fondet e disbursuara sipas kësaj Marrëveshjeje janë përdorur për qëllime të ndryshme nga ato të parashikuara sipas kësaj Marrëveshjeje; ose

3. Në lidhje me një Kontratë, një përfaqësues i Përfituesit, Subjekti i Projektit ose një Kontraktues, janë përfshirë në një Praktikë të Ndalar gjatë prokurimit ose ekzekutimit të kësaj Kontrate, ndërsa Përfituesi apo Subjekti i Projektit nuk kanë marrë masa në kohë dhe të duhura bindëse për Bankën për të rregulluar situatën;

Banka, pas njoftimit të Përfituesit, mund të anulojë Financimin e Grantit plotësisht ose pjesërisht. Ky anulim hyn në fuqi kur jepet njoftimi.

e) Nëse Banka, në çdo moment konstaton që një përfaqësues i Përfituesit, Subjekti i Projektit ose një Kontraktues është gjetur i përfshirë në një Praktikë të Ndalar, për një procesi gjyqësor ose hetimi tjetër zyrtar, Banka, pas njoftimit të Përfituesit, mund të anulojë Financimin e Grantit plotësisht ose pjesërisht. Ky anulim hyn në fuqi kur jepet njoftimi.

Seksioni 6.03. Angazhime Rimbursimi pa Kusht të pandikuara nga Pezullimi ose Anulimi

Asnjë anulim ose pezullim nuk zbatohet për shumatat që i nënshtrohen një Angazhimi Rimbursimi pa Kusht, të nënshkruar nga Banka sipas seksionit 2.03 (Angazhime Rimbursimi me Kusht dhe pa Kusht) të kësaj Marrëveshjeje, përveçse kur ku Angazhim parashikon shprehimisht ndryshe.

Seksioni 6.04 Detyrimet e Përfituesit

Pavarësisht ndonjë anulimi apo pezullimi, të gjitha dispozitat e kësaj Marrëveshjeje vazhdojnë të jenë në fuqi, përveç rasteve të parashikuara ndryshe në mënyrë specifike.

Seksioni 6.05 Ngjarjet e rimbursimit

Nëse ndonjë nga ngjarjet e mëposhtme ndodh dhe, sipas rastit, vazhdon të ndodhë për periudhën e specifikuar më poshtë, atëherë në çdo kohë gjatë vazhdimësisë së asaj ngjarjeje Banka, pas njoftimit të Përfituesit, mund të kërkojë që Përfituesi të rimbursojë të gjithë ose një pjesë të Financimit të Grantit (dhe të paguajë çdo shumë tjetër të pagueshme sipas kësaj Marrëveshjeje) dhe po kjo do të bëhet (gjithçka në këtë Marrëveshje përkundrazi) e detyrueshme dhe e pagueshme menjëherë:



a) Ka ndodhur një ngjarje e specifikuar në seksionin 6.01(a)(1) (Pezullimi) të kësaj Marrëveshjeje.

b) Ka ndodhur dhe, nëse mund të rregullohet, ka vazhduar të ndodhë një ngjarje e specifikuar në seksionin 6.01(a)(2) (Pezullimi) të kësaj Marrëveshjeje për një periudhë tridhjetëditore (30-ditore), pasi Banka të ketë dhënë njoftim në lidhje me atë.

c) Ka ndodhur ose ka vazhduar të ndodhë një Ngjarje Përshpejtimi e specifikuar në Afatet dhe Kushtet Standarde dhe në Marrëveshjen e Huas dhe Banka ka deklaruar që i gjithë ose një pjesë e Financimit të Huas të jetë i detyrueshëm dhe i pagueshëm sipas seksionit 7.06 (Ngjarjet e Përshpejtimit) të Afateve dhe Kushteve Standarde.

d) Nëse Banka, në çdo moment konstaton që një përfaqësues i Përfituesit, Subjekti i Projektit ose një Kontraktues është gjetur i përfshirë në një Praktikë të Ndalar, përmes një procesi gjyqësor ose hetimi tjetër zyrtar, në lidhje me zbatimin e Projektit, me kusht që shuma e grantit që duhet të rimbursohet të jetë ajo pjesë e grantit që përdorur për këtë Praktikë të Ndalar.

e) Përfituesi në cilësinë e tij si Huamarrës sipas Marrëveshjes së Huas ka anuluar plotësisht ose pjesërisht një pjesë të padisbursuar të Financimit të Huas sipas seksionit 3.08 (Anulimi) të Afateve dhe Kushteve Standarde.

f) Fondi është paguar në mënyrë të parregullt ose është përdorur në mënyrë të gabuar nga Përfituesi ose Kontraktuesi, me kusht që shuma që duhet të rimbursohet është ajo pjesë e grantit që është përdorur në mënyrë të parregullt ose të gabuar.

Neni VII

Zbatueshmëria, zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Seksioni 7.01 Zbatueshmëria

Të drejtat dhe detyrimet e Përfituesit janë të vlefshme dhe të zbatueshme në përputhje me kushtet e tyre pavarësisht legjislacionit vendës që parashikon ndryshe. Përfituesi nuk ka të drejtë në asnjë rrethanë që të pretendojë se një dispozitë e kësaj Marrëveshjeje është e pavlefshme ose e pazbatueshme për ndonjë arsye.

Seksioni 7.02. Mosushtrimi i të drejtave

Asnjë vonesë në ushtrimin apo mosushtrimin e një të drejte, kompetence apo mjeti juridik, që i

lind secilës palë sipas kësaj Marrëveshjeje për shkak të një mospërmbushjeje nuk pengon këtë të drejtë, kompetencë ose mjet juridik ose nuk interpretohet si një heqje dore prej saj ose një pranim i heshtur i kësaj mospërmbushjeje; as veprimi i një pale të tillë në lidhje me këtë mospërmbushje apo pranimi në heshtje i kësaj mospërmbushjeje, nuk ndikon ose pengon të drejtën, kompetencën apo mjetin juridik të kësaj pale në lidhje me çdo mospërmbushje tjetër pasuese.

Seksioni 7.03. Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Dispozitat e seksionit 8.04 (Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve) të Afateve dhe Kushteve Standarde zbatohen si të përcaktuara këtu plotësisht *mutatis mutandis*, përveç:

i. Seksionit 8.04(b)(iii) të Afateve dhe Kushteve Standarde që për qëllim të kësaj Marrëveshjeje, ndryshon që të lexojë si më poshtë: “iii. Kur Sekretari i Përgjithshëm i Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit duhet të emërojë një arbitër, Sekretar i Përgjithshëm i Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit ka lirinë të zgjedhë çdo person që ai/ajo konsideron të përshtatshëm për të vepruar si arbitër sipas neneve 9.2 dhe/ose 9.3 të Rregullave të UNICTRAL për Arbitrazhin”;

ii. referencat për “Marrëveshje Huaje” ose “Marrëveshje Projekti” lexohen sikur të ishin referenca për “këtë Marrëveshje”; dhe

iii. referenca për “Huamarrësin” lexohet sikur të ishte referencë për “Përfituesin”.

Neni VIII

Hyrja në fuqi; zgjidhja

Seksioni 8.01 Data e hyrjes në fuqi

Kjo Marrëveshje, përveçse kur Banka dhe Përfituesi bien dakord ndryshe, hyn në fuqi në datën kur Banka i dërgon Përfituesit një njoftim të marrjes nga Banka të vërtetimit të kërkuar sipas seksionit 8.02 (Kushtet precedent për hyrjen në fuqi).

Seksioni 8.02 Kushtet precedent për hyrjen në fuqi

Kjo Marrëveshje nuk hyn në fuqi nëse Banka nuk bindet se nuk ka ndodhur dhe nuk vazhdon të ndodhë një ngjarje e përmendur në seksionin 6.01(a) (Pezullimi) ose seksionin 6.05 (Ngjarjet e rimbursimit) të kësaj Marrëveshjeje; dhe deri kur të plotësohen kushtet e mëposhtme paraprahe,



në formë dhe përmbajtje të kënaqshme për Bankën ose në diskrecion të vetëm të Bankës të hiqet dorë prej tyre, plotësisht ose pjesërisht dhe duke iu nënshtruar apo jo disa kushteve:

a) Banka të ketë marrë dy kopje origjinale të kësaj Marrëveshjeje të ekzekutuara rregullisht;

b) Të gjitha kushtet paraprahe për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së Huas, sipas seksionit 9.02 (Kushtet Paraprahe për Hyrjen në Fuqi) të Afateve dhe Kushteve Standarde dhe seksionit 5.01 (Kushtet Paraprahe për Hyrjen në Fuqi) të Marrëveshjes së Huas, përveç hyrjes në fuqi vetëm të kësaj Marrëveshjeje, të jenë plotësuar, në formë dhe përmbajtje të kënaqshme për Bankën;

c) Banka të ketë marrë vërtetim nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë në formë dhe përmbajtje të kënaqshme për Bankën, që ekzekutimi dhe dorëzimi i kësaj Marrëveshjeje në emër të Përfituesit është autorizuar rregullisht dhe është ratifikuar me të gjitha veprimet e nevojshme shtetërore dhe administrative; dhe

d) Bankës i janë dhënë dokumente të tjera që ajo mund të ketë kërkuar.

Seksioni 8.03 Zgjidhja për moshyrje në fuqi
Nëse:

a) Kjo Marrëveshje nuk ka hyrë në fuqi deri në datën që është nëntëdhjetë (180) ditë kalendarike nga data e kësaj Marrëveshjeje; ose

b) Marrëveshja e Huas nuk ka hyrë në fuqi deri në datën e specifikuar në seksionin 5.03 (Zgjidhja për Moshyrje në Fuqi) të Marrëveshjes së Huas ose deri në një datë tjetër që Banka i bën me dije Përfituesit në cilësinë e Huamarrësit sipas seksionit 9.04 (Zgjidhja për Moshyrje në Fuqi) të Afateve dhe Kushteve Standarde,

të gjitha detyrimet e Bankës sipas kësaj Marrëveshjeje ndërpriten nëse Banka, pas shqyrtimit të arsyeve për këtë vonesë, nuk cakton një datë të mëvonshme për qëllimet e këtij seksioni. Banka njofton Përfituesin menjëherë për këtë datë të mëvonshme.

Seksioni 8.04 Përfundimi pas përmbushjes

a) Kjo Marrëveshje vazhdon të jetë në fuqi deri kur Përfituesi të ketë përmbushur të gjitha detyrimet e tij përkatëse në përputhje me parashikimet e saj, përveçse nëse ndërpritet më përpara në përputhje me afatet e saj; me kusht që dispozitat e seksionit 7.03 (Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve) të zbatohen përtej zgjidhjes së kësaj Marrëveshjeje.

b) Pavarësisht parashikimeve në kundërshtim me këtë Marrëveshje, dispozitat e seksionit 6.05(d) (Ngjarje të rimbursimit) zbatohen përtej zgjidhjes së kësaj Marrëveshjeje për pesë (5) vjet pas Datës së Realizimit të Projektit.

Neni IX Të ndryshme

Seksioni 9.01 Njoftime

a) Çdo njoftim ose kërkesë e nevojshme ose e lejuar për t'u dhënë ose e bërë sipas kësaj Marrëveshjeje do të jetë në formë të shkruar. Përveçse kur parashikohet ndryshe në seksionin 8.01 (Data e Hyrjes në Fuqi) të kësaj Marrëveshjeje, njoftimi ose kërkesa konsiderohet se është dhënë ose bërë siç duhet, kur i është dhënë palës të cilës duhet që t'i jepet ose bëhet në adresën e palës të specifikuar më poshtë ose në adresën që pala ka specifikuar me shkrim për palën tjetër që jep njoftimin ose që bën kërkesën. Përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë Marrëveshje ose në Manualin e BERZH-it për Disbursimet, dorëzimi mund të bëhet dorazi, me postë ose faks. Dorëzimet e bëra me faks konfirmohen edhe me postë.

Për Përfituesin:

Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3
Tiranë
SHQIPËRI

Në vëmendje të: Ministër i Financave dhe Ekonomisë

Faks: + 355 4 222 8494

Për Bankën:

Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
One Exchange Square
London EC2A 2JN
United Kingdom

Në vëmendje të: Operation Administration
Department

Faks: +44 20 7338 6100

Seksioni 9.02 Mandat për të vepruar

Çdo veprim i kërkuar ose i lejuar që të kryhet dhe çdo dokument i kërkuar ose i lejuar që të ekzekutohet sipas kësaj Marrëveshjeje nga Përfituesi merret ose ekzekutohet nga Përfaqësuesi i Autorizuar i Përfituesit, ose



nëpunës të tjerë të Përfituesit të përcaktuar me shkrim nga Përfaqësuesi i Autorizuar i Përfituesit. Përfituesi i jep Bankës dëshmi të mandatit dhe mostrën e nënshkrimit të autorizuar të këtij nëpunësi sipër formularit të pasqyrës 2 (Formulari i Shkresës së Përcakton Nënshkrimet e Autorizuara).

Seksioni 9.03 Ndryshimi

Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet me anë të një dokumenti të shkruar të nënshkruar nga Përfaqësuesi i Autorizuar i Përfituesit dhe nga një nëpunës i Bankës i autorizuar posaçërisht.

Seksioni 9.04 Gjuha angleze

Kjo Marrëveshje është përgatitur dhe ekzekutuar në gjuhën angleze. Çdo dokument që nxirret sipas kësaj Marrëveshjeje bëhet në gjuhën angleze. Dokumentet në çdo gjuhë tjetër shoqërohen me një përkthim në anglisht të tyre të certifikuar si të ishte një përkthim i miratuar dhe një përkthim i tillë i miratuar është përfundimtar.

Seksioni 9.05 Dëmshpërblimi

a) Përfituesi mban përgjegjësi të plotë dhe pranon, dëmshpërblen dhe përjashton nga përgjegjësia Bankën dhe nëpunësit e saj, drejtorët, punonjësit, agentët dhe shërbyesit ndaj dhe për, ndonjë prej dhe të gjitha detyrimeve, humbjeve, dëmshpërblimeve (zhdëmtuese, ndëshkuese apo tjetër), sanksioneve, pretendimeve, padive, taksave, kostove dhe shpenzimeve (përfshirë tarifatat dhe shpenzimet e këshillimit ligjor dhe kostot e hetimit) të çfarëdolloji dhe natyre,

përfshirë por, pa cenuar përgjithësimin e sa më sipër, atyre që lindin në kontratë ose detyrime (përfshirë pakujdesinë) ose për shkak të përgjegjësisë strikte apo tjetër, të cilat vendosen ndaj, shkaktohen nga ose pretendohen kundër Bankës apo ndonjë prej nëpunësve, drejtorëve, punonjësve, agentëve apo shërbimeve (të dëmshpërblyer apo jo nga ndonjë person tjetër sipas këtij dokument) dhe që në një farë mënyrë lidhen me apo çojnë, direkt apo jo, në:

1. Një nga transaksionet e përcaktuara në këtë Marrëveshje ose ekzekutimin, dorëzimin apo zbatimin e saj;

2. Operimin ose mirëmbajtjen e pajisjeve të Subjektit të Projektit ose pronësinë, kontrollin ose posedimin e tyre nga Subjekti i Projektit; ose

3. Ushtrimin nga Banka të të drejtave dhe mjeteve juridike të saj sipas kësaj Marrëveshjeje;

dhe

me kusht që Banka të mos ketë të drejtë të dëmshpërblehet për pakujdesi të rënda ose shkelje të qëllimshme.

b) Përfituesi pranon që Banka po nënshkruan këtë Marrëveshje dhe ka vepruar vetëm si një ofrues kryesor dhe jo si këshilltar për Përfituesin. Përfituesi deklaron dhe garanton që, duke nënshkruar këtë Marrëveshje, angazhohet dhe është mbështetur te këshilla që atij i jep një nga këshilltarët e tij ligjorë, financiarë dhe profesionistë të tjerë dhe nuk është mbështetur dhe nuk do të mbështetet në ndonjë këshillë që i jep Banka.

Seksioni 9.06 Caktime

Përfituesi nuk mund të caktojë ose përndryshe të transferojë të gjitha ose një pjesë të të drejtave apo detyrimeve të tij sipas kësaj Marrëveshjeje pa miratimin paraprak të Bankës.

Seksion 9.07. Të drejta, mjete juridike dhe heqja dorë

Të drejtat dhe mjetet juridike të Bankës sipas kësaj Marrëveshjeje nuk cenohen nga një akt ose send që përveç këtij seksioni, mund të cenojë këto të drejta ose mjete juridike. Asnjë mënyrë trajtimi dhe asnjë vonesë në ushtrimin ose mosushtrimin e një të drejte, kompetence ose mjeti juridik të Bankës nuk pengon një të drejtë, kompetencë ose mjet juridik të tillë ose nuk interpretohet si një heqje dorë prej tij. Heqja dorë nga ndonjë prej afateve ose kushteve të kësaj Marrëveshjeje bëhet me shkrim dhe nënshkruhet nga Banka. Në rast se Banka heq dorë nga një kusht për një Disbursim të Financimit të Grantit, Përfituesi, pasi merr këtë Disbursim, konsiderohet se ka rënë dakord me kushtet e kësaj heqjeje dorë dhe e drejta e Bankës për të kërkuar plotësimin e këtij kushti ruhet shprehimisht për qëllime të Disbursimit të radhës. Të drejtat dhe mjetet juridike të parashikuara në këtë Marrëveshje dhe çdo marrëveshje tjetër e shprehur në të janë kumulative dhe nuk pengojnë ushtrimin tjetër ose të mëtejshëm të tyre ose ushtrimin e një të drejte ose mjeti tjetër juridik.

Seksioni 9.08 Nxjerrja e të dhënave

a) Banka mund të nxjerrë ato dokumente, informacione dhe evidenca në lidhje me Përfituesin dhe Subjektin e Projektit dhe këtë transaksion (përfshirë kopje të kësaj



Marrëveshjeje dhe çdo marrëveshje tjetër të përcaktuar në të) që Banka i gjykon të duhura për çdo qëllim në lidhje me një mosmarrëveshje që përfshin Përfituesin dhe Subjektin e Projektit për qëllim të ruajtjes ose zbatimit të të drejtave të Bankës sipas kësaj Marrëveshjeje ose ndonjë marrëveshjeje tjetër të përcaktuar në të ose për qëllim të mbledhjes së shumave që i detyrohen Bankës dhe për qëllim të raportimit sipas Rregullave të Fondit.

b) Banka mund të njoftojë Komisionin Evropian pasi të vihet në dijeni që Subjekti i Projektit, një Kontraktues ose një nënkontraktues konsiderohet se ka qenë ose është bërë një Subjekti i Përfshirë. Pas këtij njoftimi, Komisioni Evropian mund të regjistrojë këtë informacion në Sistemin e Zbulimit të Hershëm dhe Përfshirimit (më përpara i njohur si Banka Qendrore e të dhënave të Përfshirimit) ose bankë të dhënash zëvendësuese që Komisioni Evropian e administron për këtë qëllim.

Seksioni 9.09 Duplikatat

Kjo Marrëveshje mund të ekzekutohet në çdo dublikatë ku secili konsiderohet origjinal, por ku të gjitha së bashku përbëjnë një dhe të njëjtën marrëveshje.

Në dëshmi të kësaj, palët e kësaj marrëveshjeje, me anë të përfaqësuesve të autorizuar posaçërisht prej tyre, kanë marrë masa që kjo Marrëveshje të nënshkruhet në katër kopje, në gjuhën angleze, sipas datës të shkruar më sipër.

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Nga: _____

Emri: Arben Ahmetaj

Titulli: Ministër i Financave dhe Ekonomisë

BANKA EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Nga: _____

Emri: Mateo Colangeli

Titulli: Drejtor Zyre në Shqipëri

GRAFIKU 1. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

1. Qëllimi i këtij Projekti është të ndihmojë Përfituesin për rehabilitimin e linjës ekzistuese hekurudhore ndërmjet qyteteve të Tiranës dhe Durrësit me gjatësi prej 34.17 km përafërsisht dhe ndërtimin e një linje të re hekurudhore me gjatësi si 5 km përafërsisht për të lidhur Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës dhe vendtakimin e tij me linjën ekzistuese.

2. Projekti përbëhet nga pjesët e mëposhtme, që u nënshtrohen ndryshimeve siç mund të bihet dakord nga Banka dhe Përfituesi herë pas here:

Pjesa A. Punime ndërtimi në lidhje me: i. rehabilitimin e linjës ekzistuese hekurudhore ndërmjet qyteteve të Tiranës dhe Durrësit me gjatësi prej 34.17 km përafërsisht; dhe ii. ndërtimin e një linje të re hekurudhore me gjatësi si 5 km përafërsisht për të lidhur Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës dhe vendtakimin e tij me linjën ekzistuese.

Pjesa B. Shërbime konsulence për mbështetjen për zbatimin e projektit dhe mbikëqyrjen e punimeve për pjesën A.

3. Projekti pritet që të realizohet deri në 31 dhjetor 2020.

GRAFIKU 2. ZËRA QË FINANCOHEN NGA GRANTI

Tabelat që jepen në këtë grafik tregojnë Zërat e Financuar nga Granti dhe shumën e Financimit të Grantit që alokohet për çdo Zë të Financuar nga Grantit dhe Përlogaritjet e Kostos të Projektit dhe Planin e Financimit.

	Zëra të financuar nga Granti	Shuma e financimit të Grantit alokuar në euro
1	Kontrata për punime për rehabilitimin e linjës Durrës–Tiranë (PTT) dhe ndërtimin e linjës së re hekurudhore për në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës	32,935,000
2	Shërbime të mbikëqyrjes së punimeve	1,500,000
3	Zbatimi dhe mbështetje për NJZP-në	1,000,000



Përlllogaritje të Kostos së Projektit dhe Plani i Financimit

Kostot e Projektit dhe Plani i Financimit (EUR m)	Hua e BERZH-it	Grant i BERZH-it	Grant i BE/BERZH-it	Qev. e Shqipërisë	TOTAL
Punime civile (përfshirë kontigjencën)	36,87		32,935		69,8
Dokumente të detajuara të projektimit dhe tenderit *			1,215		1,215
Mbikëqyrje e punimeve			1,5		1,5
Zbatimi dhe mbështetje për NJZP-në			1		1
Forcimi i kapaciteteve të institucionit		0,87			0,87
Blerja e tokës				1	1
TVSH				15,06	15,06
GJITHSEJ	36,87	0,87	36,65	16,06	90,45

* Ky komponent i Projektit është plotësuar.

PASQYRA 1 1. FORMULARI I KËRKESËS PËR DISBURSIM

[Për t'u shtypur me letër më kokë të Përfituesit]

[Data]

Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
One Exchange Square
London EC2A 2JN
United Kingdom

Operation Administration Department

Nr. operimi 48466 (Komponenti i Grantit)
Kërkesë Disbursimi nr. [1]

Lënda: Marrëveshje Granti, datë _____,
ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës
Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
(Banka)

Me anë të kësaj, kërkojmë Disbursimin e mëposhtëm në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes së Grantit më sipër:

Monedha e Grantit: [EUR]

Monedha e pagesës së kërkuar: [2]

Shuma/t e financuar/a/monedha: [3]

Data e vlerës: [4]

Të pagueshme për (Përfituesin): [5]

Udhëzimet e pagesës (të dhënat bankare të Përfituesit):

Emri i llogarisë të Përfituesit: [6]

Numri i llogarisë të Përfituesit: [7]

Emri bankar i Përfituesit: [8]

Adresa bankare e Përfituesit: [9]

Faqe | 7146

Të dhënat e Bankës Korrespondente të Përfituesit:

Emri i Bankës Korrespondente: [10]

Adresa: [11]

Emri i llogarisë: [12]

Numri i llogarisë: [13]

Referenca e pagesës: [14]

Adresa elektronike e Përfituesit [15]

Me anë të kësaj, vërtetojmë se nuk kemi kërkuar më parë asnjë disbursim nga Granti për mbulimin e këtyre shpenzimeve. Ne nuk kemi marrë dhe as nuk synojmë të marrim fonde për këtë qëllim nga asnjë burim tjetër i ndonjë granti, kredie apo huaje.

Mallrat dhe shërbimet që mbulohen nga kjo kërkesë janë blerë apo po blihen, në përputhje me kushtet e Marrëveshjes së Grantit.

[Respektimi nga Garancia i kërkesave të seksionit 2.02(c) (Kushtet pezulluese për Disbursimin), duke përdorur formulimin e atij seksioni.]

Prandaj, i konfirmojmë BERZH, që: i. ne kemi përmbushur detyrimet tona, siç është përcaktuar në Marrëveshjen e Grantit dhe Marrëveshjen e Huas; dhe ii. që nuk është vërejtur asnjë ngjarje që të ketë ndikim material dhe negativ tek operacionet tona ose kushtet financiare ose përgjegjësinë tonë për të kryer Projektin ose për të përmbushur çdo detyrim sipas Marrëveshjes së Grantit.

Me respekt,

Nga: _____

Emri:

Titulli:



Bashkëlidhur: Numri total i fletëve përmbledhëse: [16]

- Numri total i dokumenteve: [17]

Shënime për plotësimin e formularit të kërkesës për disbursim

[1] Përfituesi duhet të numërtojë çdo formular kërkesë. Kërkesa e parë për disbursim granti duhet të mbajë numrin 1, kërkesat pasuese do të numërtohen 2, 3 etj. I takon Përfituesit të ruajë numrin e kërkesave për disbursim që ai bën sipas një marrëveshjeje të caktuar granti. Formularët e kërkesës duhet të ndjekin të njëjtin sistem të vendosjes së numrit rendor, edhe nëse janë për një disbursim të drejtpërdrejtë pagese apo për dhënien e një angazhimi disbursimi. Përdorimi i këtij sistemi numërimi do të shmangë konfuzionin në rast se formularët dërgohen me postë, me faks më shumë se një herë etj.

[2] Lutemi caktoni monedhën e kërkuar për pagesë. Ajo mund të jetë ose monedha e grantit ose monedha në të cilën janë kryer shpenzimet (shihni pikën [3] më poshtë). Përndryshe, në disa rrethana, Banka mund të pranojë të paguajë në një monedhë të tretë, rast në të cilin ajo do të vepronte si agjente e Përfituesit për të siguruar këtë monedhë. Nëse pagesa kërkohet në më shumë se një lloj monedhe, atëherë duhet përdorur një formular kërkesë i veçantë për secilën monedhë.

[3] Shumat financiare përbëhen nga shpenzimet fillestare, në monedhën fillestare të tyre siç përcaktohet hollësisht në fletën përmbledhëse, të llogaritura në përqindjen e duhur të përcaktuar në Marrëveshjen e Grantit për Zërat e Financiar nga Granti që kualifikohen. Shuma e dhënë këtu duhet të jenë në përputhje më shumë totale sipas seksionit [15] të fletës përmbledhëse.

[4] Data e Vlerës është data kur llogaria e BERZH-it debitohet me vlerën e pagueshme sipas disbursimit. BERZH-i nuk mund të garantojë që llogaria e përfituesit do të kreditohet brenda së njëjtës datë, meqë kjo varet nga procedurat që zbatohen nga sistemet e pagesës ose nga banka Përfituese në vendin e përfituesit. Duhet të jepen të paktën 15 ditë pune nga data kur BERZH-i merr kërkesën dhe datën e vlerës së kërkuar. Do të ishte më e përshtatshme që të mos vendosej një datë e caktuar, por të shkruhet

shprehja: “sa më shpejt që të jetë e mundur”, nëse në fakt pagesa nevojitet sa më shpejt që të jetë e mundur [4]. Në këtë rast, BERZH-i do të kryejë pagesën në çdo rast brenda 15 ditëve pune, por sa më shpejt që të jetë e mundur. (Lutemi, vini re se pagesa mund të garantohet vetëm brenda 15 ditëve pune, nëse kërkesa për disbursim është e saktë dhe e plotë.)

[5] Disbursimi i duhet paguar Përfituesit. Normalisht, Përfituesi duhet të jetë Kontraktuesi, por me kusht që Banka të ketë pranuar me shkrim që dokumentacioni bashkëlidhur (shihni fletën përmbledhëse) të japë të dhëna të plota që huamarrësi e ka paguar tashmë Kontraktuesin, atëherë mund të bëhet pagesa për Përfituesin.

[6] Emri i llogarisë së Përfituesit në këtë rast do të jetë thjesht emri i atij kujt i bëhet pagesa.

[7] Numri i llogarisë së Përfituesit kërkohet në mënyrë që të shmangen vonesat. Në një numër të madh vendesh, bankat nuk pranojnë të kryejnë pagesa nëse në udhëzimet për pagesë nuk është dhënë numri i llogarisë së Përfituesit.

[8] Banka e Përfituesit është banka e cila mban llogarinë e Përfituesit. Ju lutemi tregoni emrin e bankës dhe qytetin.

[9] Në vend të adresës, duhet dhënë kodi SWIFT.

[10] Banka korrespondente e bankës së Përfituesit kërkohet vetëm nëse pagesa kërkohet të kryhet jo në monedhën e vendit ku është vendosur banka e Përfituesit. Në këtë rast, banka korrespondente është ajo bankë, e ndodhur në vendin që i përket monedhës në të cilën kërkohet të kryhet pagesa ku Përfituesi ka një numër llogarie.

[11] Në vend të adresës mund të jepet kodi SWIFT i bankës korresponduese.

[12] Në shumicën e rasteve, emri i llogarisë së Përfituesit është thjesht emri i bankës së Përfituesit.

[13] Numri i llogarisë së Përfituesit është me rëndësi themelore nëse banka e Përfituesit ka më shumë se një llogari me bankën korrespondente ose nëse ajo nuk është anëtare e SWIFT (Sistemi ndërkombëtar i shlyerjes së pagesave elektronike). Përndryshe, numri është i përdorshëm, por jo i detyrueshëm. Sipas rastit, duhet të shënohet kodi IBAN (Numri Ndërkombëtar i Llogarisë Bankare).



[14] Referenca e pagesës që do të dërgojë BERZH-i me pagesën e ndihmon Përfituesin që të identifikojë pagesën. Nëse nuk kërkohet një referencë specifike, BERZH-i do të përmendë emrin e Përfituesit dhe numrin e marrëveshjes.

[15] Adresa elektronike e Përfituesit kërkohet që Banka të dërgojë njoftime të pagesave në ardhje për Përfituesin përpara se Banka të bëjë këto pagesa. Ajo duhet të jetë një adresë elektronike që Përfituesi e kontrollon rregullisht.

[16] Nënshkrimi. Fleta përmbledhëse e kërkuar duhet të nënshkruhet nga dhe në emër të Përfituesit.

[17] Fletët përmbledhëse rendisin të gjitha llojet e dokumentacionit që bashkëlidhen në mbështetje të kërkesës për Disbursim të paraqitur. Nëse ka shumë lloje, këshillohet të përdoret një fletë përmbledhëse e veçantë për secilën kategori dokumenti.

[18] Llojet e dokumentacionit për disbursim (kontratat, faturat, dëftesat etj.) duhet të numërtohen dhe të paraqiten në të njëjtin rend, siç tregohet në fletën përmbledhëse. Numri i tyre total duhet të tregohet qartë, në mënyrë që të lehtësohet shqyrtimi nga ana e BERZH-it.

Operazioni
Nr.: [3].....

Kérkesa
Nr.: [4]

Fleta përmbledhëse nr.: [5]

Disbursim (prot. nr./emri/%)
Zë i Financuar nga Granti: [6]/...../.....

Numër nr.	Përshkrimi i zërit	Kontratë nr. dhe data	Emri dhe adresa e Kontraktuesit	Përshkrim i shkurtër i mallrave, punimeve ose shërbimeve	Monedha dhe shuma totale e Kontratës	Monedha dhe shuma e shpenzimeve të pranueshme	Shuma e financimit në monedhë të shpenzimeve
[7]	[8]	[9]	[10]	[11]	[12]	[13]	[14]

[16].....

TOTAL (për monedhë)



SHËNIME PËR PLOTËSIMIN E FLETËS PËRMbledhëse TË KËRKESËS PËR DISBURSIM

[1] Emri. Emri i Përfituesit. Kjo duhet të jetë e njëjtë atë në kërkesën për disbursim, së cilës i përket kjo fletë përmbledhëse.

[2] Data. Data e kërkesës. Kjo duhet të jetë e njëjtë atë në kërkesën për disbursim, së cilës i përket kjo fletë përmbledhëse.

[3] Numri i operimit. Ky numër duhet të jetë i njëjtë me atë në kërkesën për disbursim, së cilës i përket kjo fletë përmbledhëse.

[4] Numri i kërkesës. Ky numër është i njëjtë me atë në kërkesën për disbursim, së cilës i përket kjo fletë përmbledhëse.

[5] Numri i fletës përmbledhëse. Për çdo kërkesë disbursimi, fletët përmbledhëse duhet të numërtohen, duke filluar nga numri 1 dhe numri total i shënuar në kërkesën për disbursim, së cilës i përket kjo fletë përmbledhëse.

[6] Zërat e disbursimit që financohen nga Granti. Ky është zëri i financiar nga Granti për projektin, që financohet nga të ardhurat e disbursimit të kërkuar. Ju lutem, shiheni me kujdes marrëveshjen e grantit për të gjetur emrin dhe numrin e referencës së Zërave të Financuar nga Granti, si dhe përqindjen e shpenzimeve që do të financohen (për shembull, “Zëri i Financuar nga Granti me nr. (3b), pajisje, 60 %”).

Nëse një kërkesë për disbursim mbulon shpenzimet e më shumë se një zëri të financiar nga Granti, atëherë duhet të përdoret më shumë se një fletë përmbledhëse për çdo zë të financiar nga Granti.

[7] Numri i zërit. Të gjitha llojet e dokumenteve (kontratat, faturat, dëftesat etj.) duhet të paraqiten

në të njëjtin rend, siç tregohet në fletën përmbledhëse. Për të lehtësuar identifikimin, dokumentet duhet të numërtohen, duke filluar me 1, 2, 3 etj., për çdo kërkesë të re Disbursimi dhe ky numër duhet të shënohet qartë në vetë dokumentin. Numri total i zërave për numrin total të të gjitha fletëve përmbledhëse është shënuar në formularin e kërkesës për disbursim.

[8] Përshkrimi i zërit. Lutemi, përshkruani çdo zë, si për shembull “faturë”, “dëftesë”, “certifikatë inxhinieri”, “përkthim i [...]” etj.

[9]. Numri rendor dhe data e Kontratës. Rekomandohet që kontratës t’i vendoset një numër i veçantë kur ajo të përgatitet dhe nënshkruhet ndërmjet Subjektit të Projektit dhe Kontraktuesit. BERZH-i do të përdorë këtë numër për mbajtjen e dokumentacionit dhe të dhënave të veta. Nëse kontratës nuk i është vënë një numër i veçantë, BERZH-i do të vendosë një numër dhe do të informojë Përfituesin në kohën e miratimit. Nëse Përfituesi nuk e di numrin në kohën e plotësimit të fletës përmbledhëse, kjo pjesë do t’i lihet BERZH-it që ta plotësojë vetë.

Data e kontratës/e urdhrit të blerjes duhet, gjithashtu, të vendoset në këtë kolonë.

Shënim. E njëjta kontratë mund të paraqitet në më shumë se një kërkesë për disbursim, nëse livrimi i mallrave, pagesa e punimeve ose shërbimeve (shihni pikën [11]) dhe, rrjedhimisht, pagesa për këto mallra etj., bëhet në faza.

[10] Emri dhe adresa e Kontraktuesit. Emri dhe adresa e homologut (Kontraktuesit) sipas kontratës/urdhrit të blerjes, siç përshkruhet në pikën [9].

[11] Përshkrim i shkurtër i mallrave, punimeve ose shërbimeve. Këto mallra, punime ose shërbime duhet të jenë në përputhje me hollësitë e dhëna në Kontratë ose në dokumente të tjera që paraqiten dhe duhet të jenë sipas Zërave të Financuar nga Granti, të përcaktuara në pikën [6].

[12] Monedha dhe vlera totale e Kontratës. Vlera e plotë, në monedhën përkatëse, e Kontratës e renditur në pikën [9].

[13] Monedha dhe vlera totale e shpenzimeve të pranueshme. Për shpenzime: vlera totale e cila përbën detyrim ose duhet paguar, në monedhën përkatëse, e mbuluar nga faturat dhe dokumentet të tjera të renditura në pikat [7] dhe [8]. Kur ka më shumë se një “zë”, për secilin shpenzim (për shembull, një faturë, certifikatë ose dëftesë, që të gjitha për të njëjtin shpenzim), të gjithë këta zëra duhet të futen në kllapa dhe në kolonën përkatëse duhet të vendoset vetëm një shumë.

[14] Shuma e financimit. Për çdo shumë të renditur në kolonën [13] duhet të jepet një shumë korresponduese në këtë kolonë [14], e llogaritur në bazë përqindjeje sipas deklaramit në [6], që të jetë në përputhje me kategorinë e shpenzimit të kësaj flete përmbledhëse. Shuma e financimit duhet të jetë në monedhën përkatëse të kontratës dhe



shpenzimeve (kolonat 12 dhe 13). Kjo mund të jetë ose mund të mos jetë e njëjtë me monedhën e huas ose monedhën e pagesës.

[15] Totali. Shumat e financimit, sipas renditjes së pikës [14], duhet të mbledhen për të arritur në një shumë totale në monedhën e caktuar. Për kërkesat e drejtpërdrejta për Disbursim, shuma/t totale e/të paraqitur/a këtu duhet të jetë/jenë në përputhje me shumën/at e paraqitur/a në pikën [9] të formularit të kërkesës për disbursim.

[16] Nënshkrimi. Fleta përmbledhëse e kërkuar duhet të nënshkruhet nga dhe në emër të Përfituesit. Shihni formularin e kërkesës për disbursim, në lidhje me kërkesat për nënshkrim.

**PASQYRA 2 FORMULARI I SHKRESËS QË
CAKTON NËNSHKRUESIT E
AUTORIZUAR**

[Për t'u shtypur me letër më kokë të Përfituesit]

[Data]

Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
One Exchange Square
London EC2A 2JN
United Kingdom

Në vëmendje të: Operation Administration
Department (Departamenti të Administrimit të
Operacioneve)

Lënda: Nr. operimi 48466 (Komponenti i
Grantit)

Shkresë për caktimin e nënshkruesve të
autorizuar

I/e nderuar,

Referuar Marrëveshjes së Grantit të datës [data]
(Marrëveshja e Grantit) mes Republikës së
Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim
dhe Zhvillim (Banka), lutemi, informohuni se nga
personat për të cilët më poshtë jepet modeli i
nënshkrimit të tyre, janë të autorizuar në emër të
Përfituesit që të nënshkruajnë së bashku [Kërkesat
për Disbursim dhe çdo lloj [tjetër dokumenti]] të
kërkuar ose të lejuar për ekzekutim, sipas
Marrëveshjes së Grantit të përmendur më sipër.

EMRI	POZICIONI	MODELI I NËNSHKRIMIT
_____	_____	_____
_____	_____	_____
_____	_____	_____

Të gjitha njoftimet e mëparshme që jepnin
nënshkrimet e zyrtarëve të autorizuar për të
nënshkruar në emër të Përfituesit, sipas
Marrëveshjes së mësipërme të Grantit
konsiderohen të revokuara.

Me respekt,

Për dhe në emër të:

[EMRI I PËRFITUESIT]

Nga: _____

Emri:

Titulli:

**Shënime për plotësimin e shkresës për
caktimin e nënshkruesve të autorizuar**

- Autorizimi i mësipërm duhet nënshkruar në
emër të Përfituesit nga përfaqësuesi i tij i
autorizuar. Lutemi, vini re, se në lidhje me
ndonjë veprim të kërkuar ose të lejuar sipas
dispozitave të seksionit 2.02 ose 2.03 të
Marrëveshjes së Grantit, autorizimi i mësipërm
duhet të nënshkruhet në emër të Përfituesit nga
përfaqësuesi i tij i autorizuar.

- Në rast se çdo dokument duhet të
nënshkruhet nga më shumë se një nëpunës,
shkresa e autorizimit duhet ta theksojë këtë qartë
dhe fjalia e parë duhet të përshtatet siç duhet.

Nëse nënshkruesit e autorizuar janë ndarë në
dy grupe dhe kërkohet nënshkrimi i një nëpunësi
nga secili grup, edhe ky fakt duhet të shprehet
qartë.

LIGJ

Nr. 53/2018

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
SË HUAS NDËRMJET REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË DHE BANKËS
NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM
DHE ZHVILLIM, PËR SHITESËN E
FINANCIMIT PËR PROJEKTIN
E MODERNIZIMIT TË ASISTENCËS
SOCIALE**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, e 121,
të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të
Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për shtesën e financimit për projektin e modernizimit të asistencës sociale, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 23.7.2018

Shpallur me dekretin nr.10856, datë 31.7.2018 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

HUAJA ORIGJINALE NUMËR 8141-AL
HUAJA NUMËR 8841-AL

MARRËVESHJE HUAJE
(FINANCIM SHITESË PËR PROJEKTIN E
MODERNIZIMIT TË ASISTENCËS
SOCIALE) NDËRMJET REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE BANKËS
NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM
DHE ZHVILLIM

Marrëveshje e lidhur në datën e nënshkrimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë (Huamarrësi) dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka).

Duke pasur parasysh se: A) Në bazë të një marrëveshjeje të datës 6 qershor 2012, ndërmjet Huamarrësit dhe Bankës (Marrëveshja Fillestare e Huas), me ndryshimet përkatëse, Banka ka rënë dakord t'i jepte Huamarrësit një hua (Huaja Fillestare), në shumën e barasvlershme me tridhjetë e tetë milionë euro (38.000.000 euro), për të ndihmuar në financimin e Projektit Fillestar; dhe

B) Huamarrësi i ka kërkuar Bankës t'i japë financim tjetër shtesë në mbështetje të aktiviteteve të reja, siç paraqiten në përshkrimin e Projektit në skedulin 1 të kësaj Marrëveshjeje;

Si rrjedhojë:

Nëpërmjet kësaj Marrëveshjeje, Huamarrësi dhe Banka bien dakord si më poshtë:

Neni I

Kushtet e përgjithshme; përkufizime

1.01 Kushtet e Përgjithshme (siç përkufizohen në shtojcën e kësaj Marrëveshjeje) zbatohen për këtë Marrëveshje dhe janë pjesë integrale e saj.

1.02 Nëse konteksti nuk e kërkon ndryshe, termat me shkronjë të madhe në këtë Marrëveshje kanë kuptimin e caktuar për to në Kushtet e Përgjithshme ose në shtojcën e kësaj Marrëveshjeje.

Neni II

Huaja

2.01 Banka bie dakord t'i japë hua Huamarrësit shumën prej njëmbëdhjetë milionë dollarësh amerikanë (11.000.000 USD), (Huaja) për të ndihmuar financimin e projektit të përshkruar në skedulin 1 të kësaj Marrëveshjeje (Projekti).

2.02 Huamarrësi mund t'i tërheqë fondet e Huas, sipas seksionit III, të skedulit 2 të kësaj Marrëveshjeje.

2.03 Tarifa fillestare është sa një e katërta e një për qind (0,25%) të shumës së Huas.

2.04 Tarifa e Angazhimit është sa një e katërta e një për qind (0,25%) në vit të Tepërcës së Patërhequr të Huas.

2.05 Norma e interesit është Norma e Referimit plus një Marzh të Pandryshueshëm, në bazë të pikës 3.02(e) të Kushteve të Përgjithshme.

2.06 Datat e Shlyerjes janë 1 shkurt dhe 1 gusht të çdo viti.

2.07 Principali i Huas do të shlyhet sipas tabelës së amortizimit që paraqitet në skedulin 3 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni III

Projekti

3.01 Huamarrësi, nëpërmjet MSHMS-së, deklaron angazhimin e tij për objektivin e Projektit. Për këtë qëllim, Huamarrësi, nëpërmjet MSHMS-së, e zbaton Projektin sipas dispozitave të nenit V të Kushteve të Përgjithshme dhe skedulit 2 të kësaj Marrëveshjeje.



Neni IV

Mjetet ligjore të Bankës

4.01 Rastet shtesë të Pezullimit përfshijnë rastet kur:

a) PNE-ja dhe PAK-ja janë ndryshuar, pezulluar, anuluar, shfuqizuar apo hequr dorë në mënyrë të tillë që sipas mendimit të Bankës, në konsultim me Huamarrësin, cenohet materialisht dhe negativisht aftësia e Huamarrësit për të arritur objektivat e projektit.

b) Huamarrësi, nëpërmjet MSHMS-së, ka ndërmarrë veprime që mund të kenë sjellë zmbropsjen e një treguesi të lidhur me livrimin (TLL) që është arritur dhe në lidhje me të cilin është livruar shumat përkatëse e TLL-së.

4.02 Rasti Shtesë i Përshpejtimit përfshin situatën kur rastet e përcaktuara në pikën 4.01 të kësaj Marrëveshjeje ndodhin dhe vazhdojnë për një periudhë prej gjashtëdhjetë (60) ditësh pas njoftimit për rastin që Banka i ka drejtuar Huamarrësit.

Neni V

Hyrja në fuqi

5.01 Kushtet shtesë të hyrjes në fuqi konsistojnë në rastin kur Manuali i Operacioneve të Projektit (MOP) është miratuar në atë mënyrë që është e pranueshme për Bankën.

5.02 Afati për hyrjen në fuqi është data 90 (nëntëdhjetë) ditë pas datës së nënshkrimit të Marrëveshjes.

Neni VI

Përfaqësuesi; adresat

6.01 Përfaqësuesi i Huamarrësit është ministri i Financave dhe Ekonomisë ose çdo pasues i tij.

6.02 Adresa e Huamarrësit është:

Ministria e Financave

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3

Tiranë, Shqipëri

Faksimile:

dhe

a) Adresa e postës elektronike e Huamarrësit është:

Faksimile:

355 42228494 sekretariamin@financa.gov.al

6.03 Për qëllime të seksionit 10.01 të Kushteve të Përgjithshme: a) adresa e Bankës është:

Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim

1818 H Street, N.W.

Washington, D.C. 20433

United States of America; dhe

b) Adresa elektronike e Bankës është:

Teleks: Faksimile: [E-mail:]

248423(MCI) ose 1-202-477-6391_____

64145(MCI) msalim1@worldbank.org

Rënë dakord në datën e nënshkrimit.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Përfaqësuar nga:

Përfaqësuesi i autorizuar

Emri: Arben Ahmetaj

Titulli: MINISTËR I FINANCAVE DHE

EKONOMISË

Datë 5.6.2018

BANKA NDËRKOMBËTARE PËR**RINDËRTIM DHE ZHVILLIM**

Përfaqësuar nga:

Përfaqësuesi i autorizuar

Emri: Linda Van Gelder

Titulli: Drejtor i vendit

Datë 5.6.2018

SKEDULI 1

Përshkrimi i Projektit

Objekti i Projektit është të mbështesë zbatimin e reformave nga ana e Huamarrësit për përmirësimin e vendosjes së drejtësisë dhe rritjen e efikasitetit të programeve të tij të asistencës sociale.

Projekti përbëhet nga pjesët e mëposhtme:

Pjesa 1. Forcimi i zbatimit dhe performancës së programeve të asistencës sociale

Mbështetja e zbatimit të përmirësuar, si e programit të ndihmës ekonomike (PNE), ashtu edhe e programit të aftësisë së kufizuar (PAK), nëpërmjet dhënies së financimit për rimbursimin e pagesave që Huamarrësi ka kryer nga fondet e tij buxhetore për programin e ndihmës ekonomike (Programi i Shpenzimeve të Lejuara).

Pjesa 2. Asistenca teknike për forcimin e kapacitetit zbatues për programet e asistencës sociale

Mbështetje për kapacitetin e Huamarrësit për zbatimin e përmirësimeve në dhënien e pagesave

Faqe | 7153



të asistencës sociale, përfshirë nëpërmjet sa më poshtë:

a) Rishikimi i parametrave të programeve të asistencës sociale, duke përfshirë sistemet e reja të vlerësimit për asistencën për PAK-në në bazë të modelit social, shqyrtimin e procedurave të punës dhe të kuadrit institucional dhe hartimin e strategjive të asistencës alternative për personat me aftësi të kufizuara, të cilët nuk i përmbushin kriteret e përfitimit nga PAK-ja në bazë të reformës së PAK-së.

b) Përgatitje e një strategjie daljeje për përfituesit e PNE-së, bazuar në modele novatore dhe në përvojën ndërkombëtare.

c) Vënia në zbatim e një sistemi për menaxhimin e informacionit (SMI) për PAK, duke përfshirë shqyrtimin e procedurave bazë të punës, roleve institucionale dhe kërkesave funksionale për të përcaktuar faktorët e përdorur në projektimin e sistemit për menaxhimin e informacionit; zhvillimin e kontrollit të cilësisë për përgatitjen dhe vënien në zbatim të sistemit për menaxhimin e informacionit; përgatitjen e një politike të rishikuar për sanksionet dhe të mekanizmave të zbatimit për të rritur mundësitë për zgjidhjen e rasteve të mashtrimeve dhe gabimeve; dhe hartimin e instrumenteve për zbulimin e mashtrimeve dhe gabimeve dhe mekanizmave të tjerë të inspektimit social.

d) Nxitja e transparencës në komunikim dhe në monitorim-vlerësim, si edhe në angazhimin e qytetarëve, ndër të tjera nëpërmjet:

i. vijimit të zhvillimit të fushatave të ndërgjegjësimi për të siguruar të kuptuarit dhe të pranuarit e reformave në programeve të asistencës sociale nëpërmjet hartimit të një strategjie të gjithanshme komunikimi dhe të mjeteve specifike të komunikimit të përshtatura për temat dhe grupet e synuara specifike;

ii. forcimit të monitorimit dhe të vlerësimit nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të një procesi për vlerësimin e reformave në programet e asistencës sociale dhe zhvillimit të një studimi pasues të aftësisë së kufizuar për të mbështetur monitorimin e reformave të asistencës për aftësinë e kufizuar.

iii. fuqizimit të kapacitetit monitorues dhe vlerësues të MSHMS-së për shqyrtimin e procedurave të punës dhe masave organizative institucionale, analizimin e të dhënave dhe

përditësimin e formulës së unifikuar të pikëzimit; dhe

iv. zhvillimit të një ankete vlerësuese me përfituesit e PAK-së për të vlerësuar sa të kënaqur janë me reformën e PAK-së.

e) Vijimi i dhënies së mbështetjes për zbatimin e Projektit nëpërmjet financimit të Kostove të Shfrytëzimit dhe shërbimeve të konsultimit për të rritur njohuritë teknike të MSHMS-së në fushat përkatëse, duke përfshirë menaxhimin, monitorimin dhe vlerësimin e përditshëm të projektit, prokurimet dhe menaxhimin financiar.

SKEDULI 2 ZBATIMI I PROJEKTTIT

Seksioni I. Zbatimi

A. Kuadri zbatues

1. Huamarrësi krijon dhe mban gjatë gjithë periudhës së zbatimit të Projektit një Grup Pune Bashkërendimi ndërinstitucional, të kryesuar nga ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe ku marrin pjesë përfaqësues të MFE-së, Institutit të Statistikave, Kontrollit të Lartë të Shtetit, MSHMS-së, Shërbimit Social Shtetëror dhe Agjencisë Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit, grup i cili është përgjegjës për drejtimin e zbatimit të reformave në programet e asistencës sociale dhe për sigurimin e bashkërendimit të aktiviteteve në kuadër të projektit midis të gjitha agjencive dhe enteve përkatëse.

2. Huamarrësi, nëpërmjet MSHMS-së, siguron që Drejtoria e Programeve të Zhvillimit për Shëndetësinë dhe Mbrojtjen Sociale pranë MSHMS-së mban, sipas termave të referencës të pranueshme për Bankën, personelin e saj gjatë zbatimit të Projektit me njohuri teknike në menaxhimin, monitorimin dhe vlerësimin e Projektit, prokurimin dhe menaxhimin financiar.

3. Huamarrësi, nëpërmjet MSHMS-së, jo më vonë se: a) data 30 shtator 2018, përgatit dhe i vë në dispozicion Bankës një plan pune me afate të përcaktuara, të hartuar në përputhje me termat e referencës të pranueshëm për Bankën, për përcaktimin e qartë të roleve dhe përgjegjësi për verifikimin e plotësimi të kushteve për marrjen e pagesave në kuadër të programeve të asistencës sociale; dhe b) në datën 31 mars 2019 e vë në zbatim planin në fjalë, duke marrë në konsideratë komentet e Bankës mbi të.



4. Huamarrësi siguron, nëpërmjet MSHMS-së, që gjatë gjithë periudhës së zbatimit të Projektit, të vihen çdo vit në dispozicion fondet e nevojshme buxhetore për qëllimet e zbatimit të Projektit.

5. Huamarrësi, nëpërmjet MSHMS-së, siguron që Projekti të zbatohet në përputhje me Manualin e Operacioneve të Projektit (MOP).

B. Masat mbrojtëse.

1. Huamarrësi, nëpërmjet MSHMS-së, siguron që punimet rehabilituese në bazë të TLL18 në shtojcën 4 të kësaj Marrëveshjeje, të kryhen në përputhje me PMM-në.

2. Huamarrësi, nëpërmjet MSHMS-së, siguron që e gjithë asistencë teknike në kuadër të Projektit të zhvillohet vetëm në përputhje me termat e referencës të shqyrtuar dhe të konstatuar si të pranueshëm nga Banka, terma reference të cilët sigurojnë që asistencë teknike merr në konsideratë dhe kërkon zbatimin e Politikave Mbrojtëse të Bankës, duke përfshirë edhe Udhëzimet e Bankës për Shëndetin dhe Sigurinë.

Seksioni II. Monitorimi, raportimi dhe vlerësimi i Projektit

a) Huamarrësi, nëpërmjet MSHMS-së, i vë në dispozicion Bankës çdo Raport Projekt, jo më vonë se dyzet e pesë ditë pas fundit të çdo gjashtëmujori kalendarik, në të cilin mbulohet gjashtëmujori kalendarik.

b) Huamarrësi, nëpërmjet MSHMS-së, monitoron dhe vlerëson ecurinë e Projektit dhe, në veçanti, ecurinë lidhur me arritjen e treguesve të lidhur me livrimin dhe, për këtë qëllim, përfshin në çdo Raport Projekt informacionin në fjalë, me objektin dhe hollësinë specifike të përcaktuar në përputhje me Protokollin e Verifikimit.

Seksioni III. Tërheqja e fondeve të huas

A. Të përgjithshme.

Pa kufizuar dispozitat e nenit II të Kushteve të Përgjithshme dhe në përputhje me shkresën për Informacionin mbi Livrimin dhe Financat, Huamarrësi mund të tërheqë fondet e Huas: a) për të financuar Shpenzimet e Lejuara; dhe b) për të paguar Tarifën Fillestare sipas shumës së caktuar dhe, nëse zbatohet, deri në përqindjen e përcaktuar kundrejt secilës kategori të tabelës së mëposhtme:

Kategoria	Shuma e Huas (në dollarë)	Shuma e TLL-së (në dollarë)	Përqindja e shpenzimeve të financuara (përfshin tatimet)
1. Programi i shpenzimeve të lejuara në kuadër të pjesës 1 të Projektit	10.202.500 -	TLL 17: 3.000.000 TLL 18: 2.500.000 TLL 19: 2.202.500 TLL 20: 2.500.000	100%
2. Shërbime të konsulencës dhe kostot e shfrytëzimit në kuadër të pjesës 2 të Projektit	770.000		100%
3. Tarifa fillestare	27.500		Shuma e pagueshme në bazë të seksionit 2.03, të kësaj Marrëveshjeje, në përputhje me seksionin 2.07(b) të Kushteve të Përgjithshme
GJITHSEJ	11.000.000		



B. Kushtet për tërheqjen; Periudha e tërheqjes

1. Pavarësisht nga dispozitat e pjesës A të këtij seksioni, nuk kryhet asnjë tërheqje:

a) Për pagesa të kryera para datës së kësaj marrëveshjeje; dhe

b) Për pagesat e kategorisë 1, në lidhje me secilën shumë të TLL-ve, për të cilat është dorëzuar një kërkesë tërheqjeje, përveç kur Huamarrësi ka ofruar dëshmi të pranueshme për Bankën, se:

i. nga Huamarrësi, përfituesve të lejuar u janë kryer pagesat për programin e shpenzimeve të lejuara dhe në përputhje me procedurat e përcaktuara në ligjet e zbatueshme të Huamarrësit dhe manualin e operacioneve të projektit; dhe

ii. janë përmbushur dispozitat e pikës 2 të mëposhtme.

2. Pa kufizuar dispozitat e parashikuara në paragrafin 1, të seksionit III.B të këtij skeduli, tërheqjet e bëra nga Huamarrësi, sipas kategorisë 1, bëhen në një pagesë të vetme për çdo TLL dhe çdo pagesë kryhet sipas shumës së përcaktuar në rubrikën “shuma e TLL-së”, në bazë të dorëzimit në Bankë të dëshmive të pranueshme për Bankën dhe siç përcaktohet në manualin e operacioneve të projektit, se:

a) Ka vazhduar të zbatohet indeksimi sipas inflacionit për pagesat e PAK-së që prej vitin 2010 dhe se asnjë rritje e pagesave nuk e kalon këtë indeksim të tillë (kushti global i livrimit); dhe

b) Është arritur në përputhje me dispozitat përkatëse të kësaj Marrëveshjeje TLL të përcaktuar në skedulin 4 të kësaj Marrëveshjeje (dhe për të cilin është dorëzuar një kërkesë për tërheqje).

3. Pavarësisht nga sa më sipër:

a) Nëse Banka konstaton se nuk është përmbushur Kushti Global për Livrimin, si

pasoje e së cilës Banka nuk e ka kryer livrimin e fondeve të huas sipas kategorisë 1, në lidhje me ndonjë TLL të arritur, Banka, duke vepruar me tagrin e saj:

i. mund të autorizojë në një datë të mëvonshme kur Banka bindet për plotësimin e Kushtit Global të Livrimit tërheqjen e fondeve të huas të palejuara më parë në lidhje me TLL-në e plotësuar; ose

ii. mund të anulojë në çdo kohë, duke njoftuar Huamarrësin, shumën e fondeve të huas të mbajtura ose ta rialokojë shumën në fjalë për TLL të tjerë.

b) Nëse Banka konstaton, në çdo kohë, se një pjesë e shumave të livruara nga Huamarrësi në kategorinë 1 është përdorur për rimbursimin e shpenzimeve që nuk janë të lejuara në kuadër të pagesave për programin e shpenzimeve të lejuara ose nuk janë në përputhje me dispozitat e paragrafëve 1(b) dhe 2 të seksionit IV.B të këtij skeduli, Huamarrësi do t’ia rikthejë menjëherë këtë shumë të tillë Bankës, sipas specifikimeve që bën Banka në njoftimin për Huamarrësin.

4. Data e mbylljes është data 30 qershor 2021.

Seksioni IV. Parashikime/sipërmarrje të tjera

1. Huamarrësi e shtrin zbatimin e procedurave të rishikuara të PAK-së për përcaktimin e së drejtës për të përfituar nga PAK-ja dhe pagesat e lidhura me të në të gjitha njësitë administrative të qarkut Tiranë, brenda datës 31 dhjetor 2019.

SKEDULI 3 GRAFIKU I SHLYERJES SË AMORTIZIMIT TË LIDHUR ME ANGAZHIMIN

Në tabelën në vijim jepen datat e shlyerjes së Principalit të Huas dhe përqindja e shumës totale të Principalit të Huas të pagueshme në çdo datë shlyerjeje të Principalit (Përqindja e Këstit).

Shlyerjet e Principalit

Data e shlyerjes së Principalit	Përqindja e Këstit
Më 1 shkurt dhe 1 gusht çdo vit. Duke filluar nga data 1 gusht 2025 dhe deri më 1 shkurt 2045	2,5%



SKEDULI 4
TREGUESIT E LIDHUR ME LIVRIMIN DHE SHUMAT E TYRE

Nr.	Treguesi i lidhur me livrimin (TLL)	Shuma e TLL-së (në dollarë)
17	a) Të paktën 66 për qind e kërkesave të reja dhe kërkesave për ricertifikim të ardhura në të gjitha njësitë administrative të 3 qarqeve pilot janë përpunuar përmes SMI të automatizuar të PAK-së; dhe b) SMI i PAK-së është zgjeruar për të përfshirë funksione të fazës së dytë, duke përfshirë integrimin e të dhënave nga vlerësimi i rishikuar i së drejtës për të përfituar në bazë të Modelit Social.	3.000.000
18	Zyrat rajonale të Shërbimit Social Shtetëror në secilin prej tri qarqeve pilot rehabilitohen sipas standardeve të cilësisë të parashikuara në aktet rregullatore zyrtare për akomodimin e personave me aftësi të kufizuara në ndërtesat, hapësirat dhe shërbimet publike.	2.500.000
19	Janë përgatitur, konsultuar, miratuar dhe shpërndarë në përputhje me Protokollin e Verifikimit një strategji e daljes dhe një plan veprimi për përfituesit e PNE-së.	2.202.500
20	Hetohen nga inspektorët socialë, në përputhje me Protokollin e Verifikimit, të paktën 55 për qind të rasteve të dyshuara për mashtrim dhe gabim në PAK në Tiranë.	2.500.000

SHTOJCË

Seksioni I. Përkufizime

1. “Udhëzimet antikorrupsion”, për qëllime të paragrafit 5 të shtojcës së Kushteve të Përgjithshme, janë “Udhëzimi për parandalimit dhe luftën kundër krimit ekonomik dhe korrupsionit në projektet e financuara me hua të BNRZH-së dhe kredi e grante të SHNZH-së”, datë 15 tetor 2006, rishikuar në janar 2011 dhe nga data 1 korrik 2016.

2. “Kategoria” është një kategori e përcaktuar sipas tabelës në seksionin III.A, të skedulit 2 të kësaj Marrëveshjeje.

3. “Shuma e TLL-së” është shuma e fondeve të huas e përcaktuar në rubrikën me titull “shuma e TLL-së” në tabelat e seksionit III.A, të skedulit 2 dhe në skedulin 4 të kësaj Marrëveshjeje.

4. “Programi i ndihmës për aftësinë e kufizuar” dhe “PAK” është programi i Huamarrësit për dhënien e pagesave personave me aftësi të kufizuara, siç përkufizohen dhe parashikohen në legjislacionet e ndryshme, këto akte nënligjore të Huamarrësit: ligji nr. 8098, datë 28 mars 1996, “Për statusin e të verbrit” dhe ligji nr. 8626, datë 22.6.2000, “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik” dhe kategoritë e tjera të personave me aftësi të kufizuara, si edhe statusin e lidhur të invalidit paraplegjik dhe

tetraplegjik dhe kategoritë e tjera të personave me aftësi të kufizuara dhe ligji nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, dhe aktet e tij nënligjore, si edhe vendimet e Këshillit të Ministrave të Huamarrësit për përfitimet që rrjedhin nga statusi i të verbrit dhe invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë dhe kategoritë e tjera të personave me aftësi të kufizuara.

5. “Treguesit e lidhur me livrimin” ose “TLL” janë bashkërisht treguesit e lidhur me livrimin të paraqitur në rubrikën me titull “Treguesi i lidhur me livrimin (TLL)” në tabelën e skedulit 4 të kësaj Marrëveshjeje; dhe “Treguesi i lidhur me livrimin” dhe “TLL” është veçmas secili prej këtyre objektivave të synuar.

6. “Udhëzimet MSHS” janë Udhëzimet e Përgjithshme për Mjedisin, Shëndetin dhe Sigurinë, të Grupit të Bankës Botërore, datë 30 prill 2007, të përmendura në OP/BP 4.01, me ndryshimet përkatëse që mund të bëhen nga Grupi i Bankës Botërore, të cilat gjenden në adresën: www.ifc.org/ehsguidelines

7. “Programi i Shpenzimeve të Lejuara” ose “PSHL” është programi i shpenzimeve të lejuara i Huamarrësit, në lidhje me pjesën 1 të Projektit, të cilat janë shpenzimet për dërgesat në të holla që u bëhen përfituesve në kuadër të PNE-së.



8. “Plani i Menaxhimit Mjedisor” ose “PMM” është plani i menaxhimit mjedisor për punimet rehabilituese që do të kryhen në bazë të TLL 18, të përmendur në tabelën e shtojcës së kësaj Marrëveshjeje, zyrën rajonale të SHSSH-së Tiranë, datë 26 janar 2018, plani i menaxhimit mjedisor për punimet rehabilituese që do të kryhen në zyrën rajonale të SHSSH-së Elbasan, datë 26 janar 2018, dhe plani i menaxhimit mjedisor për punimet rehabilituese që do të kryhen në zyrën rajonale të SHSSH-së Durrës, datë 26 janar 2018, të gjitha të pranueshme për Bankën dhe të njoftuara në vend, më 26 janar 2018, dhe në faqen e internetit të Bankës, më 26 janar 2018, të cilët përbëhen nga masa zbutëse dhe lista kontrolli të hartuara dhe të miratuara nga Huamarrësi për të menaxhuar dhe/ose për të zbutur rreziqet dhe ndikimet e identifikuar ose të mundshme për mjedisin, shëndetin dhe sigurinë që shoqërojnë punimet rehabilituese në fjalë në kuadër të TLL-së 18, me shtesat dhe ndryshimet e bëra herë pas here me miratimin paraprak me shkrim të Bankës.

9. “Kushtet e Përgjithshme” janë “Kushtet e Përgjithshme të Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për financimet e dhëna nga BNRZH, ja financimi i projekteve të investimeve”, datë 14 korrik 2017.

10. “Kushti Global i Livrimit” është kushti i livrimit i përcaktuar në pikën 2(a), të seksionit III.B, të skedulit 2 të kësaj Marrëveshjeje.

11. “Udhëzimet për Shëndetin dhe Sigurinë” janë Udhëzimet e Përgjithshme për Mjedisin, Shëndetin dhe Sigurinë, të Grupit të Bankës Botërore, datë 30 prill 2007, të përmendura në OP/BP 4.01, me ndryshimet përkatëse që mund të bëhen nga Grupi i Bankës Botërore, të cilat gjenden në adresën: www.ifc.org/ehsguidelines

12. “M&V” është monitorimi dhe vlerësimi.

13. “MFE” është Ministria e Financave dhe Ekonomisë e Huamarrësit ose çdo pasues i saj.

14. “MSHMS” është Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale e Huamarrësit ose çdo pasuese e saj.

15. “SIM” është Sistemi i Informacionit për Menaxhimin.

16. “Programi i ndihmës ekonomike” ose “PNE” është programi i asistencës sociale në formë përfitimesh monetare, i krijuar me ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005, i ndryshuar në prill 2011.

17. “Kostot e shfrytëzimit” janë kostot e arsyeshme shtesë të cilat nuk do të ekzistojnë në mungesë të Projektit dhe që i linden MSHMS-së në lidhje me administrimin që shoqëron zbatimin e aktiviteteve të Projektit, duke përfshirë qiranë e zyrave, mirëmbajtjen, pajisjet e zyrave, orenditë, materialet dhe furnizimet dhe komunikimin.

18. “Huaja fillestare” është huaja e përmendur në klauzolën hapëse A të kësaj Marrëveshjeje.

19. “Marrëveshja fillestare e Huas” është marrëveshja e përmendur në klauzolën hapëse A të kësaj Marrëveshjeje.

20. “Projekti fillestar” është projekti i përshkruar në skedulën 1 të Marrëveshjes Fillestare të Huas.

21. “Rregullat për prokurimet” janë, për qëllime të paragrafit 85 të shtojcës së Kushteve të Përgjithshme, “Rregullorja e Bankës Botërore për prokurimet për huamarrësit e financimeve të projekteve të investimeve”, e miratuar në korrik 2016, rishikuar në nëntor 2017.

22. “Manuali i Operacioneve të Projektit” ose “MOP” është manuali i përgatitur dhe i miratuar nga Huamarrësi, i pranueshëm për Bankën, ku parashikohen, ndër të tjera, masat organizative institucionale për zbatimin e Projektit; masat për lëvizjen e fondeve të Projektit, duke përfshirë protokollet dhe udhëzimet për menaxhimin financiar të Projektit, përgatitjen e kërkesave për tërheqjen e fondeve, mbajtjen e të dhënave, auditimin, raportimin dhe sistemin e kontrollit të brendshëm; udhëzimet për planifikimin dhe ekzekutimin e aktiviteteve të prokurimeve sipas Projektit; protokollin për vënien në dispozicion të dëshmimeve shkresore për respektimin/arritjen e TLL-ve; dhe politikat dhe procedurat për monitorimin e aktiviteteve të Projektit, si dhe respektimin e kërkesave të raportimit, me shtesat dhe ndryshimet që mund të bëhen herë pas here me miratimin e Bankës.

23. “Politikat mbrojtëse” janë politikat dhe procedurat operative të Bankës (me shtesat dhe ndryshimet që mund të bëhen herë pas here nga Banka) të parashikuara në Manualin Operacional të Bankës dhe të identifikuar si OP/BP 4.01 (Vlerësimi mjedisor); OP/BP 4.04 (Habitatet natyrore); OP/BP 4.09 (Menaxhimi i dëmtuesve); OP/BP 4.10 (Popujt indigjenë); OP/BP 4.11 (Burimet Kulturore Fizike); OP/BP 4.12 (Shpërngulja e detyruar); OP/BP 4.36 (Pyjet)



dhe OP/BP 4.37 (Siguria e digave); të cilat gjenden në faqen e internetit të Bankës me adresë: www.worldbank.org

24. “Data e nënshkrimit” është më e fundit e dy datave me të cilat Huamarrësi dhe Banka e kanë nënshkruar këtë Marrëveshje dhe ky përkufizim zbatohet për të gjitha rastet kur përmendet “data e Marrëveshjes së Huas” në Kushtet e Përgjithshme.

25. “Modeli social” është një model që përfshin, si vlerësimin mjekësor, ashtu edhe vlerësimin jomjekësor, të zotësive dhe nevojave funksionale.

26. “Programet e asistencës sociale” bashkërisht janë PAK dhe PNE.

27. “SHSSH” është Shërbimi Social Shtetëror, subjekt i Huamarrësit i krijuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 542, datë 27.7.2005, “Për miratimin e statutit të Shërbimit Social Shtetëror”, i ndryshuar.

28. “Tri qarqet pilot” janë bashkërisht qarqet Durrës, Elbasan dhe Tiranë të Huamarrësit.

29. “Protokolli i Verifikimit” është dokumenti i Huamarrësit, i cili përmban MOP ku përshkruhen me hollësi mënyrat përmes të cilave do të verifikohet përmbushja e TLL-ve në kuadër të Projektit.

30. “Formula e unifikuar e pikëzimit” ose “FUP” është një formulë në bazë të së cilës u jepet e drejta familjeve për ndihmë ekonomike, duke përdorur koeficientë dhe ndryshore të përcaktuara qartë, të cilat dalin nga korrelacionet objektive me statusin ekonomik dhe me varfërinë.

LIGJ

Nr. 54/2018

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË HUAS NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM, PËR PROJEKTIN E KONEKTIVITETIT TË RRUGËVE RAJONALE DHE LOKALE

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për projektin e konektivitetit të rrugëve rajonale dhe lokale, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 23.7.2018

Shpallur me dekretin nr. 10860, datë 31.7.2018 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

HUAJA NUMËR 8850-AL

MARRËVESHJE HUAJE

(PROJEKTI PËR KONEKTIVITETIN E RRUGËVE RAJONALE DHE LOKALE)
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR
RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Marrëveshje që mban datën e nënshkrimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë (Huamarrësi) dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka). Huamarrësi dhe Banka bien dakord si më poshtë:

Neni I

Kushtet e përgjithshme; përkufizime

1.01 Kushtet e Përgjithshme (siç përcaktohen në shtojcën e kësaj Marrëveshjeje) zbatohen dhe janë pjesë e kësaj Marrëveshjeje.

1.02 Përveç nëse konteksti e kërkon ndryshe, termat me gërmë të madhe të përdorur në këtë Marrëveshje kanë kuptimet që u bashkëlidhen në Kushtet e Përgjithshme ose në shtesën e kësaj Marrëveshjeje.

Neni II

Huaja

2.01 Banka bie dakord t'i japë Huamarrësit shumën prej pesëdhjetë milionësh (50,000,000



dollarë amerikanë), (Huamarrja) për të ndihmuar për financimin e projektit të përshkruar në skedulin 1 të kësaj Marrëveshjeje (Projekti).

2.02 Huamarrësi mund t'i tërheqë të ardhurat nga Huaja në përputhje me seksionin III, të skedulit 2 të kësaj Marrëveshjeje.

2.03 Tarifa e parapagimit është një e katërta e një për qind (0.25%) e shumës së kredisë.

2.04 Tarifa e angazhimit është një e katërta e një për qind (0.25%) në vit të Bilancit të Huas së Patërhequr.

2.05 Norma e interesit është Norma e Referencës, plus Shpërndarja Fikse, në pajtim me seksionin 3.02 (e) të Kushteve të Përgjithshme.

2.06 Datat e pagimit janë data 1 mars dhe 1 shtator e çdo viti.

2.07 Shuma e principalit të Huas do të paguhet në përputhje me skedulin 3 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni III

Projekti

3.01 Huamarrësi deklaron angazhimin e tij ndaj objektivave të Projektit. Për këtë qëllim, Huamarrësi siguron që Projekti të kryhet nga Njësia e Zbatimit të Projektit, në përputhje me dispozitat e nenit V të Kushteve të Përgjithshme, skedulin 2 të kësaj Marrëveshjeje dhe Marrëveshjes së Projektit.

Neni IV

Mjetet ligjore të bankës

4.01 Veprimtaria Shtesë e Pezullimit përbëhet nga sa më poshtë, përkatësisht ndryshimi, pezullimi, shfuqizimi, anulimi ose heqja e legjislacionit lidhur me Njësinë e Zbatimit të Projektit, në mënyrë që ndikon materialisht dhe negativisht, sipas mendimit të Bankës, mbi aftësinë e njësise së zbatimit të projektit për të përmbushur ndonjë nga detyrimet e tij në përputhje me Marrëveshjen e Projektit ose Marrëveshjen Plotësuese.

4.02 Veprimtaria Shtesë e Përshpejtimit përbëhet nga sa më poshtë, përkatësisht ndodhja dhe vazhdimi i çdo veprimtarie të specifikuar në seksionin 4.01 të kësaj Marrëveshjeje për një periudhë 60- ditore pas njoftimit të veprimtarisë nga Banka për Huamarrësin.

Neni V

Hyrja në fuqi; përfundimi

5.01 Kushtet shtesë të hyrjes në fuqi përbëhen nga sa më poshtë:

a) Marrëveshja Plotësuese ekzekutohet në emër të Huamarrësit dhe Njësise së Zbatimit të Projektit.

b) Njësia e Zbatimit të Projektit përgatit dhe miraton Manualin Operacional të Projektit.

5.02 Çështja tjetër e përmendur në seksionin 9.02(a)(ii) të Kushteve të Përgjithshme lidhet me autorizimin e Marrëveshjes Plotësuese nga Huamarrësi dhe Njësia e Zbatimit të Projektit dhe është ligjërish e detyrueshme për Huamarrësin dhe Njësinë e Zbatimit të Projektit, në përputhje me kushtet e saj.

5.03 Afati i hyrjes në fuqi është nëntëdhjetë (90) ditë pas datës së kësaj Marrëveshjeje

Neni VI

Përfaqësuesi; adresat

6.01 Përfaqësuesi i Huamarrësit është ministri i Financave dhe Ekonomisë ose çdo pasues i tij.

6.02 Adresa e Huamarrësit është:

Ministria e Financave

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3

Tiranë, Shqipëri

Faksimile:

dhe

a) Adresa e postës elektronike e Huamarrësit është:

Faksimile:

355 42228494 sekretariamin@financa.gov.al

6.03 Për qëllime të seksionit 10.01 të Kushteve të Përgjithshme: a) adresa e Bankës është:

Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim

1818 H Street, N.W.

Washington, D.C. 20433

United States of America; dhe

b) Adresa elektronike e Bankës është:

Teleks: Faksimile: [E-mail:]

248423(MCI) ose 1-202-477-6391 _____

64145(MCI) msalim1@worldbank.org

Rënë dakord në datën e nënshkrimit.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Përfaqësuar nga: _____

Përfaqësuesi i autorizuar

Emri: Arben Ahmetaj



**Titulli: MINISTËR I FINANCAVE DHE
EKONOMISË
Datë 5.6.2018**

**BANKA NDËRKOMBËTARE PËR
RINDËRTIM DHE ZHVILLIM
Përfaqësuar nga:**

Përfaqësuesi i autorizuar

Emri: Linda Van Gelder

Titulli: DREJTOR I VENDIT

Datë 5.6.2018

**SKEDULI 1
PËRSHKRIMI I PROJEKTTIT**

Objektivat e Projektit janë përmirësimi i aksesit në qendrat e përzgjedhura bujqësore dhe turistike, si dhe forcimi i kapaciteteve të bashkive për të menaxhuar asetet e tyre rrugore.

Projekti përbëhet nga pjesët e mëposhtme:

Pjesa 1. Përmirësimi i aksesueshmërisë

a) Rehabilitimi për t'i rezistuar ndikimeve klimatike.

i. mbështetje për rehabilitimin e rrugëve rajonale dhe lokale në Bashkitë e Përzgjedhura, duke përfshirë shtigjet për këmbësorët, shtigjet për biçikletat, përmirësimet e sigurisë, sinjalistikën e orientimit dhe aspekte estetike, kur rrugët u shërbejnë zonave turistike ose kalojnë nëpër zona urbane.

ii. mbështetje për zhvillimin e projekteve rrugore dhe mbikëqyrjen e punimeve inxhinierike, duke përfshirë edhe kryerjen e auditimeve teknike dhe të sigurisë rrugore.

b) Nismat për sigurinë rrugore

Mbështetje për identifikimin e ndërhyrjeve të mundshme në sigurinë rrugore, në rrugë të ndryshme nga ato të përmendura në pjesën 1(a) më sipër dhe zbatimi i ndërhyrjeve të tilla, realizimi i hartës së rrezikut rrugor dhe inspektimi i sigurisë rrugore në seksionet rrugore të lidhura me rrugët e pjesës 1(a) për të trajtuar pikat më problematike për aksidentet.

Pjesa 2. Ndërtimi i kapaciteteve për bashkitë

a) Ndërtimi i kapaciteteve bashkiake për të menaxhuar dhe mirëmbajtur rrjetet rrugore

Mbështetje e bashkive të përzgjedhura për të zhvilluar sisteme bashkiake për mirëmbajtjen e rrugëve dhe planifikimin e rrugëve, duke përfshirë: i. ofrimin e këshillimit për të

përmirësuar sistemet ekzistuese të menaxhimit të aseteve për të përmirësuar planifikimin dhe prioritizimin e aktiviteteve të mirëmbajtjes dhe të rehabilitimit; ii. zhvillimin e një marrëveshjeje për nivelin standard të shërbimit për të përmirësuar efikasitetin e ekzekutimit të mirëmbajtjes; iii. ofrimin e këshillimit për të zhvilluar një kuadër për financimin e qëndrueshëm të mirëmbajtjes; dhe iv. kryerjen e aktiviteteve për ngritjen e kapaciteteve për bashkitë e përzgjedhura për të zbatuar në mënyrë efektive programet e mirëmbajtjes së rrugëve.

b) Ndërtimi i ekonomive të reja

Mbështetje e bashkive të përzgjedhura për zbatimin e programeve të zhvillimit rural, duke përfshirë “Programin e 100 Fshatrave” dhe programe të ngjashme, nëpërmjet ofrimit të këshillimit për: i. vlerësimin e potencialit të tregut në nivel fshati për të përcaktuar se cilat aktivitete prodhuese sigurojnë fitimin më të lartë; ii. përgatitjen e propozimeve për investime për të përdorur fondet e grantit të disponueshme për të trajtuar kërkesat e tregut; dhe iii. zbatimin e aktiviteteve të përmendura në pikën “i” dhe “ii”.

Pjesa 3. Mbështetje për menaxhimin e zbatimit

Mbështetje e Njesisë së Zbatimit të Projektit për të realizuar zbatimin e Projektit, duke përfshirë nëpërmjet ofrimit të Kostove Operacionale shtesë dhe Trajnimit, zhvillimit dhe mirëmbajtjes së Sistemit Informativ Gjeografik (GIS), përdorimit të bazës së të dhënave për përcaktimin e përparësisë së rrugëve rajonale dhe lokale.

**SKEDULI 2
EKZEKUTIMI I PROJEKTTIT**

Seksioni I. Organizimet institucionale dhe të zbatimit

A. Organizimet institucionale

1. Personeli i dedikuar

Huamarrësi mundëson që Njësia e Zbatimit të Projektit

a) Të ketë, gjatë të gjithë zbatimit të Projektit, personel të dedikuar me kualifikime, eksperiencë dhe terma reference që janë të kënaqshme për Bankën;

b) Të sigurojë që personeli i dedikuar të kryejë mbikëqyrjen dhe koordinimin e projektit lidhur me kontributet teknike të bashkive të përzgjedhura; dhe



c) Të kryejë zbatimin e Projektit, duke përfshirë menaxhimin financiar, prokurimin dhe menaxhimin e kontratave.

2. Bordi Menaxhues i Njesisë së Zbatimit të Projektit

Në vijim të legjislacionit dhe akteve nënligjore të Njesisë së Zbatimit të Projektit, Këshilli Drejtues i Njesisë së Zbatimit të Projektit realizon drejtimin në mënyrë aktive të zbatimit të Projektit, në përputhje me seksionin I.A.2 të skedulit të Marrëveshjes së Projektit.

B. Organizimet zbatuese

1. Manuali Operacional i Projektit

a) Huamarrësi mundëson që Njësia e Zbatimit të Projektit: i. të përgatisë dhe të miratojë një Manual Operacional të Projektit që është në formë dhe në përmbajtje të kënaqshme për Bankën; dhe ii. më pas ta zbatojë Projektin në përputhje me Manualin Operacional të Projektit.

b) Me përjashtim të rastit kur Huamarrësi dhe Banka mund të bien dakord ndryshe me shkrim, Huamarrësi garanton që Njësia e Zbatimit të Projektit nuk do të shfuqizojë, ndryshojë, pezullojë, heqë dorë ose të mos zbatojë në një formë tjetër Manualin Operacional të Projektit ose ndonjë dispozitë të tij.

c) Në rast të ndonjë mospërputhjeje midis dispozitave të Manualit Operacional të Projektit dhe dispozitave të kësaj Marrëveshjeje ose të Marrëveshjes së Projektit, dispozitat e kësaj Marrëveshjeje do të kenë përparësi.

2. Marrëveshja Plotësuese

a) Për të lehtësuar realizimin e Projektit, Huamarrësi i vë në dispozicion të ardhurat nga Huaja në formë grantesh Njesisë së Zbatimit të Projektit, bazuar në një Marrëveshje Plotësuese (Marrëveshja Plotësuese) ndërmjet Huamarrësit dhe Njesisë së Zbatimit të Projektit, sipas termave dhe kushteve të miratuar nga Banka.

b) Huamarrësi ushtron të drejtat dhe përmbush detyrimet që i rrjedhin nga Marrëveshja Plotësuese në mënyrë që të mbrojë interesat e Huamarrësit dhe Bankës dhe të përmbushë qëllimet e Huas. Përveç kur Banka bie dakord ndryshe, Huamarrësi nuk mund të caktojë, ndryshojë, shfuqizojë, ndërpresë ose të mos zbatojë Marrëveshjen Plotësuese ose ndonjë prej dispozitave të saj.

C. Garancitë

1. Për të siguruar zbatimin e duhur të Projektit, në mënyrë të përshtatshme mjedisore dhe sociale, Huamarrësi garanton që Njësia e Zbatimit të Projektit:

a) Të realizojë Projektin në përputhje me Instrumentet Mbrojtëse;

b) Para kryerjes së ndonjë punimi në kuadër të Projektit: i. të përgatisë PMMS-të në përputhje me KMMS-të përkatëse, duke përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese dhe konsultimet me publikun, në formë dhe përmbajtje të kënaqshme për Bankën; dhe ii. të zbatojë aktivitetet e Projektit në përputhje me PMMS-në përkatëse.

c) Para kryerjes së ndonjë punimi në kuadër të Projektit, i cili përfshin zhvendosje të pavullnetshme, të përgatisë një PVR në përputhje me KPZH-në, duke përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese dhe konsultime të rëndësishme me personat e prekur nga projekti, në formë dhe përmbajtje të kënaqshme për Bankën, dhe të sigurojë zbatimin e PVR-ve, duke përfshirë kompensimin e duhur të personave të prekur nga Projekti, në përputhje me dispozitat e KPZH-së dhe PVR-së, dhe

d) Të mos caktojë, ndryshojë, shfuqizojë ose heqë dorë nga Instrumentet e Mbrojtjes ose ndonjë dispozitë e saj, pa miratimin paraprak të Bankës.

2. Në rast të ndonjë mospërputhshmërie ndërmjet dispozitave të ndonjë instrumenti mbrojtës dhe dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, dispozitat e kësaj Marrëveshjeje do të kenë përparësi.

3. Huamarrësi garanton që Njësia e Zbatimit të Projektit të sigurojë që termat e referencës së çdo konsulence në lidhje me Projektin të jenë të kënaqshme për Bankën, duke u pasuar nga rishqyrtimi prej saj dhe, për këtë qëllim, termat e referencës përfshijnë rregullisht kërkesat e Politikave të Mbrojtjes të Bankës që janë në fuqi, siç aplikohet për këshillimet e përcjella nëpërmjet asistencës teknike.

4. Pa kufizim ndaj detyrimeve të tjera të raportimit sipas kësaj Marrëveshjeje, Huamarrësi garanton që Njësia e Zbatimit të Projektit, për secilin nga instrumentet mbrojtëse që përfshijnë planet përkatëse mjedisore dhe sociale, të mbledhë, përpilojë dhe furnizojë Bankën një herë në tre muaj (ose më shpesh, ose nëpërmjet një



raportimi të veçantë, sa herë që kërkohet nga rrethanat), me raporte në formë dhe përmbajtje të kënaqshme për Bankën, mbi statusin e përputhshmërisë me Instrumentin e Mbrojtjes, duke përfshirë planet përkatëse mjedisore dhe sociale si pjesë e Raporteve të Projektit, duke dhënë detaje mbi:

a) Masat e marra për avancimin e Instrumenteve të Mbrojtjes, duke përfshirë çdo plan mjedisor dhe social përkatës;

b) Kushtet, nëse ka, të cilat ndërhyjnë ose rrezikojnë të ndërhyjnë në zbatimin e qetë të Instrumenteve të Mbrojtjes dhe të çdo plani mjedisor dhe social përkatës (duke përfshirë aksidentet dhe ankesat e lidhura me Projektin); dhe

c) Masat përmirësuese të marra ose të nevojshme për t'u marrë për të trajtuar këto kushte;

5. Pa kufizim të dispozitave për shpenzimet e përjashtuara të përcaktuara në KMMZ dhe KPZH, Huamarrësi, nëpërmjet Njesisë së Zbatimit të Projektit, siguron që aktivitetet në vijim nuk kanë të drejtë të përfshihen ose të financohen nga projekti, domethënë çdo aktivitet që do të çonte në konvertimin ose degradimin e habitateve kritike natyrore ose të zonave të tyre mbështetëse.

6. Huamarrësi garanton që Njësia e Zbatimit të Projektit të mbajë gjatë gjithë zbatimit të Projektit dhe të publikojë disponueshmërinë e një mekanizmi për zgjidhjen e ankesave, në formë dhe përmbajtje të kënaqshme për Bankën, për të dëgjuar dhe vendosur në mënyrë të drejtë dhe në mirëbesim të gjitha ankesat e ngritura në lidhje me Projektin dhe për të marrë të gjitha masat e nevojshme për zbatimin e përcaktimeve të bëra nga një mekanizëm i tillë, në një mënyrë të kënaqshme për Bankën.

Seksioni II. Raportimi dhe vlerësimi i monitorimit të Projektit

Huamarrësi garanton që Njësia e Zbatimit të Projektit i paraqet Bankës çdo Raport të Projektit, të përgatitur dhe të dorëzuar nga Njësia e Zbatimit të Projektit, jo më vonë se dyzet e pesë ditë pas mbarimit të çdo gjashtëmujori kalendarik, duke e mbuluar edhe këtë të fundit.

Seksioni III. Tërheqja e të ardhurave nga huaja

A. Të përgjithshme

Pa kufizim ndaj dispozitave të nenit II të Kushteve të Përgjithshme dhe në përputhje me Letrën e Disbursimit dhe Informimit Financiar, Huamarrësi mund të tërheqë të ardhurat e Huas, për të: a) financuar shpenzimet e lejueshme; dhe b) paguar tarifën e parapagimit; në shumën e alokuar dhe, nëse është e zbatueshme, deri në përqindjen e përcaktuar në secilën kategori të tabelës në vijim:

Kategoria	Shuma e huas së alokuar (e shprehur në dollarë)	Përqindja e shpenzimeve që do të financohen (përfshirë taksat)
1. Mallrat, punimet, dhe shërbimet jokonsulente	45,025,000	100%
2. Shërbimet e konsulencës	2,850,000	100%
3. Kostot operative dhe trajnimi	2,000,000	100%
4. Tarifa e parapagimit	125,000	Shuma që paguhet në bazë të seksionit 2.03 të kësaj Marrëveshjeje, në përputhje me seksionin 2.07(b) të Kushteve të Përgjithshme _____
SHUMA E PËRGJITHSHME	50,000,000	



B. Kushtet e tërheqjes; periudha e tërheqjes

1. Pavarësisht nga dispozitat e pjesës A më sipër, nuk bëhet asnjë tërheqje për pagesat e kryera para datës së nënshkrimit.

2. Data e përfundimit është data 31 dhjetor 2022.

Seksioni IV. Sipërmarrje të tjera

A. Huamarrësi mundëson që Njësia e Zbatimit të Projektit të sigurojë përdorimin e standardeve të përkohshme të projektimit të pranueshme për Bankën për projektimin e rrugëve të financuara, sipas pjesës 1 të Projektit. Standardet alternative të projektimit mund të përdoren vetëm pas marrëveshjes paraprake me shkrim ndërmjet FSHZH-së, bashkive të përzgjedhura dhe Bankës.

SKEDULI 3 AFATET E SHLYERJES SË AMORTIZIMIT TË LIDHUR ME ANGAZHIMIT

Tabela e mëposhtme përcakton datat e pagesës së principalit të huas dhe përqindjen e shumës totale të principalit të huas që paguhet në secilën datë të pagimit të principalit (Përqindja e kështit).

Shlyerjet e pagimit të principalit

Data e pagimit të principalit	Përqindja e kështit
Çdo datë 1 mars dhe 1 shtator Duke filluar nga data 1 shtator 2024 deri më 1 mars 2047	2.13%
Më 1 shtator 2047	2.02%

SHTESË

Seksioni I. Përkufizime

1. “FSHZH-ja” ose “Fondi Shqiptar i Zhvillimit” nënkupton një organizatë jofitimprurëse me autonomi administrative, financiare, teknike dhe ligjore të krijuar në bazë të ligjit të Huamarrësit nr. 10130, të datës 11.5.2009 dhe nr. 82, të datës 17.7 ose çdo akt tjetër pasues të pranueshëm për Bankën.

2. “Udhëzimet kundër Korrupsionit” janë, për qëllime të paragrafit 5 të shtojcës së Kushteve të Përgjithshme, “Udhëzimet për Parandalimin dhe Luftimin e Mashtrimit dhe Korrupsionit në Projektet e Financuara nga Huat e IBRD-së dhe Kreditë dhe Grantet e IDA-s”, të datës 15 tetor, 2006, të rishikuara në janar 201 dhe më 1 korrik 2016.

3. “Politikat e Mbrojtjes së Bankës” janë politikat dhe procedurat operacionale të Bankës, të përcaktuara në Manualin Operacional të

Bankës dhe të identifikuara si OP/BP 4.01, 4.04, 4.09, 4.10, 4.11, 4.12, 4.36 dhe 4.37: www.WorldBank.org/opmanual

4. “Kategoria” është një kategori e përcaktuar në tabelën në seksionin III.A, të skedulit 2 të kësaj Marrëveshjeje.

5. “Marrëveshje Bashkëpunimi” është marrëveshja e lidhur midis Njesisë së Zbatimit të Projektit dhe një Bashkie të Përzgjedhur, siç specifikohet në seksionin I.B.3 të Programit të Marrëveshjes së Projektit.

6. “Personeli i Dedikuar” ose “PD” është stafi i emëruar në kuadër të Njesisë së Zbatimit të Projektit për zbatimin e projektit dhe të përmendur në seksionin I.A.1, të skedulit 2 të kësaj Marrëveshjeje ose ndonjë pasues i pranueshëm për Bankën.

7. “Kuatr i Menaxhimit Mjedisor dhe Social” ose “KMMS” është korniza e Projektit, e përgatitur nga Njësia e Zbatimit të Projektit dhe e botuar në faqen e internetit të Njesisë së Zbatimit të Projektit më 22 dhjetor 2017 dhe në faqen e internetit të Bankës, më 10 janar 2018, e cila përcakton, ndër të tjera, modalitetet për analizimin mjedisor dhe social të zonave specifike, duke përfshirë: a) udhëzime për identifikimin e kushteve ekzistuese mjedisore dhe sociale dhe ndikime të mundshme të drejtpërdrejta dhe të tërthorta mjedisore dhe sociale dhe rreziqe që rrjedhin si rezultat i realizimit të Projektit; b) udhëzimet për kryerjen e vlerësimeve mjedisore dhe sociale dhe përgatitjen e planeve të menaxhimit mjedisor dhe social (PMMS), kur janë të zbatueshme; c) rekomandime për masat lehtësuese për çdo ndikim negativ të identifikuar; d) masa për rritjen e çdo ndikimi pozitiv të identifikuar; dhe e) udhëzime për përgatitjen e planeve të monitorimit mjedisor dhe social për ndjekjen e zbatimit të masave lehtësuese, sipas ndryshimeve dhe plotësimeve herë pas here të kornizës së lartpërmendur, me miratimin paraprak me shkrim të Bankës.

8. “Plani i Menaxhimit Mjedisor dhe Social” ose “PMMS-ja” janë planet për menaxhimin mjedisor dhe social të zonave specifike, të cilat janë të kënaqshme për Bankën, duke përfshirë planet për zbutjen e mjedisit dhe planet e monitorimit mjedisor që do të përgatiten dhe miratohen nga Njësia e Zbatimit të Projektit, në



përputhje me KMMS-në, ku përcaktohen detajet specifike të masave për menaxhimin e rreziqeve të identifikuar ose potenciale mjedisore dhe sociale dhe për zbutjen, zvogëlimin dhe/ose kompensimin e ndikimeve të pafavorshme mjedisore dhe sociale, të lidhura me zbatimin e aktiviteteve në kuadër të Projektit, së bashku me një bazë mjedisore dhe sociale për çdo zone specifike, detajet e kornizës legislative mjedisore përkatëse, organizimet e duhura institucionale, monitorimi dhe raportimi i aftë për të siguruar zbatimin e duhur dhe kontribute të rregullta në lidhje me pajtueshmërinë me secilin PMMS, sipas ndryshimeve dhe plotësimeve herë pas here, me miratimin paraprak me shkrim të Bankës.

9. “Kushtet e Përgjithshme” janë “Kushtet e Përgjithshme të Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për Financimin e IBRD-së dhe Financimin e Projekteve të Investimeve” të datës 14 korrik 2017.

10. “Zhvendosja e pavullnetshme” është çdo ndikim i drejtpërdrejtë ekonomik dhe social i shkaktuar nga: a) marrja e pavullnetshme e tokës që çon në: i. zhvendosjen ose humbjen e banesës; ii. humbjen e pasurisë ose humbjen e aksesit në pasuri; ose iii. humbjen e burimeve të të ardhurave ose të mjeteve të jetesës, pavarësisht nëse personat e tillë duhet të lëvizin apo jo në një vend tjetër; ose b) kufizimin e pavullnetshëm të aksesit në parqe dhe zona të mbrojtura të përcaktuara me ligj, duke çuar në ndikime të pafavorshme mbi jetesën e këtyre personave.

11. “MFE-ja” është Ministria e Financave dhe Ekonomisë e Huamarrësit ose çdo pasues i saj.

12. “Shpenzimet operative” janë shpenzimet graduale të bëra nga Njësia e Zbatimit të Projektit dhe EMP-ja, për shkak të zbatimit të Projektit, të cilat nuk do të ekzistojnë në rast të mosekzistencës së Projektit, dhe përfshijnë shpenzimet për qira, operim dhe mirëmbajtje të automjeteve, pajisje zyre dhe shpenzime për komunikimin, mbështetje për sistemet e informacionit, përkthime, tarifa bankare, shpenzime udhëtimi dhe dieta, pagat e personelit të kontraktuar të Njesisë së Zbatimit të Projektit (duke përfshirë shërbimet e konsulencës dhe pagat e zyrtarëve të shërbimit civil të Huamarrësit), tarifatat sociale për stafin e Njesisë së Zbatimit të Projektit, shpenzimet për administrimin e zyrës dhe shpenzimet e tjera të arsyeshme të lidhura drejtpërdrejt me realizimin e Projektit, siç është

rënë dakord me Bankën dhe bazuar në një buxhet vjetor të pranueshëm për Bankën.

13. “Rregulloret e Prokurimit” janë, për qëllime të paragrafit 85 të shtojcës së Kushteve të Përgjithshme, “Rregullat e Prokurimit të Bankës Botërore për Huamarrësit e IPF-së” të muajit korrik 2016, të rishikuara në nëntor 2017.

14. “Person i prekur nga Projekti” janë personat, të cilët, për shkak të ekzekutimit të Projektit, janë prekur ose do të preken nga rivendosja e pavullnetshme.

15. “Njësia e Zbatimit të Projektit” ose “NJZP” është Fondi Shqiptar i Zhvillimit ose FSHZH.

16. “Legjislacioni i Njesisë së Zbatimit të Projektit” janë ligjet e Huamarrësit nr. 10130, të datës 11.5.2009 dhe nr. 82 të datës 17.7.2009.

17. “Manuali Operacional i Projektit” është manuali që duhet të përgatitet dhe miratohet nga Njësia e Zbatimit të Projektit që është i kënaqshëm për Bankën dhe Marrëveshjen e Projektit, duke përfshirë një përshkrim të detajuar të Projektit, procedurave për zbatimin e Projektit, organizimeve të hollësishme institucionale, në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje dhe ligjet dhe rregulloret në fuqi dhe duke përfshirë, ndër të tjera, afatet kohore të veprimeve që kërkohen të kryhen në kuadër të Projektit, personelin, aspektet e mirëbesimit, teknike dhe operacionale, procedurat për zbatimin e Projektit, duke përfshirë procedurat e menaxhimit (buxhetimi, kontabiliteti dhe kontrolli i brendshëm, disbursimi dhe qarkullimi i fondeve, raportimi financiar, raportet vjetore, procedurat e organizimit të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm, duke përfshirë edhe skicën specifike të llogarive të Projektit), Marrëveshjen model të Bashkëpunimit, procedurat e prokurimit, KMMS-në dhe RPF-në, organizimet për monitorimin dhe vlerësimin, si edhe organizime të tjera në mirëbesim dhe administrative, siç mund të ndryshohen herë pas here me marrëveshje me Bankën.

18. “Plani i Veprimit i Rivendosjes” ose “PVR” është një plan i kënaqshëm për Bankën, për t’u përgatitur dhe zbatuar nga Njësia e Zbatimit të Projektit për kryerjen e aktiviteteve në kuadër të Projektit, në përputhje me Kornizën e Politikave të Zhvendosjes dhe duke përcaktuar, ndër të tjera, parimet dhe objektivat, kriteret e përshtatshmërisë së personave të prekur, kompensimin, asistencën dhe të drejtat e rehabilitimit, si dhe organizimet e



nevojshme për monitorimin dhe raportimin në përputhje me Kornizën e Politikave të Zhvendosjes, sipas ndryshimeve herë pas here të këtij plani, me miratimin paraprak të Bankës.

19. “Korniza e Politikave të Zhvendosjes” ose “KPZH” është dokumenti i përgatitur nga Njësia e Zbatimit të Projektit dhe i botuar në faqen e internetit të Njesisë së Zbatimit të Projektit, më 22 dhjetor 2017, dhe në faqen e internetit të Bankës, më 10 janar 2018, i kënaqshëm për Bankën, i cili përcakton modalitetet për blerjen e tokës në kuadër të Projektit dhe përshkruan politikat, procedurat, planet dhe veprimet (duke përfshirë përgatitjen e PVR-ve) dhe masat institucionale që lidhen me Zhvendosjen e Pavullnetshme, duke përfshirë blerjen e tokës dhe ndikimet e tjera shoqërore që mund të lindin gjatë Projektit, sipas ndryshimeve që mund t'i nënshtrohet kjo kornizë herë pas here me miratimin paraprak të Bankës.

20. “Instrumenti i mbrojtjes” është KMMS-ja, PMMS-ja, KPZH-ja ose çdo PVR për një aktivitet të Projektit, siç mund të kërkohej nga konteksti; dhe “Instrumentet mbrojtëse” nënkuptojnë të gjitha kornizat ose planet e tilla për Projektin.

21. “Bashkitë e përzgjedhura” nënkupton ndonjë prej bashkive të Huamarrësit që mund të jenë rënë dakord ndërmjet Huamarrësit dhe Bankës për pjesëmarrje në projekt, duke përfshirë Bashkinë e Shkodrës, Fierit dhe Pogradecit.

22. “Data e nënshkrimit” është data më e vonë nga dy datat kur Huamarrësi dhe Banka e nënshkruajnë këtë Marrëveshje dhe ky përkufizim zbatohet për të gjitha formulimet “në datën e Marrëveshjes së Huas” të Kushteve të Përgjithshme.

23. “Kontributet Shoqërore” janë çdo pagesë, shpërblim ose kontribut për përfitimet shëndetësore dhe shoqërore të ofruara për personelin e Njesisë së Zbatimit të Projektit, në përputhje me ligjin e Huamarrësit nr. 7703, të datës 11 maj 1993, të ndryshuar.

24. “Marrëveshje Plotësuese” nënkupton marrëveshjen e përmendur në seksionin I.B.2, të shtojcës 2 të kësaj Marrëveshjeje, në bazë të së cilës Huamarrësi vë në dispozicion të Njesisë së Zbatimit të Projektit të ardhurat e Huas.

25. “Trajnim” janë shpenzimet (përveç shërbimeve të konsulencës) e kryera nga Njësia e Zbatimit të Projektit, në lidhje me zbatimin e Projektit, bazuar në buxhetet periodike të

pranueshme për Bankën, për: i. shpenzimet e arsyeshme për udhëtim, akomodim, vakte dhe dieta për trajnerët dhe të trajnuarit në lidhje me trajnimin e tyre; ii. tarifat e kurseve; iii. qiraja për vendet e organizimit të trajnimit/seminarit dhe përdorimin e pajisjeve; dhe iv. shpenzimet për përgatitjen, blerjen, riprodhimin dhe shpërndarjen e materialeve të trajnimit që nuk përfshihen në kontratat e ofruesve të mallrave ose shërbimeve.

26. “Programi i 100 Fshatrave” është programi i Huamarrësit i miratuar me qëllim kthimin e 100 fshatrave në territorin e Huamarrësit, në modele të zhvillimit rural, nëpërmjet një qasjeje të ndërhyrjes ndërqeveritare ndërinstitucionale për mundësimin e ndërhyrjeve zhvillimore nga Huamarrësi në zonat rurale.

VENDIM

Nr. 86, datë 16.7.2018

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 49, DATË 29.9.2014 “AUTORIZIM I NDIHMËS SHTETËRORE PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT TË GAZSJELLËSIT TRANS ADRIATIK, BAZUAR NË LIGJIN NR. 116, DATË 15.4.2013, “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES ME QEVERINË E VENDIT PRITËS NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, DUKE VEPRUAR NËPËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE, DHE TRANS ADRIATIK PIPELINE AG, LIDHUR ME PROJEKTIN E GAZSJELLËSIT TRANS ADRIATIK (PROJEKTI TAP), SI DHE TË MARRËVESHJES NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA KËSHILLI I MINISTRAVE, DHE TRANS ADRIATIK PIPELINE AG, NË LIDHJE ME PROJEKTIN E GAZSJELLËSIT TRANS ADRIATIK (PROJEKTI TAP)”

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, me pjesëmarrjen e:

Z. Arben Ahmetaj	kryetar;
Znj. Mimoza Dhëmbi	anëtare;
Znj. Etleva Haka	anëtare;
Znj. Mirjana Zisia	anëtare;
Z. Ahmet Maçellari	anëtar.



Në mbledhjen e tij të radhës të datës 16.7.2018, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në bazë të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, neni 28/1 “Autorizimi eks-post i ndihmës” dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 817, datë 28.12.2005, “Për miratimin e rregullores “Për procedurat dhe formën e njofimit””, vlerësoi përputhjen me legjislacionin e ndihmës shtetërore të projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së ndryshimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave, dhe Trans Adriatic Pipeline AG, lidhur me marrëveshjen me qeverinë e vendit pritës”.

1. Vlerësimi i ekzistencës së ndihmës shtetërore

1.1 Kualifikimi i masës si ndihmë shtetërore

Në bazë të nenit 4, pika 1, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, përcaktohet se:

“Përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj, ndalohet çdo ndihmë e dhënë nga burimet shtetërore, në çfarëdolloj forme, e cila në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojë konkurrencën duke dhënë përparësi për një ose disa ndërmarrje të caktuara ose për prodhimin e produkteve të caktuara, për aq sa mund të ketë ndikim në plotësimin e detyrimeve të ndërmarrja nga Republika e Shqipërisë në marrëveshjet ndërkombëtare që përmbajnë dispozita të ndihmës shtetërore”.

Gjithashtu, neni 71 “Konkurrenca dhe dispozita të tjera ekonomike”, i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Komuniteteve Evropiane e Shteteve të tyre Anëtare dhe Republikës së Shqipërisë¹, përcakton se:

“Praktikat në kundërshtim me këtë nen vlerësohen në bazë të kritereve që lindin nga zbatimi i rregullave të konkurrencës të aplikueshme në Komunitet, sidomos në nenet 81, 82, 86 dhe 87 të Traktatit themelues të Komunitetit Evropian dhe instrumenteve interpretuese që përdoren nga institucionet e Komunitetit.”

Në përcaktimin nëse një masë përbën ndihmë shtetërore në kuptim të nenit 4, të ligjit të ndihmës shtetërore dhe të nenit 107 (1) të TFEU-së, Komisioni vlerëson plotësimin në mënyrë kumulative të kritereve të mëposhtme:

- Masa duhet të jepet nga shteti dhe të përfshijë burimet shtetërore;

- Masa duhet të japë një avantazh ndaj ndërmarrjeve të caktuara ose sektorëve të caktuar;

dhe

- Masa ndikon në konkurrencë dhe tregtinë midis shteteve anëtare.

Komisioni referuar projektaktit të sipërcituar si edhe legjislacionit në fuqi konstaton se:

a) Referuar shtojcës 1 “Ndryshime në marrëveshjen me qeverinë pritëse”, pikës 5, konkretisht:

1. Germës “a” që parashikon se “... *Importimi i mallrave nga Investitori i Projektit ose Kontraktuesi i Nivelit të Parë, importuesi nuk do të ketë detyrimin për pagesën e tatimit mbi vlerën e shtuar pranë autoriteteve doganore që duhej kryer në lidhje me këto importe. Ky import mallrash do të trajtohet si një furnizim mallrash i kryer nga importuesi për veten e tij si pjesë e veprimtarisë së tij ekonomike, me efekt lindjen e detyrimit të importuesit për të paguar këtë tatim mbi vlerën e shtuar ndaj administratës tatimore dhe të drejtën e tij për të zbritur këtë tatim mbi vlerën e shtuar...*”;

2. Germës “b” që parashikon se “*Në lidhje me furnizimin e mallrave dhe shërbimeve brenda vendit nga një kontraktues i Nivelit të Parë ose një Kontraktues i Nivelit të Dytë, vetëm marrësi i mallrave dhe/ose shërbimeve do të jetë i detyruar të paguajë tatimin mbi vlerën e shtuar ndaj administratës tatimore dhe ka të drejtën për të zbritur këtë tatim mbi vlerën e shtuar...*”;

3. Germës “e”, që parashikon se “*Importuesi sipas shkronjës “a” dhe marrësi i furnizimeve të mallrave /shërbimeve sipas shkronjës “b” do të lëshojë një faturë tatimore shitje për veten, ku do të rezultojë si furnizues dhe blerës i mallrave dhe i shërbimeve në të njëjtën kohë (autofaturimi) dhe ka të drejtë që në mënyrë të menjëhershme të zbresë nga TVSH-ja e llogaritur mbi shitjet që i korrespondojnë këtyre importeve ose furnizimeve të mallrave ose shërbimeve, TVSH-ja e zbatuar në këto blerje në të njëjtën shumë; pra nuk do të bëhet pagesë me para në dorë pranë administratës tatimore, me kusht të ketë të drejtë të zbresë këtë TVSH në blerje sipas dispozitave të përgjithshme të ligjit të zbatueshëm”.*

b) Referuar nenit 15 “Vetëfurnizimi i mallrave dhe shërbimeve”, të ligjit nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i cili përcakton se:

¹ Ligji nr. 9590, datë 27.7.2006, “Për ratifikimin e “Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe komuniteteve evropiane e shteteve të tyre anëtare”.



“Për qëllime të këtij ligji, konsiderohet si furnizim kundrejt pagesës nga personi i tatueshëm furnizimi i mallrave të prodhuara, të ndërtuara, të nxjerra, të përpunuara, të blera ose furnizimi i shërbimeve në kuadër të veprimtarisë së tij ekonomike për t’u përdorur për nevoja të kësaj veprimtarie”;

c) Referuar njoftimit të Komisionit Evropian për zbatimin e rregullave të ndihmës shtetërore për masat që lidhen me taksimin e biznesit², masat fiskale të një natyre të përgjithshme, të cilat zbatohen për të gjitha ndërmarrjet pa dallim, nuk përbëjnë ndihmë shtetërore. Sipas njoftimit, kur zbatohen masa taksash të një game më të gjerë për ndërmarrjet që përmbushin kritere të caktuara, të cilat lehtësojnë barrën e taksave që këto ndërmarrje do të duhej të përballonin në kushte normale, *selektiviteti* i masave zakonisht vlerësohet sipas analizës në tri faza, konkretisht:

1. Identifikimi i sistemit të referencës;

2. Përcaktimi nëse një masë e caktuar përbën një përjashtim nga sistemi, pra nëse aplikohen diferencime ndërmjet operatorëve ekonomikë; si dhe

3. Nëse masa në fjalë përbën një përjashtim nga sistemi i referencës, duhet të përcaktohet, nëse masa e përjashtimit është e justifikueshme nga natyra ose skema e përgjithshme e sistemit (referencës).

Sa më lart, Komisioni i Ndihmës Shtetërore vlerëson se projektligji i sipërcituar nuk aktivizon burime shtetërore, duke qenë se nëpërmjet kësaj skeme të gjitha furnizimet e nevojshme ndërkombëtare/të huaja dhe vendase të lidhura me projektin TAP, në nivelin e parë dhe të dytë të furnizimeve për projektin TAP, do t’i nënshtrohen TVSH-së nëpërmjet sistemit të autofaturimit të parashikuar në nenin 15, të ligjit nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”. Projektakti i sipërcituar përcakton mënyrën se si duhet të llogaritet TVSH për mallrat dhe shërbimet që blihen nga ana e ndërmarrjes, duke rregulluar procedurat administrative gjatë zbatimit të projektit.

Sa më lart, Komisioni i Ndihmës Shtetërore mbështetur në vlerësimet e mësipërme, në kuptim të nenit 4 të ligjit për ndihmën shtetërore,

vlerëson se skema e sipërcituar nuk përbën ndihmë shtetërore, në kushtet kur mosplotësimi i të paktën një prej kritereve të sipërpërmendura (burime shtetërore) nuk provohet, duke qenë se këto kritere janë kumulative.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, në bazë të neneve 4, 17, 22 dhe 31, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar:

VENDOSI :

1. Skema e parashikuar në projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së ndryshimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave, dhe Trans Adriatic Pipeline AG, lidhur me marrëveshjen me qeverinë e vendit pritës”, nuk përbën ndihmë shtetërore, pasi një nga kriteret kumulative, burime shtetërore nuk provohet.

2. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në nenin 20, pika 1, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të njoftojë pranë Komisionit të Ndihmës Shtetërore në rastin eventual të çdo ndryshimi të marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave dhe Trans Adriatic Pipeline AG.

3. Ky vendim të botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Arben Ahmetaj

²http://ec.europa.eu/competition/state_aid/legislation/legislation.html

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2018

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 392 lekë